

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE

Bruksel, 05.11.2008
SEC(2008) 2697 final

DOKUMENT I STAFIT PUNUES TË KOMISIONIT

**RAPORTI I PROGRESIT PËR KOSOVË (SIPAS REZOLUTËS 1244)
2008**

shoqëruar me

**LETRËN PREJ KOMISIONIT PËR
PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN**

Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2008-2009

{COM(2008)674}

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrja.....	4
1.1.Parathënia.....	4
1.2. Konteksti.....	4
1.3. Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës (sipas Rezolutës 1244).....	6
2. Kriteri politik.....	8
2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit.....	8
2.2. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve.....	16
2.3. Çështjet regjionale dhe obligimet ndërkombëtare.....	26
3. Kriteri ekonomik.....	27
3.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut.....	27
3.2. Kapaciteti për të përballuar presionin garues dhe forcat e tregut brenda BE-së.....	31
4. Standardet Evropiane.....	34
4.1. Tregu i brendshëm.....	34
4.1.1. Lëvizja e lirë e të mirave.....	34
4.1.2. Lëvizja e njerëzve, shërbimeve dhe e drejta për ndërmarrje.....	35
4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit.....	35
4.1.4. Doganat dhe Taksat.....	35
4.1.5. Konkurrenca.....	37
4.1.6. Siguria Publike.....	37
4.1.7. Ligji për Pronën Intelektuale.....	38
4.1.8. Politikat sociale dhe të punësimit.....	38
4.1.9. Edukimi dhe Hulumtimi.....	40
4.1.10. Çështjet e WTO-së.....	41
4.2. Politikat Sektoriale.....	42
4.2.1. Industria dhe SMEs.....	42
4.2.2. Bujqësia dhe Peshkimi.....	42
4.2.3. Ambienti.....	43
4.2.4. Politika e Transportit.....	45
4.2.5. Energjia.....	46
4.2.6. Informimi dhe media.....	48
4.2.7. Kontrolli financiar.....	50
4.2.8. Statistikat.....	50
4.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria.....	51
4.3.1. Viza, kufiri, kontrolli, azili dhe migrimi.....	51
4.3.2. Pastrimi i parave.....	52
4.3.3. Droga.....	52
4.3.4. Policia.....	53
4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	53
4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale.....	54

DOKUMENT I STAFIT PUNUES TË KOMISIONIT

Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008

1. HYRJA

1.1. Parathënia

Prej marsit të vitit 2002 Komisioni ka raportuar rregullisht para Këshillit dhe Parlamentit Evropian për progresin e bërë nga vendet e Ballkanit perëndimor.

Ky raport ka kryesisht të njëjtën strukturë sikurse në vitet e mëparshme. Raporti:

- përshkruan shkurtimisht marrëdhëniet mes Kosovës¹ dhe BE-së;
- analizon situatën politike në Kosovë për sa i përket demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së minoriteteve dhe çështjeve regjionale;
- analizon situatën ekonomike në Kosovë;
- shqyrton kapacitetin e Kosovës për të implementuar standardet evropiane, që do të thotë, afrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të Kosovës me ato të “*acquis*”, në përputhje me prioritetet e Partneritetit Evropian.

Periudha e mbuluar nga ky raport është prej 1 tetorit 2007 deri në fillimi të tetorit 2008. Progresi është matur në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të aprovuar dhe masave të implementuara. Legjislacioni ose masat që janë duke u përgatitur ose presin aprovimin parlamentar nuk janë marrë për bazë. Kjo qasje garanton trajtim të barabartë të të gjitha raporteve dhe lejon vlerësim objektiv.

Raporti është i bazuar në informatat e mbledhura dhe analizuar nga Komisioni. Po ashtu, janë përdorur edhe burime tjera, përfshirë kontributet prej autoriteteve të Kosovës, shteteve anëtare të BE-së, raporteve të Parlamentit Evropian², dhe informatat nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni nxjerrë konkluzione të detajuara për sa i përket Kosovës në komunikimin e saj të ndarë për zgjerim³, bazuar në analizën teknike të përfshirë në këtë raport.

1.2. Konteksti

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1244/99) siguron kornizën legale ndërkombëtare për Kosovën. Ajo siguron vendosjen e pranisë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë, nën mbikëqyrjen e Kombeve të

¹ Sipas Rezolutës 1244

² Raportues për Kosovën është Mr Joost Lagendijk MEP.

³ Strategjia për Zgjerim dhe Sfidat Kryesore 2008-2009.

Bashkuara. Ajo autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për të vendosur një prani civile ndërkombëtare për të siguruar një administrim të përkohshëm për Kosovën.

KFOR, prania ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, e udhëhequr nga NATO-ja, vazhdon të jetë përgjegjës për sigurinë e përgjithshme.

Sistemi legal në Kosovë është kombinim i legjislacionit të aprovuar nga autoritetet e Kosovës, rregulloret dhe urdhëresat administrative të UNMIK-ut dhe ligjet jugosllave të para 22 marsit 1989.

Në mars të vitit 2007, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, ka paraqitur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, përgatitur nga i dërguari i tij i posaçëm, Martti Ahtisaari. Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës parasheh një përfaqësues civil ndërkombëtar (ICR) me mandat të dyfishtë, si përfaqësues special i BE-së dhe si mision i ESDP-së (European Security and Defence Policy – Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje – shënim i përkthyesit) për sundim të ligjit. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka përkrahur plotësisht rekomandimin e Ahtisaarit për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës.

Në gusht të vitit 2007, në mungesë të marrëveshjes në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, miraton një nismë të re për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Ai propozoi negociata të drejtpërdrejta, të ndërmjetësuar nga një treshe BE-ShBA-Rusi. Bisedimet e drejtpërdrejta mes Prishtinës dhe Beogradit filluan në New York në shtator të vitit 2007. Më 10 dhjetor 2007, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dërgoi raportin e treshes në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke konfirmuar se dy palët nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë marrëveshje. Raporti konfirmonte se procesi i negociatave është shterur.

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës deklaroi Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Deri tani, pavarësia e Kosovës është njohur nga 51 shtete, 22 prej të cilave janë shtete anëtare të BE-së. Kuvendi i Kosovës, po ashtu, ka miratuar flamurin dhe himnin. Pas kësaj deklaratë, situata e sigurisë ka mbetur relativisht e qetë, përveç dy incidenteve serioze në Kosovën veriore. Në shkurt, janë shkatërruar dy pika kufitare në Kosovën veriore, kurse në mars është sulmuar ndërtesa e gjykatës në Mitrovicë, ku është vrarë një polic i UNMIK-ut dhe ka pasur disa dëme serioze.

Më 9 prill, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta bazohet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës dhe parasheh një rol domethënës të Bashkimit Evropian në Kosovë. Ajo, po ashtu, siguron për përfaqësuesin civil ndërkombëtar autoritet përfundimtar mbikëqyrës, siç e parasheh Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

Në raportin e tij të muajit qershor para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka pranuar se Deklarata e Pavarësisë dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës ka krijuar një realitet të ri në Kosovë. Ky realitet ka paraqitur sfida domethënëse për mundësinë e UNMIK-ut për të ushtruar autoritetin e tij administrativ dhe për të kryer shumicën e detyrave të tij, duke paraqitur nevojën për ri-konfigurim të pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë. Në korrik, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka instruktuar UNMIK-un të bashkëpunojë me BE-në me qëllim që BE të pranojë një rol operativ të zgjeruar në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

Më 8 tetor, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka aprovuar një rezolutë që kërkon mendimin këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.

Procesi i shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe themelimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i paraparë me kushtetutë, ka filluar në muajin qershor. FSK duhet të përbëhet nga një personel prej diku 2,500 vetash të armatosur lehtë, detyra e parë e të cilëve do të jetë përgjigja ndaj krizave, çmontim i eksplozivit dhe mbrojtja civile. Procesi realizohet nën kontrollin e NATO-s dhe në koordinim të ngushtë me aktorët tjerë ndërkombëtarë.

Strukturat paralele e privojnë Qeverinë e Kosovës që të ekzekutojë pjesë të autoritetit të saj në shumë zona të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. UNMIK-u i ka deklaruar të pavlefshme zgjedhjet lokale serbe të mbajtura në Kosovë në maj të vitit 2008.

Kosova vazhdon të jetë e hapur për të biseduar me Serbinë çështjet e interesit praktik. Pas Deklaratës së Pavarësisë, Qeveria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për t'i siguruar qytetarët serbë të Kosovës. Bashkëpunimi konstruktiv me Serbinë është përparësi kryesore në Partneritetin Evropian për Kosovën.

1.3. Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës (sipas Rezolutës 1244)

Pas raportit të treshes dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Këshilli i Evropës në dhjetor të vitit 2007 ka theksuar nevojën për të ecur përpara drejt marrëveshjes për Kosovën, duke nënvizuar se zgjidhja e statusit të Kosovës paraqet rast sui generis dhe që nuk përbën precedent. Këshilli ka konfirmuar se BE ka qëndruar e gatshme të luajë rol udhëheqës në forcimin e stabilitetit në regjion dhe në implementimin e marrëveshjes që e definon statusin e ardhshëm të Kosovës. Këshilli, po ashtu, ka konfirmuar që BE ka qenë e gatshme të ndihmojë në zhvillimin ekonomik dhe politik përmes perspektivës së qartë evropiane, në përputhje me perspektivën evropiane të regjionit.

Në shkurt të vitit 2008, Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme është pajtuar për një Aksion të Përbashkët⁴ për të vendosur një mision për sundimin e ligjit në Kosovë, të njohur si "EULEX". Detyra kryesore e misionit është mentorimi,

⁴ Veprimi i Këshillit të Përbashkët 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008 për Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË.

monitorimi dhe këshillimi. EULEX ka po ashtu edhe disa funksione ekzekutive. Këshilli po ashtu është pajtuar në Aksionin e Përbashkët⁵ për të caktuar një Përfaqësues Special të BE-së në Kosovë. PSBE këshillon dhe mbështet procesin politik dhe siguron konsistencën e veprimit të BE-së në Kosovë. Në rolin tjetër të tij, ai mbikëqyr implementimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen e Statusit të Kosovës. PSBE raporton te Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Si PCN, ai raporton te Grupi Udhëheqës Ndërkombëtar për Kosovën, i cili përbëhet prej 25 vendeve⁶ që kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Në qershor 2008, Këshilli i Evropës ka rikonfirmuar që BE ka mbetur e përkushtuar për të luajtur rol udhëheqës në garantimin e stabilitetit të Kosovës, përmes EULEX-it, PSBE-së dhe kontributit të Zyrës Civile Ndërkombëtare si pjesë e pranisë ndërkombëtare. Këshilli i Evropës kujton gatishmërinë për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës përmes perspektivës së qartë evropiane, në përputhje me perspektivën evropiane të regjionit.

Kosova ka vazhduar të punojë me ekipet planifikuese të Këshillit për të përgatitur misionin e BE-së dhe është duke bashkëpunuar ngushtë me EULEX-in dhe PSBE-në/PCN-në. Vendosja e EULEX-it është duke vazhduar. EULEX do të funksionojë në tërë Kosovën.

Kosova vazhdon të marrë pjesë në Procesin e Stabilizim Asociimit. Mbledhjet plenare të Mekanizmit Shoqërues të Procesit të Stabilizim Asociimit janë mbajtur më nëntor të vitit 2007 dhe maj të vitit 2008. Në kornizën e zgjerimit të strukturave të Mekanizmit Shoqërues të Stabilizimit, të vendosura në mars të vitit 2007, takimet sektoriale të Mekanizmit Shoqërues të Stabilizimit janë mbajtur në fushat e Zbulimit, Tregut të Brendshëm, Qeverisjes së Mirë, Ekonomisë dhe Infrastrukturës.

BE ka paraqitur reformat prioritare për autoritetet përmes Partneritetit Evropian. Në shkurt të vitit 2008, Këshilli ka aprovuar një partneritet evropian të rishqyrtuar për Kosovën. Në korrik të vitit 2008, Qeveria ka aprovuar Planin e Aksionit të Partneritetit Evropian.

Në prill të vitit 2008, Qeveria ka aprovuar Planin për Integrim Evropian 2008-2010, i cili ka për qëllim të përmirësojë koordinimin dhe komunikimin ndërqeveritar. Strukturat relevante institucionale janë ndërtuar në shtator.

Më 11 korrik Komisioni Evropian ka organizuar Konferencën e Donatorëve për Kosovën, e cila është mbajtur në Bruksel. Pjesëmarrësit kanë siguruar gjithsej 1,236 milionë euro.

⁵ Veprimi i Këshillit të Përbashkët 2008/123/CFSP i 4 shkurtit 2008 oër caktimin e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë.

⁶ Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Republika e Cekisë, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia, Latvia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Slovenia, Zvicrra, Suedia, Turquia, Mbretëria e Bashkuar, ShBA.

Zotimi i përbashkët i Komisionit⁷ dhe Shteteve Anëtare të BE-së është gati 800 milionë euro.

Kosova vazhdon të përfitojë prej Instrumentit për Para-anëtarësim, Asistencës Makro-Financiare, CARDS, Instrumentit për Stabilitet dhe të tjerave. Në ndihmë të vendimit për të mbyllur Agjencinë Evropiane për Rindërtim (AER) në fund të vitit 2008, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë në qershor ka marrë përgjegjësinë nga AER për projektet e financuara në kuadër të programit CARDS. Asistenca e tanishme e BE-së për Kosovën në kuadër të instrumentit CARDS sillet diku 170 milionë euro dhe përfshin mbi 80 projekte.

Programi Vjetor 2008 për Kosovën i IPA-s fokusohet në objektivat e identifikuar në Dokumentin Planifikues Shumë-Vjetor (MIPD) 2008-2010. Asistenca e EU IPA-s për Kosovën në vitin 2008 sillet në 122.7 milion⁸, e cila menaxhohet drejtpërdrejtë nga ECLO, plus ndihma prej 2 milionë eurove nën Programin Multi-Përfitues. Programimi për IPA 2008 ka filluar në tetor të vitit 2007. Të gjitha institucionet përfituese kanë qenë ngushtë të përfshira në procesin e programimit. Përparësitë kryesore për financim përfshijnë forcimi i kapaciteteve administrative në të gjitha nivelet, zgjerimi i sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe qeverisja e mire, përmirësimi i kushteve socio-ekonomike për të gjitha komunitetet dhe zhvillimi i bashkëpunimit regional. Parapërgatitjet për programin IPA janë bërë në bashkëpunim të ngushtë me ekipet planifikuese të Këshillit (EUPT dhe EUSR/ICO) për të garantuar komplementaritetin me aktivitetet e misionit të ESDP-së në Kosovë dhe EUSR-së. Janë konsultuar po ashtu edhe shtetet anëtare dhe komuniteti i donatorëve, por edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Marrëveshja financiare për IPA 2008 Programi Vjetor për Kosovë është nënshkruar në tetor.

ECLO implementon programet e IPA-së në Kosovë nën menaxhimin e dekoncentruar centralisht. Disa projekte menaxhohen nën menaxhimin e përbashkët me organizatat ndërkombëtare (si Këshilli i Evropës). Kosova ka për të themeluar një 'roadmap' për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontroll *ex ante* të Komisionit. Kosova është në fazë shumë të hershme të këtij projekti.

Kosova duhet të caktoj koordinatorin e saj kombëtar të IPA-së (NIPAC).

2. Kriteri politik

Ky kapitull shqyrton progresin që ka bërë Kosova drejt plotësimit të kriterit politik të Kopenhagës, i cili kërkon stabilitet të institucioneve që garantojnë demokraci, sundim të ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të minoriteteve. Po ashtu, monitoron bashkëpunimin regional, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet që aspirojnë anëtarësim por edhe me shtetet anëtare dhe respektimin e obligimeve ndërkombëtare, si bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare të Kombeve të bashkuara për ish-Jugosllavi.

2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

⁷ Pjesë nga premtimi i Komisionit është temë e miratimit nga Autoriteti Buxhetor.

⁸ Një ndarje e sërishme e 60 milion eurove është transferuar prej MFA-së në IPA në vitin 2008.

Kushtetuta

Më 9 prill, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kësaj i ka paraprirë përgatitjet nga grupi punues kushtetues, diskutimet publike, çertifikimi i draft kushtetutës nga ICR-ja dhe aprovimi nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

Kushtetuta është e bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës të përgatitur nga përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaari. Kushtetuta në mënyrë të qartë konfirmon që dispozitat e Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës kanë përparësi në raport me të gjitha dispozitat legale në Kosovë. Ajo, po ashtu, konfirmon Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës si referencë kryesore për të verifikuar pajtueshmërinë e kushtetutës me ligjet dhe aktet tjera legale. Kushtetuta konfirmon se ICR është autoriteti përfundimtar në Kosovë për sa i përket interpretimit të aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Kushtetuta nuk i referohet KB-ve ose UNMIK-ut, përveçse në kontekst të përfundimit të misionit të tij në Kosovë.

Kushtetuta garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Ajo respekton parimet demokratike të subsidiaritetit dhe qeverisjes lokale. Ajo përfshin dispozitat themelore që kanë lidhje me shtetësinë. Ajo, po ashtu, konfirmon të drejtat dhe liritë fundamentale, të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre. Ajo përmban përshkrim të detajshëm të kompetencave dhe fuqive të institucioneve shtetërore, përfshirë Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë. Ajo përshkruan parimet dhe strukturën e sistemit të drejtësisë, përfshirë rolin e gjykatës kushtetuese. Kushtetuta përfshin dispozita të detajuara për qeverisjen lokale dhe sektorin e sigurisë. Ajo, po ashtu, konfirmon rolin dhe kompetencat e institucioneve të pavarura, përfshirë Ombudspersonin, Auditorin Gjeneral, Komisionin Qendror Zgjedhor, Bankën Qendrore, dhe Komisionin e Pavarur të Mediave.

Dispozitat kalimtare të Kushtetutës konfirmojnë rregullimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, të paraparë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

Komunitetit serb i Kosovës nuk ka marrë pjesë formalisht në procesin kushtetues. Minoritetet tjera, si për shembull, minoriteti rom, është ankuar se nuk ka qene i përfshirë ose i përfshirë dhe konsultuar pamjaftueshëm.

Kushtetuta është në përputhje me standardet evropiane, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve duke garantuar demokraci, sundim të ligjit, të drejta të njeriut dhe respekt dhe mbrojtje të minoriteteve. Garantimi i respektimit të plotë të sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve është prioriteti kryesor në partneritetin evropian për Kosovën.

Parlamenti

Kuvendi është rithemeluar pas zgjedhjeve të përgjithshme të nëntorit 2007, të cilat janë mbajtur në një frymë fer dhe efektive. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka fituar 34% të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë 23% të votave, Aleanca Kosova e Re (AKR) 12% dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) kanë fituar nga 10%, Partia Reformiste (ORA) 4% dhe Partia e Drejtësisë (PD) 2%. Të trembëdhjetë partitë minoritare kanë fituar gjithsej 5% të votave.

Komisioni Qendror Zgjedhor është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë. Kryesia e KQZ-së është transferuar prej misionit të OSBE-së në Kosovë te autoritetet e Kosovës.

Kuvendi formalisht e ka zgjedhur Presidentin dhe Kryeministrin, ka aprovuar Deklaratën e Pavarësisë dhe Kushtetutën dhe ka aprovuar me procedurë të përshpejtuar totalisht 41 ligje drejtpërdrejtë të lidhura me pavarësinë dhe kushtetutën.

Pas bojkotit pas Deklaratës së pavarësisë, anëtarët e komunitetit serb të Kosovës i janë ribashkuar Kuvendit.

Në mars, Kryesia e Kuvendit ka aprovuar rregullat procedurale për punën e kryesisë dhe rregullat për stafin politik. Janë formuar tri komitete të reja: Komiteti për Integritet Evropian, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Çështje Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione dhe Komiteti për Mandate dhe Imunitete. Komitetet kanë organizuar një numër të dëgjimeve publike.

Kuvendi ka kryer përgjegjësitë e tij ex ante për sa i përket buxhetit. Ka intervenuar për të siguruar mjete financiare të caktuara për institucionet e pavarura dhe ka shqyrtuar raportet për shpenzimet e tyre ex post. Kuvendi ka rritur rolin e tij në sigurimin e mbikëqyrjes për sektorin e sigurisë. Komiteti i Kuvendit për Çështje të Brendshme dhe Siguri është përgjegjës për monitorimin dhe implementimin e legjislacionit që ka të bëjë me sigurinë.

Sidoqoftë, ka pak ose aspak ndërveprim mes Qeverisë dhe Kuvendit përveç kur e para i dërgon të dytës legjislacionin. Qeveria merr pjesë në diskutimet e komiteteve të Kuvendit kur i kërkohet një gjë e tillë. Komitetet e Kuvendit shpesh i dërgojnë rekomandimet për draft ligjet pas afateve duke shkaktuar shtyrje të aprovimit të tyre. Kuvendi nuk kryen vlerësimet e rregullta të draft ligjeve për përputhshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut. Po ashtu, nuk i vlerëson gjithnjë ndikimet buxhetore të draft ligjeve. Kuvendi ka mungesë të theksuar të ekspertizës për të pasur shqyrtim efektiv dhe ka mungesë të kapacitetit për të siguruar mbikëqyrje efektive të implementimit të ligjeve. Anëtarët e Kuvendit kanë lidhje të dobëta me zonat e tyre zgjedhore dhe ka mungesë të pjesëmarrjes efektive të shoqërisë civile në procesin legjislativ.

Implementimi i Programit Punues Vjetor të Kuvendit për 2007 ka qenë ndërprerë nga fushata zgjedhore. Plani Punues Vjetor për 2008 duhet të aprovohet.

Në shtator, Kuvendi ka vendosur për të shtyrë zgjedhjen e Ombudspersonit për herë të tretë.

Në nivelin administrativ, ka mungesë të stafit të kualifikuar dhe mungesë të përfaqësuesve të komuniteteve minoritare. Boshllëqet e vazhdueshme e pengojnë punën e njësisve kryesore administrative, përfshirë edhe njësinë që është duke monitoruar standardizimin me BE-në. Kuvendi akoma nuk ka një sistem autonom të IT-së. Votimet e vetëm një sesioni plenar janë publikuar në ueb site. Komiteti për Integritet Evropian ka mungesë të mbështetjes administrative dhe ekspertizës për çështjet që kanë të bëjnë me BE-në.

Komisioni Qendror Zgjedhor edhe më tutje bazohet në mbështetjen e OSBE-së.

Përgjithësisht, Kuvendi ka bërë disa përparime në një numër fushash dhe pjesërisht ka arritur të përmbushë rolin e tij pas periudhës raportuese, e cila është karakterizuar me fokus të fuqishëm në aprovimin e kushtetutës dhe legjislacionit të afërm. Sidoqoftë, sfidat dhe të metat mbesin për t'u adresuar, me theks të veçantë mungesa e kapacitetit për të shqyrtuar draft ligjet dhe monitoruar implementimin pas aprovimit.

Qeveria

Më 9 janar 2008 është formuar koalicioni qeveritar mes Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës me kryeministër Hashim Thaçin. Qeveria përbehet nga Kryeministri dy zëvendëskryeministra dhe 17 ministra.

Qeveria e re është fokusuar në pavarësi dhe kushtetutë. Paritë politike kanë respektuar përkushtimin e tyre për të mbetur të bashkuara në periudhën mes deklaratës së pavarësisë dhe futjes në fuqi të kushtetutës. Vëmendja e tyre ka filluar të zhvendoset kur në muajin prill Qeveria prezantoi strategjinë për 2008-2011. Partitë politike opozitare kanë qëndrime më kritike ndaj qeverisë.

Qeveria ka themeluar një komision për monitorimin e implementimit të ligjeve, i cili udhëhiqet nga zëvendëskryeministri.

Në prill Kryeministri ka prezantuar para Kuvendit raportin për 100 ditët e Qeverisë dhe programin e Qeverisë për 2008-2011.

Qeveria ka filluar të lëshojë pasaportat e Kosovës në korrik.

Në shtator, Presidenti dhe Kryeministri janë pajtuar për të caktuar dhjetë përfaqësuesit e parë diplomatikë në disa prej vendeve që e kanë njohur deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Qeveria ka vazhduar të ndërtojë kapacitetet e saj për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me BE-në. Në korrik, ajo ka aprovuar struktura të reja për të mbikëqyrur më mirë çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në BE sipas kornizës së Planit për Aksion të Partneritetit Evropian. Qeveria raporton para Komisionit të Kuvendit për Integritime Evropiane çdo tre muaj. Agjencia për Integritim Evropian (AEI) vazhdon të jetë agjencia qendrore për koordinimin e përpjekjeve për afrim të Kosovës me Evropën. AEI ka filluar të ketë kontakte më të strukturuar me Kuvendin, posaçërisht për sa i përket verifikimit të përputhshmërisë së legjislacionit dhe ndjek sesionet javore të Komitetit të Kuvendit për Integritim Evropian. Në tetor, AEI është riemëruar si Qendra për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritimit Evropian (CCDEI), që reflekton ristrukturimin dhe bashkimin e saj me Qendrën për Koordinim të Donatorëve në vijim Konferenca e Donatorëve.

Qeverisja lokale është forcuar. Në qershor është futur në fuqi legjislacioni i ri për kufijtë administrativ komunal, vetëqeverisjen lokale dhe financat lokale qeveritare dhe decentralizimin. Përparimi i reformës për vetëqeverisje dhe rritja e kapacitetit administrativ për të lehtësuar decentralizimin janë prioritetet kryesore në Partneritetin Evropian për Kosovën.

Aktet legale ose ligjet e miratuara nga Kuvendi janë publikuar në *Gazetën Zyrtare*. Gazeta publikohet në dy gjuhët zyrtare të Kosovës. Po ashtu publikohet edhe në gjuhën boshnjake, turke dhe angleze në ueb sajtin e Gazetës. Gazeta shpërndahet në ministri, komuna, gjykata dhe institucione edukative.

Sidoqoftë, fokusi i qeverisë në çështjet që kanë të bëjnë me pavarësinë e ka mbajtur atë larg prej adresimit të çështjeve tjera. Qeveria është ballafaquar me disa vështirësi në prezantimin dhe koordinimin e prioritetëve të saj strategjike. Kuvendi, përfshirë anëtarët e koalicionit qeverisës, kanë kundërshtuar programin e qeverisë 2008-2011. Qeveria ka dërguar në Kuvend strategjinë e saj legjislative pa orar për dërgimin e draft ligjeve.

Qeveria nuk ka arritur të realizojë qëllimet e saj për prezantimin e komunitetit minoritar. Progresi i mëtutjeshëm në këtë fushë është penguar nga zhvillimet politike pas Deklaratës së Pavarësisë.

Në disa zona me shumicë serbe, Qeveria ka autoritet të kufizuar në polici, gjykata, dogana, transport, kufij dhe trashëgiminë serbe. Strukturat paralele administrative në nivel lokal janë konsoliduar dhe vazhdojnë të operojnë në shumicën e komunave me shumicë serbe, edhe nëse nuk janë operacionale në disa zona si jugu i lumit Ibër. Komunat në veri të Kosovës kanë filluar të implementojnë legjislacionin serb për qeverisje lokale. Një numër i qytetarëve të Kosovës mbështeten në shërbimet e tyre si, dokumentet e udhëtimit, edukimin. Në qershor, Qeveria ka vendosur të zgjerojë mandatin e kryetarëve në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Shtërpçë, duke konfirmuar vendimin e mëparshëm të UNMIK-ut për të mos i validizuar rezultatet e zgjedhjeve lokale serbe, të mbajtura në maj të vitit 2008 në Kosovë.

Rikonfigurimi i ngadalshëm i UNMIK-ut ka çuar në disa paqartësi në disa fusha si te kompetencat e qeverisë (gllabërimi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit).

Racionalizimi i metodave punuese vazhdon të jetë sfidë. Përgjegjësitë e Zyrës për Qeverisje të Mirë përkojnë me ato të Agjencionit për barazi Gjinore dhe Agjencionit Kundër Korrupsionit. Nuk është e qartë se si Zyra për Komunitete do të bashkëpunojë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Komunikimi dhe koordinimi mes administratave lokale dhe qendrore që mirren me të drejta të njeriut dhe minoriteteve nuk është efektiv.

Efektiviteti i pjesëmarrjes së qeverisë në forume regjionale dhe ndërkombëtare është i kufizuar nga fakti që legjitimiteti i saj është i kontestuar nga vendet që nuk e kanë njohur.

Deklarimet për ndërhyrje politike në përzgjedhjen dhe caktimin e një numri për pozitën e rëndësishme (bordet e ndërmarrjeve publike) kanë ndikuar në kredibilitetin e qeverisë. Lajmërimet e parakohshme për regjistrimin e popullatës dhe dorëzimi i parakohshëm në Kuvend i shqyrtimit të buxhetit të mesit të vitit, bie ndesh me dispozitat e kushtetutës.

Qarkullimi i stafit të lartë në Agjencionin për Integritet Evropian dhe mungesa e udhëheqjes strategjike rrezikon minimin e efektivitetit të saj. Posaçërisht departamenti përgjegjës për verifikimin e përputhjeve ligjore është me personel të pamjaftueshëm.

Përgjithësisht është bërë një progres në konsolidimin e qeverisë në një ambient të pasigurt e shpërthyes. Mjetet themelore për punë për një qeveri efektive janë, por ato duhet të shtohen dhe zbatohen plotësisht dhe siç duhet. Sigurimi i qeverisjes demokratike është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovën.

Administrata Publike

Grupi punues ndërinstitucional dhe grupet punuese sektorale, të ngarkuara më mbikëqyrjen dhe implementimin e Planit të Aksionit dhe Strategjisë për Reformim të Administratës Publike (për periudhën 2006-2011) takohet rregullisht.

Në shkurt, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës (IOB), më herët këshillonte PSSP-në për reformën e administratës publike, është transformuar në një trup autonom që i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Në vitin 2007, IOB ka zgjidhur 386 raste të ankesave nga punëtorët e ministrive, komunave dhe agjencioneve ekzekutive. IOB po ashtu ka mbikëqyruar 37 procedura të përzgjedhjes së shërbyesve civilë në ministri dhe komuna dhe ka shqyrtuar 71 ankesa. Deri tani, IOB ka zgjidhur 222 ankesa nga 282 sa ka pranuar deri tani në vitin 2008.

Ministria e Shërbimeve Publike ka nxjerrë ligjet implementuese që kanë të bëjnë me shërbimet civile dhe me menaxhimin e administratës publike. Këto rregullojnë shpenzimet reprezentative të institucioneve qeveritare, definojnë rrogat, të drejtat dhe detyrat e të emëruarve politik, procedurat për Komitetin për Emërime të Zyrtarëve Publik dhe rregullat për komunikime me qytetarë.

Qeveria ka aprovuar një udhëzim administrativ për të forcuar zyrat legale ekzistuese në një varg ministrish. Në shkurt është krijuar Komisioni për Implementimin e ligjeve. Po ashtu, është krijuar edhe grupi punues për racionalizimin dhe efikasizimin e legjislacionit.

Në prill ka filluar shqyrtimi funksional i administratës publike. Shqyrtimi synon zvogëlimin e kompetencave komplementare mes institucioneve dhe shtimin e efektivitetit të administratës publike. Shqyrtimi institucional vertikal është duke u konsideruar me qëllim të identifikimit të detyrave që mund të delegohen në nivelin lokal ose t'i dorëzohen sektorit privat. Është themeluar një komision ndërministror dhe grupe teknike punuese për të udhëhequr këtë proces. Aty është i përfshirë zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministri i Shërbimeve Publike. Ka filluar një projekt që synon zhvillimin e softuerit për përmirësimin e informatave dhe menaxhimin e resurseve njerëzore në shërbimin civil të Kosovës⁹.

Sidoqoftë, ligji për shërbim civil, ligji për Institutin Kosovar për Administratë Publike dhe ligji për administratë publike nuk janë aprovuar akoma. Shërbyesit civil vazhdojnë të jenë të gatshëm për ndërhyrje politike, korrupsion dhe nepotizëm. Më shumë se një vit pas aprovimit, rezultatet e Strategjisë për Reformë të Administratës Publike dhe Planit të Aksionit dhe mënyra se si rezultatet maten, janë akoma të paqarta. Prej mesit të shtatorit, katër prej shtatë pozitive për Bordin e Pavarur Mbikëqyrës janë të zbrazëta duke parandaluar kështu marrjen e vendimeve. Komiteti për Emërime të Zyrtarëve Publikë nuk është plotësisht funksional dhe sekretariati i tij duhet të fuqizohet edhe më me staf shtesë dhe trajnime.

Disa ministri dhe autoritete lokale akoma refuzojnë për të siguruar informata, t'u përgjigjen kërkesave ose të ndjekin rekomandimet e zyrës së Ombudspersonit. Staf i zyrës së Ombudspersonit është reduktuar prej 56 në 45.

Përgjithësisht, edhe përkundër njëfarë progresit që ka të bëjë me aprovimin e një plani të veprimit dhe disa ligjeve, reforma e administratës publike patjetër duhet të implementohet. Aktet më të rëndësishme legale mbesin për t'u aprovuar. Administrata publike dhe kapaciteti koordinues i trupave publikë në Kosovë vazhdon të jetë i dobët. Garantimi i shërbimeve civile për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe krijimi i një administrate publike profesionale, të përgjegjshme, të qasshme dhe përfaqësuese është prioritet kryesor i Partneritetit Evropian për Kosovë.

Sistemi i drejtësisë

Ministria e Drejtësisë vazhdon të forcojë kapacitetin e saj administrativ. Ajo ka hartuar një numër të konsiderueshëm të akteve të reja legjislative në përputhje me programin e saj për reformë legale. Këshilli Koordinues për Sundim të Ligjit i themeluar në tetë të vitit 2007 ka filluar të funksionojë. Ky këshill përbëhet nga ministri dhe agjencione nga fusha e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

⁹ Pritet që projekti të përfundojë në fund të vitit.

Njësia për hetime gjyqësore nën përgjegjësinë e UNMIK-ut vazhdon të shqyrtojë ankesat për sjellje të këqija të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vitin 2008 janë pranuar gjithsej 164 raste dhe janë në proces 73 hetime të reja. Njësia për Hetime Gjyqësore ka gjetur sjellje të këqija në 87 raste dhe i ka dërguar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Në janar të vitit 2008, është aprovuar statuti i Institutit Gjyqësor të Kosovës. Në mars, ky institut ka aprovuar Planin Strategjik 3 vjeçar.

Kuvendi ka miratuar këto ligje në periudhën mars-maj 2008: Ligji për Juridiksion, Përzgjedhje dhe Caktim të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; Ligji për Persekutim Special; Ligji për Plotësim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës; Ligji për Plotësim të Kodit të Procedurës Kriminale dhe Ligji për Procedurë **Out Contentious**.

Kosova po bashkëpunon mirë në kuadër të kornizës të Bordit Koordinues për Sundim të Përbashkët të Ligjit dhe merr pjesë në takimet e tij mujore.

Sidoqoftë, të metat e gjyqësorit vazhdojnë. Ministria e Drejtësisë akoma ka resurse humane dhe teknike shumë të kufizuara. Akoma te qytetarët ekziston një nivel shumë i ulët besimit për gjyqësorin. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese dhe mundësia e sigurimit jo të rregullt të Gazetës Zyrtare në sistemin gjyqësor e vështirëson sigurinë legale në Kosovë. Ky problem rëndohet me ekzistencën e vazhdueshme të tri burimeve paralele të legjislacionit (ligjit ish-jugosllav, rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjeve të Kosovës të miratuara pash shpalljes së pavarësisë). Në Kosovë nuk ka kompilim dhe trajtim të vendimeve gjyqësore.

Shqyrtimi i rasteve të trazirave të marsit 2004 ka vënë në pah të metat e vazhdueshme për sa i përket prokurorëve, gjykatave dhe dëshmitarëve. Sistemi i drejtësisë ka dështuar në dërgimin e një mesazhi të qartë dhe të fuqishëm se dhuna etnike nuk do të tolerohet në Kosovë. Përndjekja e fuqishme e të gjitha krimeve ndëretnike është prioritet kryesor për Partneritetin Evropian për Kosovën.

Mbrojtja e dëshmitarëve vazhdon të jetë e dobët, për të mos thënë se nuk ekziston, posaçërisht për sa i përket krimeve të luftës. Rastet e krimeve të luftës trajtohen nga një numër i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të moshuar. Shumë raste që kanë të bëjnë me krime lufte nuk i janë dërguar prokurorisë. Një dënim për krime lufte është shqiptuar në maj të vitit 2008. Shtatë procese gjyqësore për krime lufte që përfshijnë 14 të akuzuar janë duke u zhvilluar dhe 51 raste të tjera janë nën hetime fillestare.

Për shkak të madhësisë së Kosovës, ndërtimit shoqëror “close-knit” dhe mundësive të kufizuara për zhvendosjen e dëshmitarëve jashtë Kosovës, disa dëshmitarë janë të gatshëm të marrin pjesë në rastet sensitive sikurse që janë ato për krimet e luftës. Akoma nuk ka ligj të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili do t'i vendoste procedurat për zhvendosjen e dëshmitarëve në rastet më serioze kriminale.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nuk është aprovuar akoma. Dispozitat kushtetuese i japin Kuvendit të drejtë të caktojë tetë nga trembëdhjetë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kjo nuk është në përputhje me standardet evropiane për pavarësinë e gjyqësorit prej ekzekutivit dhe legjislativit. Sistemi disiplinues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i ngadalshëm dhe vendimmarrja nuk mbikëqyret gjithnjë. Deri tani, 57 raste disiplinuese janë duke pritur për t'u procesuar nga dy komitetet disiplinuese të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Puna e pabërë e rasteve vazhdon të jetë problem serioz posaçërisht në masat civile. Të dhënat e disponueshme nuk sigurojnë pasqyrë të qartë për punët e pabëra. Ka konfuzion mes punëve të pabëra dhe rasteve të pezulluara. Në fillim të tetorit, shumica e rasteve të pazgjidhura para gjykatave komunale të Kosovës ka qenë 160,477. Nuk ekziston sistem operacional për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Për më shumë, mbi 36,000 raste kriminale janë pezulluar. Zgjedhja alternative e mosmarrëveshjeve, siç është ndërmjetësimi, nuk është implementuar akoma. Gjykatat Komunale, bashkë me policinë, nuk kanë kapacitet për të adresuar, parandaluar dhe sanksionuar okupimet ilegale, përdorimin dhe ndërtimin e pronës në mënyrë të drejtë.

Korniza legjislative është akoma e pakompletuar. Nuk ka ligje në fushat si vijon: noteri, procedurë ekzekutive, ndjekje penale, gjykata, gjykatë kushtetuese dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës. Strategjia për reformën e sistemit gjyqësor nuk përfshin një plan gjithëpërfshirës për të efektivizuar të tri burimet e legjislacionit dhe për të krijuar siguri legale. Gjykatat paralele që zbatojnë ligjet serbe vazhdojnë të funksionojnë.

Themelimi i shkollës për gjykatës dhe korigjimi i procesit në sistemin gjyqësor kanë siguruar për juristët e rinj një mundësi për t'u bërë gjyqtarë dhe prokurorë. Sidoqoftë, funksionet e reja në sistemin gjyqësor mbesin të kufizuara.

Sistemi gjyqësor ballafaqohet me sfida serioze për sa i përket aspektit të resurseve njerëzore dhe organizative. Transferimi i gjyqtarëve prej gjykatave me punë modeste te ato të mbingarkuara ngjan shumë rrallë. Numri i gjyqtarëve është akoma i pamjaftueshëm. Rrogat në gjyqësi nuk janë ngritur që nga vitit 2002. Gjyqtarët nuk janë të pajisur me sigurim shoqëror. Nuk ligj që i përcakton kriteret për përparim profesional. Mosha mesatare e gjyqtarëve është e lartë. Prej vitit 2002, nuk është rekrutuar pothuajse asnjë gjyqtar ose prokuror i ri. Vendet e lira janë plotësuar përmes zhvendosjes. Sistemi i caktimit, shkarkimit dhe promovimit në karrierë për gjyqtarët dhe prokurorët sikurse parashohin standardet evropiane pa ndërhyrje politike duhet të përhapet dhe zbatohet.

Mbledhja e të dhënave në gjykata është e dyshimtë. Sistemi i ri i menaxhimit të rasteve duhet të bëhet më efektiv. Gjykatat dhe zyrat e prokurimit nuk kanë kompetenca buxhetore për prokurimin e gjërave të vogla në zyra, të cilat vështirësojnë aktivitetet e zakonshme. Nuk ka një ndarje të qartë mes gjyqtarëve që merren me çështje penale ose civile. Gjyqtarët shpesh merren me të dyja. Nuk ka gjykata administrative të specializuara. Kriteri për transferimin e rasteve mes gjykatave komunale dhe atyre të qarkut kontribuon në mbingarkim të gjykatave të qarkut. Brenda gjykatave, rastet e

transferimit nuk ndjekin kriterin objektiv dhe transparent. Implementimi i Kodit të Etikës është i dobët.

Kapaciteti i prokurorisë për të drejtuar hetimet në përputhje me parimet e autonomisë dhe paanshmërisë është i kufizuar. Aktualisht, vetëm gjashtë prej dhjetë prokurorëve të angazhuar në Zyrën e Prokurorëve Special të Kosovës (KSPO) janë duke punuar: kjo e dhënë nuk është ndryshuar nga vitit 2007. Zyrat e Prokurorisë janë pa staf dhe kanë mungesë të mundësive për të hetuar. Të akuzuarit duhet të presin mesatarisht 1 deri në 1.5 vite para se të fillojnë gjykimet ndaj tyre dhe kushtet në burg për të arrestuarit që nuk u janë shqiptuar dënimet janë të pakënaqshme. Mungesa e specializimit të prokurorëve është një pengesë serioze në luftën kundër krimit të organizuar, si pastrimi i parave ose trafikimi i qenieve njerëzore, i cili është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovë. Bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë publike është i varfër dhe i pa efekt.

Gjykata Supreme është institucioni i vetëm legal i specializuar për shqyrtimin e akteve administrative. Sidoqoftë, ajo ka vetëm dy gjyqtarë dhe më shumë se 2,000 raste janë pezulluar. Ekzistojnë shqetësime për sa i përket mundësisë për të kërkuar shqyrtim gjyqësor të akteve administrative.

Përgjithësisht, sistemi gjyqësor mbetet i dobët në të gjitha nivelet. Ka pasur pak progres gjatë periudhës raportuese.

Politika anti-korrupsion

Korrupsioni është akoma i përhapur dhe mbetet problem kryesor në Kosovë. Kjo është për shkak të mungesës së masave legjislative dhe implementuese dhe mungesës së vendosmërisë dhe dobësisë së sistemit gjyqësor. Mbetet të aprovohen strategjia anti-korrupsion dhe plani i veprimit. Ndjekja e politikës zero tolerancë ndaj korrupsionit është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovën.

Ligji për Parandalimin e Konfliktëve të Interesit ka hyrë në fuqi. Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Deklarimin e Origjinës së Pasurisë për Zyrtarët Publikë. Kuvendi akoma nuk ka aprovuar draftin final të ligjit për deklarimin e aseteve.

Në mars të vitit 2008, Agjencioni Kosovar Kundërkorrupsionit ka dorëzuar në Kuvend raportin e tij të parë vjetor. Në fund të shtatorit, AKK ka dorëzuar 35 raste të ndjekjes, të cilat kanë çuar në nisjen e shtatë proceseve penale.

Në fushën e konfliktit të interesit, AKK ka intervenuar në 9 raste prej muajit janar deri në qershor 2008 dhe në katër raste tjera prej korrikut deri në shtator. Në prill të vitit 2008 agjencioni ka publikuar një listë të zyrtarëve të cilët nuk i kanë dërguar asetet e tyre. Në gusht agjencioni ka kërkuar nga institucionet që ndaj 17 që nuk kanë deklaruar asetet e tyre të fillohet procedura e shkarkimit. AKK ruan konfidencialitetin e denoncimeve.

Sidoqoftë, korrupsioni është akoma i përhapur dhe minon funksionimin e duhur të institucioneve. Raporti i fundit prej zyrës së auditorit gjeneral tregon humbje të

pashpjegueshme të buxhetit të Kosovës prej 0.5-5 milion euro në ministri për vit. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet implementimit të kornizës ekzistuese legale. Zyrtarët që nuk kanë deklaruar pasurinë e tyre duhet të dënohen në përputhje me ligjin.

Korniza institucionale për të ndaluar korrupsionin është akoma e paqartë. Grupi Punues Ndërmintor Kundër-korrupsionit akoma nuk është operacional. Mandati i Këshillit Kundërkorrupsion dhe roli i tij vis a vis AKK-së mbetet i paqartë dhe përbërja e tij (stafi nëntë vetësh përfshirë përfaqësuesin prej Zyrës së Kryeministrit dhe përfaqësuesin prej Zyrës së Presidentit) nuk garantojnë mjaftueshëm paanshmërinë e tij politike.

Caktimi i përgjegjësive mes AKK-së dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë, kryesuesi i së cilës është zëvendës kryesues i Këshillit Kundër-korrupsionit, ka çuar në mosmarrëveshje. Bashkëpunimi me zyrën e Ombudspersonit mbetet i dobët. Trajnimi i siguar për zyrat e prokurimit të ministrive është jo i rregullt.

Korniza legale ka nevojë të përmirësohet edhe më për të ndrequr dallimet mes ligjit aktual kundër korrupsionit dhe kodit penal për definimet e korrupsionit. Nuk ka ligj për menaxhimin e asetëve të sekuestruara dhe të konfiskuara. Implementimi i ligjit për qasje në dokumentet zyrtare duhet të përmirësohet. Zhvillimi i planit sektoral të veprimit për të luftuar korrupsionin dhe ngritur vetëdijen brenda administratës publike dhe shoqërisë civile për korrupsionin është i vonuar.

Përgjithësisht, edhe përkundër njëfarë progresi, korrupsioni mbetet i përhapur dhe përbën problem serioz.

2.2. Të drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Observimi i ligjit për të drejtat ndërkombëtare të njeriut

Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale dhe liston marrëveshjet kryesore ndërkombëtare dhe instrumentet drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë. Në rast konflikti këto të fundit kanë përparësi mbi ligjet lokale.

Kuvendi ka themeluar një Komitet për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione për të shqyrtuar draft ligjin dhe për ta rregulluar me legjislacionin ndërkombëtar dhe të BE-së për të drejtat e njeriut.

Njësitë për të drejtat e njeriut janë vendosur në komuna për të siguruar monitorimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal. Ato i plotësojnë njësitë për të drejtat e njeriut në nivel ministror. Sidoqoftë, trajnimi për stafin relevant duhet të intensifikohet për të përmirësuar koordinimin. Mekanizmat monitorues nuk janë akoma efektiv.

Disa gjyqtarë në Kosovë janë trajnuar për ligjet zakonore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kanë filluar t'u referohen atyre.

Paneli Këshillues i të Drejtave të Njeriut i themeluar për të adresuar boshllëkun në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe shqyrtuar ankesat për shkeljet e të drejtave të njeriut nga UNMIK-u, ka mbajtur sesionin e tij përrues në nëntor të vitit 2007. Rregullat e tij të procedurës janë aprovuar në shkurt 2008. Paneli aktualisht është duke shqyrtuar një numër të rasteve, disa prej të cilave i janë referuar PSSP-së në përputhje me dispozitat e rregullores 2006/12. Në mars të vitit 2008 paneli ka lansuar një fushatë informuese për të promovuar mandatin e tij.

Sidoqoftë, për shkak të pezullimit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, qytetarët nuk kanë mundësinë për të paraqitur ankesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shans e fundit.

Për sa i përket promovimit dhe forcimit të të drejtave të njeriut, kapacitetet monitoruese në Parlament, qeveri, dhe shoqëri civile janë shumë të kufizuara, posaçërisht për sa i përket të drejtave pozitive si edukimi, shëndetësia dhe punësimi. Për sa i përket kompensimit, qytetarët e Kosovës i dorëzojnë lëndët në zyrën e Ombudspersonit. Sidoqoftë, amandamentet në Ligjin për Ombudspersonin që kanë për qëllim forcimin e zotësisë së Ombudspersonit për të mbikëqyrur shkeljet potenciale të të drejtave të njeriut në vendimet e gjykatave, nuk janë aprovuar akoma. Shumica e rekomandimeve të zyrës së Ombudspersonit në Qeveri nuk janë marrë parasysh.

Strategjia e Qeverisë dhe Plani i Aksionit për të Drejtat e Njeriut nuk janë aprovuar akoma.

Përgjithësisht, edhe përkundër njëfarë progresi institucional dhe legjislativ, akoma ka mungesë të kapacitetit për të implementuar dhe për të përmirësuar standardet e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Të drejtat civile dhe politike

Sa i përket parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndëshkimit, raporti i vitit 2007 i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës nuk është bërë publik ende.

Raporti i vitit 2007 i Inspektoratit të Policisë nënvizon nevojën për të reformuar kornizën legale për përdorim të forcës nga policia dhe mangësitë që kanë të bëjnë me çuarjen deri në fund të ankesave kundër policisë. Korniza legale është përmirësuar mjaftueshëm përmes aprovimit të Ligjit për Inspektoratin e Policisë së Kosovës. Njësitë Standarde Profesionale shqyrtojnë kundërvajtjet e supozuara procedurale ose minore nga shtabet e Policisë së Kosovës dhe shtabet regjionale. Në Kosovën Veriore kjo është bërë nën përkujdesjen e UNMIK-ut. Inspektorati i policisë, i cili është i pavarur, por i raporton Ministrin të Brendshëm, është përgjegjës për ankesat rreth kundërvajtjeve kryesore, përfshirë ato që ndodhin në qendrat policore të ndalimit. Proceset gjyqësore ndaj të arrestuarve të rinj në praktikë mund të marrin më shumë se një vit. Departamenti i resurseve njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë është trupi kryesor që merret me ankesat për keqtrajtimet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit.

Komisioni për Personat e Pagjetur ka vazhduar procesimin e rasteve. Mes tetorit 2007 dhe shtatorit 2008, janë iniciuar 46 ekshumime nga Zyra për Persona të Pagjetur dhe eshtrat e 62 personave janë gjetur dhe transferuar për autopsi dhe identifikim. Prej tetorit 2007, Komisioni ka pranuar 150 raporte pozitive të ADN-së në lidhje me 102 persona dhe ka kthyer eshtrat e 118 personave të identifikuar te familjet e tyre. Delegacioni i Kosovës për personat e pagjetur ka vazhduar rregullisht aktivitetet e tij të koordinuara me Delegacionin e Serbisë dhe të afërmit e personave të pagjetur. Zhvillimet për sa i përket personave të pagjetur janë të ngadalta për shkak të mungesës së transparencës prej autoriteteve për sa i përket vendodhjes së varezeve dhe vështirësive në identifikimin e eshtrave. Numri i përgjithshëm i personave të pagjetur është 1,940.

Përgjithësisht, parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit dhe lufta kundër mosndëshkueshmërisë ka shënuar progres të kufizuar.

Në fushën e **qasjes në drejtësi**, sistemi për ndihmë juridike tani është operativ; ai përbëhet nga Komisioni për Ndhimë Juridike, i cili ka qenë operativ prej shtatorit të vitit 2007, Zyres Koordinuese për Ndhimë Juridike dhe pesë Zyra të Qarkut për Ndhimë Juridike me një staf prej 21 personash, përfshirë 13 juristë dhe tre pjesëtarë të stafit prej komuniteteve jo-shumicë.

Mes janarit dhe qershorit të vitit 2008, Komisionet e Distrikteve për Ndhimë Juridike kanë ndihmuar 534 persona me ndihmë juridike, përfshirë 256 raste juridike administrative, 214 raste civile dhe 64 raste kriminale. 9% e kërkesave kanë qenë prej anëtarëve të komuniteteve minoritare dhe 37% prej femrave. Kërkuesve ose u është siguruar ndihmë juridike nga zyrtarët legalë prej zyrave të distrikteve ose janë dërguar atyre që kërkojnë klientë për rastet ku kërkohet përfaqësim në gjykatë për çështjet civile dhe administrative. Përgjegjësia për përfaqësimin në gjykatë të kërkuesve për sa i përket çështjeve kriminale, i takon gjykatës. Asociacioni i Avokatëve ka themeluar një program trajnues për avokatët e involvuar në ndihmën juridike.

Sidoqoftë, zyrat janë kryesisht të vendosura larg prej gjykatave dhe në zona të largëta prej qyteteve kryesore, gjë që e bën të vështirë qasjen në drejtësi për të gjithë qytetarët. Ekzistenca e tyre është pak e ditur në mesin e popullatës dhe gjyqtarëve.

Performanca e avokatëve në gjykata nuk i plotëson gjithnjë standardet minimale. Asociacioni i Avokatëve nuk merr përkujdesje të mjaftueshme institucionale. Avokatët shpesh refuzojnë kërkesat për ndihmë juridike, duke e thyer kështu Kodin e tyre të Etikës. Serbët e Kosovës nuk punojnë në Komisionin për Ndhimë Juridike. Ministria e Drejtësisë akoma nuk e ka caktuar drejtorin për departamentin e saj për të drejta civile. Trajtimi i kërkesave për ndihmë juridike në rastet kriminale dhe kërkesat për ekstradim nuk i plotësojnë standardet ndërkombëtare.

Përgjithësisht, njëfarë progresi është arritur. Sistemi për ndihmë juridike është funksional por kërkon mbështetje të mëtutjeshme për të gjitha komunitetet për të përmirësuar qasje në drejtësi për të gjithë.

Raporti mes të burgosurve dhe stafit të burgut është korrekt. Kushtet e jetesës për të dënuarit, kujdesi shëndetësor dhe trajtimi ndaj tyre nga ana e Shërbimi Korrektues i Kosovës janë korrekt.

Sidoqoftë, siguria në disa qendra korrektuese dhe të parandalimit është e dobët. Kjo është posaçërisht e vërtetë për burgun me siguri të lartë të Dubravës. Edhe përkundër lëshimit të një raporti për ikje prej burgut të Dubravës në gusht të vitit 2007, përpjekja për të adresuar të metat ka qenë e kufizuar.

Nevojat për riintegrim të të burgosurve nuk merren në konsideratë. Aty janë po ashtu disa lehtësime për të burgosurit e moshës së re ose për personat me aftësi të kufizuara mendore. Lehtësitë për ata që i takojnë moshës së re nuk nënkuptojnë dhënie të përparësisë për edukim, trajtim profesional dhe përkujdes pas lirimt.

Nuk ka plan për bashkëpunim ndërkombëtar për të lehtësuar transferimin e të arrestuarit kosovarë nga vendet e BE-së.

Përfaqësimi i minoriteteve në stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës është zvogëluar pas dorëheqjeve që kanë pasuar pas shpalljes së pavarësisë. Të gjithë serbët e dënuar të Kosovës janë duke i kryer dënimet e tyre në qendrën e burgimit në Mitrovicë, e cila nuk është e përshtatshme për burgim afatgjatë.

Përgjithësisht, sistemi ndëshkëimor në Kosovë është funksional, por mbesin sfida serioze për sa i përket planifikimit strategjik dhe standardeve të sigurisë.

Në fushën e lirisë së shprehjes, nuk është evidentuar gjuhë e urrejtjes në mediat e shtypura dhe elektronike gjatë periudhës raportuese. Këshilli i Pavarur i Mediave të Shtypura është duke funksionuar në mënyrë korrekte.

Sidoqoftë, shpifja mbetet vepër kriminale sipas Kodit të Procedurës Kriminale, i cili është akoma valid.

Ekziston presion politik mbi mediat. Gazetarët nga komunitetet e minoriteteve ankohen për qasje të vështirë në institucionet e Kosovës, gjë që e pengon punën e tyre.

Komisioni i Pavarur i Mediave për televizion dhe radio akoma ballafaqohet me kufizime të mëdha buxhetore, gjë që e vështirëson funksionimin e tij themelor, efektivitetin dhe mundësinë për të rekrutuar staf të kualifikuar. Komisioni i Pavarur i Mediave nuk konsultohet sistematikisht për çështjet relevante brenda mandatit të tij.

Përgjithësisht, liria e të shprehurit mbetet fragjile. Korniza relevante institucionale nuk është plotësisht funksionale. Mediat vazhdojnë t'i ekspozohen kërcënimeve politike.

Ligji për Lirinë e Mbledhjes në organizata joqeveritare nuk është nxjerrur akoma. Kuvendi nuk e ka shqyrtuar akoma Ligjin për Mbledhje Publike dhe ligji nuk është nxjerrur akoma.

Liri e krijimit të shoqatave dhe e tubimeve është e garantuar me kushtetutë, por korniza relevante legale nuk ekziston.

Më shumë se 4,600 organizata të shoqërisë civile janë regjistruar në Ministrinë e Shërbimeve Publike, shumica e të cilave janë lokale. 529 NGO të regjistruara janë aktive në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe 17 prej tyre kanë staf multietnik. Njësia për regjistrim të NGO-ve dhe ndërlidhje në Ministrinë e Shërbimeve Publike është duke monitoruar 280 organizata të shoqërisë civile që kanë status publik përfitues dhe që janë të parapara për ndihmë financiare prej buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Disa NGO vazhdojnë të jenë aktive në ndërtimin e urave mes komuniteteve. Përpjekje domethënëse janë duke u bërë për të transferuar ekspertizë prej NGO-ve ndërkombëtare në ato lokale përmes partneritetit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për themelimin dhe funksionimin e NGO-ve lokale.

Sidoqoftë, shumica e organizatave të shoqërisë civile janë të vogla dhe varen kryesisht nga donacionet e huaja. Kjo do të thotë se agjenda e shoqërisë civile kryesisht është e dirigjuar nga donatorët. Qeveria nuk ka një qasje strategjike për ndërveprim me organizatat e shoqërisë civile.

Përgjithësisht, shoqëria civile mbetet e dobët.

Zyra për Qeverisje të Mirë dhe njësitë për të drejtat e njeriut në kuadër të komunave janë të mandatuara për të monitoruar implementimin e Ligjit për Lirinë e Religjionit, i cili është prioritet kryesor për Partneritetin Evropian për Kosovën. Zyra për Qeverisje të Mirë ka përgatitur një manual për ligjin, i cili është publikuar në pesë gjuhë në shtator të vitit 2008. Një katedrale katolike është duke u ndërtuar në qendër të Prishtinës. Policia ka hartuar një direktivë operationale të titulluar “Siguria e Objekteve të Trashëgimisë Kulturorë dhe Religjioze”. Janë zgjidhur shumica e rasteve që kanë të bëjnë me incidentet lidhur me trashëgiminë kulturore e religjioze mes nëntorit 2007 dhe marsit 2008.

Sidoqoftë, ndërtimi dhe përdorimi vendeve të kultit ka shkaktuar tension. Ligji për Lirinë e Religjionit, është në kontradiktë me disa dispozita të Ligjit për Edukim dhe ka çuar deri te ankimet për sa i përket lirisë së religjionit në shkolla. Takimet e përgjithshme mes komuniteteve religjioze në Kosovë nuk janë mbajtur në dy vitet e fundit. Disa liderë religjioz hapur kanë përkrahur parti ekstremiste gjatë fushatave zgjedhore. Përndjekja e shkatërruesve të objekteve religjioze në mars të vitit 2004 ka vazhduar, por ka pasur shtyrje dhe dënimet nuk kanë reflektuar gjithnjë motivin etnik si një faktor keqësues.

Përgjithësisht, liria e religjionit është e garantuar në Kosovë, por duhet bërë më shumë për të përparuar pajtimin.

Të drejtat ekonomike dhe shoqërore

Në fushën e të drejtave të grave, qeveria ka aprovuar Programin për Barazi Gjinore 2008-2013, i cili identifikon objektivat, politikat dhe institucionet e angazhuara në implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Në qershor, qeveria ka dorëzuar një raport për Profilin Gjinor të Kosovës në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas duke mbuluar periudhën 1999-2007. Agjencioni për Barazi Gjinore ka rritur kapacitetin e tij dhe punën koordinuese në nivel qendror me zyrën e Ombudspersonit dhe zyrtarëve për barazi gjinore në kuadër të ministrive.

Sidoqoftë, dhunimi i të drejtave të grave është i shpeshtë. Kosova mbetet burim, pikë kalimi dhe destinim i trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo është po ashtu e prekur nga trafikimi i brendshëm. Nuk ka dokumente për strategjinë ose mekanizma legjislativ për të adresuar dhunën e brendshme. Nuk ka resurse për strehim dhe duhet bërë strehime të përshtatshme dhe afatgjata për viktimat. Mandati plotësues i AGE dhe OGG parandalon përkrahimin e qartë të përgjegjësive dhe përdorimit efektiv të resurseve të pakta dhe minon rezultatet e synuara të politikave gjinore. Shefi ekzekutiv i AGE nuk është caktuar akoma. AGE nuk ka as bazë të të dhënave as qendër të resurseve. Zyrtarët e barazisë gjinore në ministri dhe në komuna nuk janë gjithnjë funksional. Nuk ka koordinim të trupave që merren me barazi gjinore dhe nuk ka promovim publik të barazisë gjinore. Përfaqësimi i barabartë mbetet sfidë për të nivelet; qëllimi që minimumi 40% të jenë femra, siç thotë Ligji për Barazi Gjinore, nuk është plotësuar akoma.

Përgjithësisht, implementimi i Ligjit për barazi Gjinore dhe trajtimi i dhunës së brendshme kërkon resurse plotësuese.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve, Plani Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës është duke u përgatitur. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përfunduar Strategjinë Shkollore për Promovim të Shëndetit për 2008-2017. Treqind fëmijë romë, ashkali dhe egjiptianë janë regjistruar për herë të parë në dhjetë shkolla-pilote në shtatë komuna përmes angazhimit të prindërve dhe implementimit të planeve komunale të veprimit për integrimin e tyre në sistemin lokal arsimor. Zyra për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës është themeluar si pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e shërbimeve për kujdesin shëndetësor ndaj fëmijëve. Vdekja e fëmijëve të posalindur është duke rënë. Në nivelin komunal, janë caktuar koordinatorët e të drejtave të fëmijëve. Në sektorin e drejtësisë, është themeluar një Komitet Drejtues për Drejtësi për të Rinjtë dhe udhëzimet dhe standardet për drejtësi për të rinjtë janë zhvilluar dhe përhapur për të zhvilluar aftësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sidoqoftë, mbrojtja e fëmijëve mbetet e dobët; ndarja buxhetore për edukim, përkujdesje dhe zhvillim të përgjithshëm të fëmijëve është e ulët. Nuk ka monitorim të masave të veçanta të përkujdesjes në Kodin për Drejtësi për të Rinjtë dhe mekanizmi i pasaktë i raportimit për respektimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës e minon përgjegjësinë. Komiteti ndërministror për të drejtat e fëmijëve, i krijuar në maj të vitit 2007, nuk është takuar akoma. Plani Nacional për të Drejtat e Fëmijës nuk është finalizuar akoma. Përfshirja e fëmijëve të marginalizuar, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara, mbetet sfidë e konsiderueshme për institucionet lokale. Një numër i konsiderueshëm i fëmijëve

nuk kanë dokumente për regjistrimin e lindjes, posaçërisht komunitetet rome, ashkali dhe egjiptianë. Trafikimi i fëmijëve dhe puna e fëmijëve vazhdon. Vetëdija e fëmijëve për shërbimet ekzistuese shoqërore është e vogël. Koordinimi dhe shpërndarja e përgjegjësive për shërbimet shoqërore mes komunave dhe institucioneve qendrore nuk lejon implementimin adekuat të të drejtave të fëmijëve. Mungesa e investimeve në zhvillimin e hershëm të fëmijërisë rezulton me nivelin më të ulët në rajon të ndjekjes së parashkollimit. Integrimi në shkolla i fëmijëve me nevoja të veçanta është i pamjaftueshëm. Zhvillimi i pakontrolluar urban e kërcënon sigurinë e fëmijëve.

Në fushën e personave me të meta dhe/ose personave me aftësi të kufizuara, akoma nuk ka strategji për personat me aftësi të kufizuara. Të dhëna të sakta statistikore për personat e paaftë fizikisht ose mentalisht nuk ekzistojnë.

Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk është funksional. Konsultimet me Organizatën e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara në Kosovë kanë qenë të pjesshme dhe të fragmentuara. Dy qendrat për rehabilitim fizik nuk menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë. Njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të paguajnë për shërbimet rehabilituese që ata marrin. Ka mungesë të lehtësimeve për personat e sëmurë mentalisht, dhe personave të varur nga droga dhe alkooli. Ka mungesë të karrocave për invalidë, patericave, aparateve higjienike dhe aparateve të dëgjimit.

Përgjithësisht, pak progres është bërë në këtë fushë. Integrimi dhe mbrojtja e grupeve me të meta dhe aftësi të kufizuara nuk është siguruar. (*Shih po ashtu Punësimi dhe Politikat Sociale*)

Njësitë për të drejtat e njeriut në ministri kanë marrë trajnime të mëtejshme dhe kanë organizuar sesione informative për Ligjin Kundër Diskriminimit. Krijimi i një shoqërie të lirë prej diskriminimit është një nga prioritetet kryesore të Partneritetit Evropian për Kosovën. Duke konfirmuar dispozitat e ligjit, kushtetutës, po ashtu, ligji kundër diskriminimit përkujdeset për njerëzit që diskriminohen për shkak të orientimit të tyre seksual. Trajtimi policor i keqtrajtimit të motivuar nga homofobia është përmirësuar pas trajnimit të zyrtarëve policorë komunalë për LGBT (lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transgender. Nuk ka tension ndëretnik mes komunitetit LGBT.

Sidoqoftë, ka pak progres për të raportuar në lidhje me implementimin e ligjit. Kapaciteti i njësive për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe komunal është i vogël. Bashkëpunimi mes qeverisë dhe zyrës së Ombudspersonit duhet të përmirësohet. Komunikimi mes trupave qendror dhe lokal është gjithashtu i rrallë për të hetuar shkeljet e mundshme të ligjit. Njerëzit që jetojnë në zonat rurale dhe komuniteti LGBT nuk janë të informuar për ligjin. Homofobia është akoma e përhapur në publik dhe në media. Dënimet për ngacmime homofobike nuk e specifikojnë ngacmimin si motiv të dënimit.

Përgjithësisht, mund të raportohet progres i vogël në implementimin e ligjit për anti diskriminim.

Për sa i përket të drejtave pronësore, të cilat janë prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovën, Kuvendi ka miratuar ligjin për trajtimin e ndërtimeve ilegale. Komisioni i Kosovës për Ankesa Pronësore ka filluar punën në mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Pronë. Agjencia Kosovare për pronë ka regjistruar 39, 683 ankesa. Në maj të vitit 2008, UNMIK ka lëshuar një urdhër, i cili liron pronarët e ligjshëm të pronës nga pagimi i faturave të lëshuara gjatë periudhës së okupimit ilegal të pasurisë ose kur dikush që shfrytëzon me qira një pronë dështon të paguajë faturat e tilla. Skema e marrjes me qira të një prona të braktisur në Kosovë e lejon pronarin e ligjshëm të pronës të pranojë të hyra të caktuara nga prona duke e autorizuar AKP-në për ta lëshuar pronën me qira për periudhën përcaktuar. Anëtarët e ri nj të Bordit Mbikëqyrës të AKP-së janë caktuar. Bordi duhet të finalizoj procedurën për të bërë kalkulimin dhe kushtet e kompensimit për ankesë të suksesshme pronësore.

Në qershor, është aprovuar ligji për të plotësuar rregulloren për ankesat pronësore, transferimin e kompetencave të UNMIK-ut për AKP-në te autoritetet e Kosovës dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Sidoqoftë, shumë persona të zhvendosur janë duke pritur për restituim të pronës rezidenciale, bujqësore ose komerciale. Ligji për Eksproprijim dhe Ligji për Arbitrim janë aprovuar në vitin 2007, por nuk janë promulguar nga PSSP-ja. Draft ligji për shitjen e banesave kur ekzistojnë të drejtat e zotërimit ka kaluar leximin e parë në shkurt të vitit 2008, por, duhet të plotësohet për të parandaluar shpronësimin e paligjshëm. Paneli i Gjykatës Supreme, i cili është përgjegjës për të vendosur për ankesat që kanë të bëjnë me Komisionin Kosovar për Ankesa Pronësore, akoma nuk është caktuar. Urdhri i UNMIK-ut i majit 2008 nuk i prek të gjithë pronarët e ligjshëm të pronës. Pas aprovimit të ligjit në qershor, qeveria e Serbisë ka vendosur t'i suspendojë zyrat e AKP-së në Beograd, Kragujevc dhe Nish. Kjo e vë në rrezik rezolutën për ankesa pronësore, të iniciuar nga serbët e Kosovës.

Implementimi i skemës rentale është akoma i pakënaqshëm. Prej 4,338 pronave të menaxhuara nga KPA, më shumë se 2,500 janë të përfshira në skemën rentale. Marrëveshjet rentale për më shumë se 940 prona janë nënshkruar deri tani, por pak rentë është mbledhur në të vërtetë. Aktualisht janë 706 raste për dëbim për arsye të qirasë, e që janë pezulluar dhe afërsisht 40 dëbime janë kryer për çdo javë. Ka akoma konfuzion për sa i përket bartjes së rasteve prej KPA-së në gjykatat lokale.

Mungesa e përhapur e njohurisë për lejet e ndërtimit dhe sistemin e planifikimit urban ndikon po ashtu në të drejtat pronësore. Masa ekspropriuese të ndërmarra nga komunat, të cilat lejojnë ndërtimin e infrastrukturës publike rrallë janë në përputhje me procedurat zyrtare dhe komunat shpesh dështojnë për të informuar ose kompensuar pronarët e pronave.

Autoritetet komunale në Mitrovicë i konsiderojnë dy zonat e dikurshme rezidenciale në Mahallën e Romëve si pronë publike, gjë që po e shtyn procesin e rregullimit dhe kthimit.

Departamentet e Kadastrës në komunat e Kosovës kanë mungesë të dokumentacionit për pronat dhe arkivat nuk janë harmonizuar, gjë që rezulton me komplikime për verifikimin e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe shqiptarëve të Kosovës. NGO-të që janë duke punuar në projektet që kanë të bëjnë me kthimin arrijnë të sigurojnë dokumente prej Serbisë dhe të reregjistrojnë pronën në kadastrat e Kosovës, por kjo nuk mund të bëhet nga personat që nuk kanë asistencë. Plani i Veprimit për Marrëveshjet Joformale nuk ka sjellur rezultate përmbajtësore. Kushtet e banimit mbeten kritike dhe në disa zona është në rrezik edhe jeta e njerëzve.

Përgjithësisht, progres i vogël është arritur në fushën e të drejtave pronësore. Shtyrjet në implementimin e ligjit dhe pengesat kanë çuar në dhunimet e të drejtave dhe tensione mes komuniteteve.

Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Qeveria ka vazhduar të punojë për kornizën institucionale legale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Kuvendi ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta për të mbrojtur veçanërisht objektet e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Po ashtu, janë miratuar amendamentet për të siguruar kompatibilitetin e Ligjit për Planifikim Hapësinor me ligjin për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta. Janë aprovuar shtatë rregullore implementuese që lejojnë aplikimin efektiv të Ligjit për Trashëgimi Kulturor. Janë identifikuar afër 3,000 objekte për përfshirje të gjasshme në listën e trashëgimisë kulturore. Është themeluar formalisht grupi punues ndërministror për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturorë.

Pas sulmeve të përsëritura kundër objekteve fetare dhe kulturore – posaçërisht kundër objekteve të Kishës Ortodokse Serbe – siguria e Trashëgimisë Kulturore dhe Fetare tani përgjithësisht është më e mirë. Një kompani private e sigurimit është kontraktuar për të mbrojtur objektet më të cenueshme dhe për të plotësuar punën e bërë nga policia. Urdhri Operativ i Policisë së Kosovës për mbrojtjen e objekteve të Kishës Ortodokse Serbe është finalizuar. Tani, ai duhet të implementohet. Zbatimi i ligjit është përmirësuar. Gjykata e Qarkut në Pejë ka dënua personin përgjegjës për hedhjen e granatës kundër manastirit të Deçanit në vitin 2007. Gjykimi i personit të dyshuar për vjedhjen e materialit ndërtimor në Kishën Ortodokse Serbe në Prizren. Një Memorandum i Mirëkuptimit është nënshkruar mes shërbimit të doganave dhe Ministrisë së Kulturës dhe policisë kufitare për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe për të krijuar bashkëpunim të kontrollit të kufijve dhe mbrojtur trashëgiminë e lëvizshme kulturore.

Punë e rëndësishme rindërtuese është bërë në njëmbëdhjetë objekte nga Komisioni për Implementim Rindërtues për objektet religjioze ortodokse serbe të dëmtuara gjatë ngjarjeve të marsit 2004. Disa prej këtyre objekteve, përfshirë rezidencën peshkopale në Prizren, i janë dorëzuar Kishës Ortodokse Serbe. Kisha është duke planifikuar ribanimin e këtyre objekteve.

Sidoqoftë, adaptimi i ligjeve ka nevojë të pasohet me implementim. Këshilli për Trashëgimi Kulturorë, për të cilin këshill ekziston dispozita në ligjin përkatës, akoma

nuk është themeluar. Grupi Punues ndërministror për Trashëgiminë Fetare dhe Kulturore akoma nuk ka filluar t'i mbajë takimet e rregullta. Tri ligjet për planifikim hapësinor, trashëgimi kulturore dhe zonat e veçanta mbrojtëse janë kompatible por duhet siguruar implementimin e tyre të harmonizuar.

Aktivitetet ndërtuese në afërsi të objekteve religjioze dhe kulturore paraqet kërcënimin kryesor për ambientin historik dhe natyror por edhe për jetën monastike. Zhvillimi i parregulluar ekonomik paraqet rrezik potencial për të ardhmen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore.

Vendimi i Komunës së Gjakovës për të ndërtuar një park në një copë të tokës që është pronë e Kishës Ortodokse Serbe, në këtë mënyrë duke i mbuluar themelet e kishës së shkatërruar në mars të vitit 2004, është çështje për shqetësim.

Trupat që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore të Kosovës akoma u duhet reforma institucionale dhe burime adekuate. Ngritja e vazhdueshme e njohurive është e nevojshme për të siguruar një vetëdije në rritje për pasurinë e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Komunikimi mes institucioneve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse të Serbisë duhet të përmirësohet.

Përgjithësisht, edhe përkundër situatës politike shpërthyesë dhe sfidave të vështira, është bërë progres në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Në fushën e edukimit, ligjet e fundit për edukim në nivelin lokal dhe në decentralizim e rrit rolin e komunave, përfshirë mundësinë për të zgjedhur programin në gjuhën serbe. Fëmijët turk dhe boshnjak janë të integruar në sistemin e edukimit të Kosovës në nivelin fillor dhe të mesëm. Mësimet mbahen në gjuhën turke dhe boshnjake dhe ndjekin programin e Kosovës. Serbët dhe shumica e romëve dhe goranëve ndjekin mësimet me programet serbe, po ashtu edhe fakultetet janë nën juridiksionin e Qeverisë së Serbisë.

Sidoqoftë, mungesa e programit të Kosovës në gjuhën serbe ka krijuar tensione në komunitetin goran, shumica e të cilëve kanë zgjedhur gjuhën serbe për t'u arsimuar. Nuk ka tekste mësimore në gjuhën turke dhe boshnjake për nxënësit e shkollave të mesme. Radio Televizioni i Kosovës transmeton emisione në gjuhët serbe, boshnjake, turke dhe rome, në përputhje me dispozitat legale. RTK mbulon 78% të territorit të Kosovës. Pjesa tjetër e territorit nuk është e mbuluar nga sinjali i RTK-së për shkak të rrjetit të dobët të shpërndarjes dhe kjo pjesë përfshin shumicën e boshnjakëve, turkeve, goranëve dhe serbëve që jetojnë në Kosovë. Kjo është një pengesë për të drejtën e minoriteteve për t'u informuar.

Implementimi Ligjit të vitit 2006 për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në nivelin qendror dhe lokal është vështirësuar nga mungesa e rregulloreve komunale dhe resurseve të nevojshme. Komisioni për Gjuhë nuk është duke punuar efektivisht. Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Qeverisjes Lokale nuk kanë bërë aktivitete për informim të publikut. Anëtarët e komuniteteve minoritare nuk janë të informuar për

dispozitat e ligjit, posaçërisht në zonat rurale. Gjuha rome vazhdon të injorohet në institucionet edukative dhe në administratën lokale.

Përgjithësisht, ligji për të drejtat kulturore është përmirësuar, por implementimi i tij mbetet i varfër.

Janë bërë përpjekje për të përmirësuar bazën legislative dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Zyra për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është themeluar në shtator të vitit 2008. Kushtetuta përcakton të drejtat e komuniteteve, themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe përfaqësimin e tyre në qeverinë lokale. Kuvendi në muajin mars ka aprovuar ligjin për të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre. Në shtator, Zyra e Presidentit ka themeluar me dekret Këshillin Konsultativ për Komunitete.

Komunitetet minoritare vazhdojnë të tregojnë besim në institucionin e Ombudspersonit. Në vitin 2007, 27% e kërkesave të dorëzuara në Ombudsperson janë nga përfaqësuesit e komuniteteve minoritare. Asnjë incident i madh i motivuar etnikisht nuk ka ngjarë pas shpalljes së pavarësisë. Njëfarë progresi mund të raportohet në fushën e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes për komunitetet e minoriteteve.

Sidoqoftë, kushtet e jetesës të komuniteteve më të dobëta janë përmirësuar. Në nivelet qendrore dhe lokale, korniza institucionale përgjegjëse për komunitetet minoritare me vështirësi është ballafaquar me shtrirjen dhe shumëllojshmërinë e tyre. Implementimi adekuat i ligjit dhe monitorimi i tij nuk janë siguruar. Nuk ka strategji për pajtim dhe dialog ndëretnik.

Përgjithësisht, përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet minoritare varet në efektivizimin e kornizës institucionale dhe përhapjen e informacionit. Mungesa e bashkëpunimit konstruktiv mes Prishtinës dhe Beogradit e komplikon këtë proces.

Janë afërisht 20 mijë persona të zhvendosur në Kosovë, 206 mijë banorë të Kosovës të vendosur në Serbi dhe 16 mijë në Malin e Zi. Krijimi i klimës për kthimin e personave të zhvendosur është prioritet kryesor i Partneritetit Evropian për Kosovë. Në maj të vitit 2008, një rrjet i asociacioneve të personave të zhvendosur në Serbi ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete të Kosovës për të inkurajuar kthimin e 60 familjeve Laplje Selo (një vend tjetër prej vendit të origjinës së tyre).

UNHCR dhe Ministria për Kthime dhe Komunitete kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit për të forcuar kapacitetin e institucioneve qendrore dhe lokale të angazhuara në menaxhimin e kthimit. Shumica e komunave kanë bërë strategjitë e tyre komunale për kthim.

Partneriteti i Qëndrueshëm për Asistencë të Kthyerve Minoritarë në Kosovë (Programi SPARK), i implementuar nga UNDP siguron një kornizë për të ndihmuar të kthyerit vullnetarë. Në nivelin qendror, Mekanizmi Qendror për Shqyrtime është për të siguruar

konsistencë. Kryesuesi i këtij mekanizmi, i cili shqyrton të gjitha projektet vullnetare për kthim, të miratuara nga grupet punuese komunale, është bartur në vitin 2007 në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete.

Qeveria ka miratuar në tetor të vitit 2007 Strategjinë për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar në Kosovë. Strategjia synon të garantojë zgjidhje të qëndrueshme dhe për nevojat e personave të riatdhesuar në fushat e shëndetësisë, edukimit, punësimit, riintegrimin legal, mirëqenies sociale, strehimit dhe çështjeve që lidhen me pronë. Ajo, po ashtu, adreson nevojat e grupeve të dobëta të shoqërisë dhe komuniteteve minoritare. Një plan i veprimit për implementimin e Strategjisë për riintegrim është finalizuar në prill të vitit 2008.

Edhe përkundër disa incidenteve që kanë pasur për cak të kthyerit, situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë gjatë periudhës raportuese ka mbetur relativisht e qetë.

Sidoqoftë, ritmi i procesit të kthimit është shumë i ulët dhe është ulur edhe më shumë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Prej tetorit 2007, rreth 700 persona janë kthyer vullnetarisht dhe rreth 2000 persona janë riatdhesuar forcërisht prej vendeve ku kanë qenë të strehuar. Për më shumë, prej janarit 2008, vendet strehuese i kanë kërkuar Kosovës të pranojë edhe 2,900 persona. Strategjia për riintegrim të personave të riatdhesuar nuk është implementuar akoma. Vizitat “Shko dhe informo” dhe “Shko dhe shih”, të cilat synojnë të vendosin lidhje mes komuniteteve shumicë në Kosovë dhe të zhvendosurve janë suspenduar përkohësisht dhe kanë filluar sërish pas një marrëveshjeje në prill mes organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të personave të zhvendosur. Strukturat e krijuara në vitin 2005 për të inkurajuar dialogun e drejtpërdrejtë mes Prishtinës dhe Beogradit për procesin e kthimit nuk janë më operative. Grupi i fundit teknik për kthim është mbledhur në vitin 2007.

Në disa komuna, personat e zhvendosur kanë ndërprerë pjesëmarrjen në grupet punuese komunale pas pavarësisë së Kosovës. Komunitatet serbe të Kosovës përgjithësisht nuk marrin pjesë në mekanizmat relevantë institucional.

Në nivelin qendror, kapaciteti administrativ dhe resurset buxhetore janë të pamjaftueshme, edhe pse buxheti për 2007 për kthim është rritur për 35% (7.14 milion euro) krahasuar me 2006. Ministria për Komunitete dhe Kthime është konfrontuar me shumë parregullsi dhe probleme në menaxhim dhe ka ndërmarrë disa masa për t'i adresuar ato probleme. Pas dorëheqjes së ministrit, një ministër i ri është caktuar në shtator. Në nivelin lokal, ekipet komunale nuk janë të pajisura siç duhet për të implementuar politikat e kthimit.

Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve akoma nuk ka bazë të të dhënave për personat e zhvendosur, gjë që çon në konfuzion dhe pasiguri.

Përgjithësisht, procesi i kthimit është ngadalësuar gjatë periudhës së raportimit dhe mbetet sfidë kryesore për autoritetet e Kosovës.

Anëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptian, mbesin të marginalizuar. Strategjia për të përmirësuar edukimin e fëmijëve në shtator të vitit 2007 nuk është duke ndikuar në ndjekjen e mësimit nga fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptianë dhe niveli i ndjekjes së mësimit nga këto komunitete mbetet i vogël, posaçërisht nga vajzat. Niveli i punësimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është akoma më i vogël sesa mesatarja. Shumica nuk përfiton nga mirëqenia sociale dhe ka qasje të kufizuara në përkujdesin shëndetësor. Deri në 40% prej 34,000 anëtarëve të këtij komuniteti nuk janë të regjistruar si banorë të Kosovës, gjë që i pengon ata të përfitojnë nga shërbimet administrative e sociale. Strategjia dhe plani i veprimit nuk janë aprovuar akoma. Marrëveshjet joformale mbesin problem dhe kushtet e jetesës janë jashtëzakonisht të pasigurta. Banorët e disa kampeve të romëve të zhvendosur vuajnë nga ndotjet, posaçërisht në Kosovën veriore, ku autoritetet relevante kanë dështuar të sigurojnë trajtim dhe të zhvendosin popullatën e rrezikuar. Siguria mbetet shqetësuese dhe incidentet ngjajnë dhe nuk raportohen. Kushtet e vëna për të fituar shtetësinë e Kosovës janë vështirë të realizueshme për anëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.

Përgjithësisht, situata e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë mbetet shqetësuese dhe kërkon vëmendjen e plotë të autoriteteve të Kosovës.

2.3. Çështjet regionale dhe obligimet ndërkombëtare

Bashkëpunimi i plotë me Tribunalin Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (ICTY) është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovë.

Bashkëpunimi mes Qeverisë, UNMIK-ut dhe ICTY ka vazhduar. Në prill të vitit 2008, ICTY ka lëshuar vendimin për rastin Haradinaj dhe të tjerët. Prokuroria ka kërkuar dënim 25 vjet për të akuzuarin. Ramush Haradinaj është liruar nga të gjitha paditë. Ndërsa lideri i dikurshëm i “Shqiponjave të Zeza” (njësi speciale e UÇK-së) është liruar po ashtu nga të gjitha paditë, kurse lideri tjetër është gjetur fajtor për dy akuza (trajtim çnjerëzor dhe torturë) dhe është dënuar me 6 vite burg.

Në maj të vitit 2008, prokurori i ICTY ka paraqitur një kërkesë për të përmbysur vendimin e gjykatës, duke argumentuar se gjykimi nuk ka qenë fer për shkak të kërcënimeve dhe frikës. Vendimi origjinal, dërguar Dhomës së Gjyimit, potencon se është hasur në vështirësi domethënëse në sigurimin e dëshmimeve prej një numri të madh të dëshmitarëve. Ai po ashtu specifikon se ka fituar përshtypje të fortë se gjykimi është mbajtur në një atmosferë ku dëshmitarët janë ndier të pasigurt.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë hetuar deklaratat për trafikimin e organeve të marra nga serbët e burgosur pas luftës së fund viteve 90-ta. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka filluar punën për një raport për trajtim jo human të njerëzve dhe trafikim të palejueshëm të organeve njerëzore në Kosovë.

UNMIK-u ka nënshkruar në emër të Kosovës pjesëmarrjen në një numër organizatash dhe marrëveshjesh ndërkombëtare (Komuniteti i Energjisë, Marrëveshja Evropiane për Zonë të Përbashkët të Aviacionit, Vëzhgimi i Transportit në Evropën Juglindore,

CEFTA). Kushtetuta e Kosovës parasheh që autoritetet e Kosovës të sigurojnë përfaqësimin e saj regional dhe ndërkombëtar. Sidoqoftë, autoritetet e Kosovës nuk janë të pranuar si trashëgimtare të UNMIK-ut nga disa palë të këtyre marrëveshjeve. Procesi aktual i rikonfigurimit të UNMIK-ut parasheh mundësimin, ku është e nevojshme dhe e mundshme, që Kosova të vazhdojë të angazhimin në marrëveshjet ndërkombëtare. Është thelbësore që përfaqësimi dhe pjesëmarrja e Kosovës në forumet multilaterale të sigurohet dhe të gjitha palët të demonstrojnë qëndrim konstruktiv drejt këtij qëllimi.

Kosova vazhdon të marrë pjesë në nismat rajonale të bashkëpunimit. Ka qenë e angazhuar në punën e Paktit të Stabilitetit dhe në procesin e tranzicionit në kuadër të kornizës regjionale me Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECIP) dhe Këshillin Regjional të bashkëpunimit (RCC). Qeveria duhet të nominojë përfaqësuesin e saj në RCC.

UNMIK rregullisht ndjek takimet e komitetit të përbashkët dhe nënkomiteteve të CEFTA-s. Qeveria duhet të nominojë përfaqësuesin për këto takime.

UNMIK-u ka marrë përsipër në emër të Kosovës kryesimin e Traktatit të Komunitetit për Energji prej 1 janarit deri më 30 qershor 2008.

Kosova vazhdon të implementojë dispozitat e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). Të gjitha zhvendosjet e instrumenteve për Fazën 1 të ECAA-së janë në proces të finalizimit dhe aprovimit.

Kosova, përmes UNMIK-ut, vazhdon të ndjek takimet e Kartës së BE-së për Ndërmarrje të Vogla. Sidoqoftë, qeveria nuk i ka caktuar akoma pikat kryesore në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Kosova merr pjesë në Vëzhgimin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO). Në dhjetor të vitit 2007, UNMIK ka nënshkruar Shtesën për Hekurudha.

Kosova merr pjesë në Investment Compact Initiative, e dizajnuar për të përmirësuar klimën e investimeve dhe inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në rajon.

Përgjithësisht, pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat rajonale¹⁰ duhet të jetë proaktive dhe konstruktive. Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria duhet të garantohen.

Për sa i përket marrëdhënieve bilaterale, vendet fqinje dhe që aspirojnë anëtarësim, Shqipëria, Turqia, Mali i Zi dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në qershor të vitit 2008, vendosja e tri pikave kufitare në Serupa ka shënuar fillimin e procesit të demarkacionit të kufirit mes Kosovës dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Nën ndërmjetësimin dhe kryesimin e Zyrës Civile

¹⁰ Kosova po ashtu merr pjesë në Iniciativën Broadband të Evropës Juglindore bSEE, Iniciativën Elektronike të Evropës Juglindore eSEE, Shkollën Regjionale për Administratë Publike dhe Iniciativën Bashkëpunuese të Evropës Juglindore SECI.

Ndërkombëtare, është themeluar një grup punues mes Kosovës dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe takimi i tij i parë është mbajtur në prill të vitit 2008.

3. KRITERET EKONOMIKE

Në shqyrtimin e zhvillimeve ekonomike në Kosovë, qasja e Komisionit prihej nga konkluzat e Këshillit Evropian në Kopenhagë të qershorit 1993, të cilat theksonin se anëtarësia për BE kërkon ekzistimin e një ekonomie funksionale tregu si dhe të kapacitetit për t'u përballur me trysinë konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së.

3.1. Ekzistimi i një ekonomie funksionale tregu

Politikat themelore të ekonomisë

Qeveria e Kosovës ka prezantuar një Kornizë Zgjerimi Afatmesme për 2009-2011 (KZAM) e cila i përcakton përparësitë e politikave, duke përfshirë rritjen ekonomike dhe qeverisjen e mirë¹¹. Sidoqoftë, konsistenca dhe besueshmëria e politikave mbeten të brishta. Kjo u ilustrua nga buxheti i rishqyrtuar i propozuar në vlerësimin e mesvitet të buxhetit në korrik 2008, që devijonte dukshëm nga KZAM-ja, duke shpallur një përjasje *ad-hoc* ndaj politikës fiskale. Për më shumë, mungesa e vazhdueshme e bashkërendimit ndërmjet ministrive të përfshira, paaftësia për t'i ndjekë procedurat e vendosura në ligjet përkatëse dhe qeverisja e dobët e ndërmarrjeve shtetërore vazhdojnë ta dëmtojnë mjedisin e gjithëmbarshtëm ekonomik. Ekonomia dhe formulimi i politikës ekonomike u ndikuan nga zgjedhjet e përgjithshme në nëntor 2007, nga shpallja e pavarësisë në shkurt 2008 si dhe nga mungesa e qartësisë mbi përmasën dhe vijimësinë e pranisë ndërkombëtare gjatë tranzicionit. Më 10 korrik 2008, Kosova zyrtarisht aplikoi për anëtarësi në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe, rrjedhimisht, në Bankën Botërore. Në përgjithësi, është ruajtur konsensusi politik mbi fundamentet e politikave ekonomike me orientim tregu, porse qasja strategjike afatmesme ende pritet të inkorporohet në veprimin qeveritar.

Stabiliteti makroekonomik

Mangësitë në të dhënat statistikore vazhdojnë ta pengojnë vlerësimin e gjithëmbarshtëm të gjendjes ekonomike në Kosovë. GDP-ja reale u rrit me një përqindje të parallogaritur prej 4.4% më 2007 pas shtimit për 3.9% më 2006¹². Shpenzimet nga ekonomitë private familjare u shtuan për pothuaj 10% në kuptimin formal. Shpenzimet publike shfaqin një tjetër tablo, meqë pagat qeveritare u rritën për 2.5% kurse konsumi publik i mallrave dhe shërbimeve për 1.4%. Shpenzimet e përgjithshme qeveritare në investime ranë për pothuaj 10% më 2007, meqë vetëm 71% të investimeve të buxhetuara u shpenzuan faktikisht¹³. Investimet nga donatorët u rruhdën për 7.7%, duke e ulur pjesën e tyre të investimeve totale në 4% nga 5.5% më 2006. investimi total në vetvete qëndronte në 27%

¹¹ KZAM shërbeu si udhëzimit për Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve në Bruksel më 11 korrik 2008.

¹² Vlerësime të FMN-së nga maji 2008.

¹³ Këto shifra nuk përfshijnë subvencionet kapitale për ndërmarrjet publike.

të GDP-së më 2007, i ngritur nga 23% më 2006. Aktiviteti ekonomik është vazhdimisht i kushtëzuar nga faktorë vendas dhe dinamizmi i sektorit privat, megjithëse mbetet në nivel mesatar. Së bashku me implementimin e dobët nga buxheti kapital, furnizimi jostabil me energji vazhdon të mbetet frenues i madh në investim dhe rritje. Sipas paralogaritjeve të FMN-së, GDP për krye më 2007 qëndronte tek afro €1,600 që është rreth 5.5% e mesatares BE-27¹⁴. Në përgjithësi, shtimi po ngrihet gradualisht nga niveli mesatar ndërsa furnizimi jostabil me energji, me nga disa ndërprerje të gjata në ditë, mbetet më i madhi kufizim për shtimin.

Përpjesa e mbulesës së mallrave të eksportuara ndaj të importuarave ende është shumë e ulët, çka pasqyron mungesën e kapacitetit eksportues dhe të konkurrencës, me gjithë një rritje në mesataren e lëvizshme 12-muajsh nga 8.5% më 2006 në 10.9% në korrik 2008. Deficiti tregtar u zgjerua më tej në 41% të GDP-së më 2007, krahasuar me 37% më 2006. Ky trend vazhdon përgjatë 2008, ndonëse me një hap më të ngadalshëm. Në shtatë muajt e parë të 2008, eksportet e mallrave u shtuan për 63% dhe importet për 27% krahasuar me periudhën e njëjtë para një viti, duke e sjellë deficitin tregtar (vetëm mallrat) tek rreth 42% e GDP-së. Deficiti i llogarive rrjedhëse– përfshirë asistencën e huaj– u shtua nga 12.2% e GDP-së më 2006 në 17.4% më 2007. Kryesisht financohej nga derdhjet prej investimit direkt të huaj (IDH). Mbrapa aktivitetit të përsheptuar të privatizimit dhe investimeve në operatorin e dytë mobil (IPKO) si dhe sektorin bankar përgjatë 2007, IDH u ngrit nga 12.6% e GDP-së pas 8% më 2006. Sidoqoftë, një pjesë e ndjeshme e financimeve mbeti e pashpjeguar¹⁵, çka dëfton për një përpjesë të madhe të qarkullimeve financiare të pargjistruara. Paratë e dërguara të punëtorëve qëndruan në 12.9% të GDP-së më 2007 pas 11.6% më 2006. Rënia e aseteve neto të huaja të sektorit bankar komercial për 16% gjatë gjysmës së parë të vitit 2008 tregon derdhje kapitale në rënie në Kosovë. Në përgjithësi, llogaritë e jashtme të Kosovës mbeten jostabile.

Disponueshmëria dhe besueshmëria e dobët e të dhënave zyrtare të punësimit e bëjnë të pamundshme të analizohen zhvillimet në tregun e punës. Në fund të 2007-ës, numri i të papunëve të regjistruar u shtua për 2.6% krahasuar me 2006 dhe 60% të të papunëve janë të pakualifikuar, 47% janë femra kurse pjesa e të papunëve afatgjatë mbetet tejet e lartë (93%). Pas një shtimi të vogël gjatë muajve të parë më 2008, numri i regjistruar zyrtarisht i të papunëve u kthye në nivelin e fundvitit 2007 në muajt e verës. Në korrik ishte 335.920 persona, i rritur për 0.4% krahasuar me dhjetorin 2007 dhe për 0.9% krahasuar me korrikun 2007. Rezultati i Anketës së Fuqisë Punëtore 2007 shpalosi një shkallë papunësie prej 43.6% (meshkuj 38.5%, femra 55.2%), një shkallë aktiviteti prej 46.5% (meshkuj 65.2%, femra 28.3%) si dhe një shkallë punësimi prej 26.2% (meshkuj 40.1%, femra 12.7%). Rreth 30.000 të rinj hyjnë në tregun e punës për çdo vit. Me shkallën aktuale të rritjes, ekonomia nuk mund ta thithë këtë fuqi punëtore të re në shtim. Po ashtu, fakti se ekonomia po fillon nga një bazë e ulët produktive, ndryshimet strukturore aktuale, të lidhura pjesërisht me procesin e privatizimit si dhe kriteret e të drejtës të definuara dhe të administruara keq për transfero sociale konservacionale kontribuojnë për ruajtjen e nivelit ekzistues të papunësisë. Sidoqoftë, pjesërisht për shkak të përmasave të

¹⁴ Bazuar në bursën e këmbimeve të tregut, sepse të dhënat për një krahasim me bazë PPP nuk disponohen

¹⁵ Kjo është përmbledhur në komponentin gabimet dhe lëshimet neto në balancën e pagesave.

mëdha të ekonomisë joformale, ndryshimet në papunësinë e regjistruar mund të mos e pasqyrojnë saktë dinamikën faktike të ekonomisë. Në përgjithësi, papunësia e regjistruar mbetet shumë e lartë.

Inflacioni mesatar vjetor i konsumatorit u ngrit në 4.4% më 2007 pas një 0.6% më 2006 dhe u ngrit në 12.4% për tetë muajt e parë të vitit 2008. Inflacioni u shtua në gjysmën e dytë të 2007, me shkallë vit-më-vit vazhdimisht mbi 10% që nga tetori 2007 dhe me ngritje në 14% ndërmjet majit e korrikut 2008. Ky zhvillim u diktua fillimisht nga çmimet e ushqimeve, që përbëjnë pothuajse gjysmën e shportës së konsumatorit, dhe nga çmimet e transportit. Kryesisht për shkak të efektit bazë, shkalla vjetore e inflacionit ra në 7.8% në gusht 2008. Presionet inflacionare u ulën për shkak të relaksimit në energjinë ndërkombëtare si dhe zhvillimet në çmimet e ushqimeve. Më 2007, paratë e gjera u shtuan për 23.3% kurse stoqet e kredive të papaguara për sektorin privat për 40%. Për të përmbledhur, pas viteve të tëra të inflacionit të ulët, u shpërfaqën tensionet e çmimeve, të nxitura nga shtimet në çmimet e mallrave, edhe pse janë zbutur rishtazi.

Kosova ka filluar të ndajë fonde për servisimin e borxhit nacional si dhe të caktojë likuiditetin dhe rezervën e stabilizimit në planifikimin buxhetor afatmesëm. Më 2007, shpenzimet buxhetore u shtuan, me të ardhurat vjetore duke tejkaluar dukshëm dhe me shpenzimet kapitale duke mos u përputhur me shifrat e buxhetuara. Kjo rezultoi me akumulimin e rezervave substanciale të keshit dhe me përzjerje të jofavorshme të politikave. Implementimi i buxhetit të vitit 2007 prodhoi (i) të ardhura vjetore të atij viti prej 75 milion eurosh për shitjen e licencës së telefonisë mobile; (ii) mbledhje më të madhe sesa ishte planifikuar të të ardhurave vjetore, falë taksimeve të mjaftueshme në kufi; dhe (iii) shpenzime të ulëta kapitale. Së bashku, këta faktorë çuan tek shtrëngimet e forta të pasyruara fiskale më 2007, me një shtesë prej 7.2% të GDP-së, duke pasqyruar cilësinë e dobët të planifikimit dhe implementimit buxhetor. Buxheti i 2008-ës është i zmadhueshëm dhe divergjon nga rregulla fiskale se shpenzimi real aktual primar nuk duhet të rritet për më shumë sesa 0.5% vit-për-vit. Më parë, është caktuar të ngrihet për me gjasë më shumë sesa 10% gjatë prodhimit të viti të kaluar. Shpenzimet e buxhetuara kapitale thuaja kanë trefishuar rezultatin e 2007-ës dhe trendi është theksuar në vlerësimin e mesitit të buxhetit në korrik 2008, ndërsa KZAM tashmë e pranon se rezultati faktik me siguri nuk do ta kapë këtë shifër për rreth 30%. Shifrat aktuale të ekzekutimit sugjerojnë ulje edhe më të madhe, meqë shpenzimet kapitale vazhdojnë të kenë performim të dobët, duke kapur vetëm 20% të planit vjetor në shtator, ndërsa të ardhurat vjetore performuan AKP a shumë siç pritej. Në përgjithësi, buxheti nuk është instrument efikas i politikës fiskale dhe nuk kontribuon për parashikimin e zhvillimeve ekonomike. Më parë, thjesht i përgjigjet trysnive *ad-hoc* të shpenzimit.

Kosova vazhdon të mbështetet në euron si valutë në përdorim. Në mungesë të politikës autonome monetare, kjo e lë buxhetin si veglën themelore për politikën makro-ekonomike në Kosovë. Sido që të jetë, për shkak të planifikimit dhe implementimit të dobët buxhetor, siç shpaloset nga konsolidimi i pasyruar i fuqishëm fiskal më 2007, i pasuar nga një plan i zgjerueshëm buxheti më 2008, përzjerja e përgjithshme e politikave mbetet e pamjaftueshme dhe paqëndrueshmëria buxhetore është shtuar.

Bashkëveprimi i forcave të tregut

Më 2007, u shtuan më tej hisja e sektorit privat në shpenzimin e përgjithshëm, investimet dhe importet. Investimi privat u ngrit nga rreth 37% më 2007, nga 26% sa kish qenë më 2006. Privatizimi vazhdoi me hap të shpejtë deri nga fundi i vitit 2007, kur erdhi në një frenim pas një vendimi nga Oda Speciale e Gjykatës Supreme të Kosovës që e vuri në pikëpyetje metodën e privatizimit. Këto shqetësime janë adresuar pjesërisht në Ligjin e ri mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe procesi i privatizimit gradualisht vazhdoi pas verës. Megjithatë, mbeten çështje të mëtejme ligjore për t'u zgjidhur dhe agjencia ende duhet të bëhet operacionale. Të gjitha ndërmarrjet publike janë inkorporuar nga fundi i vitit 2007 dhe legjislacioni i ri mundëson privatizimin e tyre¹⁶. Në përgjithësi, zgjerimi i sektorit privat vazhdoi më 2007, por hyri në një fazë të pasigurt më 2008, i shënuar nga një frenim në procesin e privatizimit në gjysmën e parë të vitit.

Hyrja dhe dalja e tregut

Numri i bizneseve të regjistruara në Kosovë ishte rreth 86.000 në qershor 2008. Sidoqoftë, një pjesë e madhe e tyre nuk janë aktive. Janë bërë përmirësime në zyrat "one-stop shop" për regjistrim biznesesh, por kostot e fiksuara për marrjen me biznes, siç është leja për punë dhe ndërtim, mbeten të larta. Furnizimi jostabil me energji, qasja e kufizuar në financa, korrupsioni dhe të drejtat pronësore dobët të përkufizuara e pengojnë hyrje-daljet në treg. Me qëllim të lehtësimit të daljes, është miratuar Ligji mbi bankrotimin. Në përgjithësi, vëniet në zbatim të kontratave, të vështira e të shtrenjta, e vështirësojnë qasjen ndaj financave dhe vazhdojnë ta pengojnë seriozisht mjedisin biznesor.

Sistemi ligjor

Në qershor 2008, Agjencia Kosovare e Pronave (AKP) filloi t'i zbatojë vendimet e para ta marra nga Komisioni Kosovar i Çështjeve Pronësore (KKÇP) për pretenduesit. KKÇP ka shqyrtuar 8.329 nga 39.589 ankesa pronësore dorëzuar AKP-së. Sidoqoftë, në qershor qeveria e Serbisë ka vendosur t'i pezullojë zyrat e AKP-së në Beograd, Kragujevac dhe Nish, duke theksuar se AKP-ja nuk ia kishte dalë t'i mbronte të drejtat e qytetarëve serbë prona e të cilëve në Kosovë është okupuar ilegalisht nga palë të treta. Korrupsioni, aktivitetet kriminale dhe pasiguria mbi të drejtat pronësore mbeten pengesat kryesore për zhvillimin ekonomik. Në përgjithësi, përdorimi i gjykatave për vënien në zbatim të kontratave mbetet i pazhvilluar, ndërsa në të njëjtën kohë gjykatat vazhdojnë të përballen me ngarkesën e rëndë të rasteve në pritje.

Zhvillimi i sektorit financiar

Sektori financiar në Kosovë vazhdon të rritet. Shtatë banka komerciale, nëntë kompani sigurimi dhe dy fonde pensionale janë operative në Kosovë. Katër banka të reja kanë hyrë në treg më 2007 e 2008. Deri më tash, kriza ndërkombëtare financiare nuk ka pasur ndikim material në sektorin financiar në Kosovë, meqë bankat vendore nuk kanë ekspozim direkt ndaj efekteve të valës së parë dhe janë në pozitë të mirë likuiditeti.

¹⁶ Kjo përfshinte bilanc të pastër hapës që mandej do të mundësonin privatizimet e mundshme të ardhshme

Sidoqoftë, efektet që po shpalosen aktualisht të valës së dytë mund të kenë ndikim nëpërmjet kompanive ëma kryesisht të huaja të bankave vendore. Në maj 2008, Banka Qendrore e Kosovës nënshkroi Memorandume mirëkuptimi me the autoritetet mbikëqyrëse turke e kroate të sektorit financiar, duke i shtuar kornizave të ngjashme ekzistuese me institucionet respektive të vendeve të tjera nga rajoni.

Sektori bankar mban 88% të aseteve të sektorit financiar dhe dominohet nga bankat e huaja si dhe mbetet tejte i koncentruar, me tri bankat kryesore duke pasur 83% të aseteve totale. Profitet e tij janë ngritur për 68% më 2007. Shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë është shtuar më tej, ndonëse nga një nivel ende shumë modest. Hisja e aseteve të sektorit bankar në GDP është rritur nga 37% më 2006 në 43% më 2007. Vëllimi i kredive u shtua nga 21% e GDP-së më in 2006 në 27% më 2007. Kreditë u shtuan për 40% vit-për-vit, të financuar kryesisht nga shtimi i depozitave. Në gjysmën e parë të vitit 2008, kreditë për shkallë depozite u shtuan në 85%. Kjo shkallë e lartë sinjalizon probleme të shtuara likuiditeti në ekonomi. Për më shumë, kreditë janë kryesisht afatgjata, ndërsa depozitat janë afatshkurtra, duke shpalosur shpërputhje maturitetit. Cilësia e portofolios së kredive në sektorin bankar të Kosovës tregon do shenja të përkeqësimit: kreditë joperformuese përbëjnë 4.1% të portofolios totale të kredive (0.4 pikë të përqindjes nga 2006). Megjithatë, indikatorët e profitabilitetit dhe likuiditetit për gjysmën e parë të 2008-ës mbeten të favorshme, ndonëse janë në një përkeqësim të vogël. Shkalla e interesit e shpërndarë ndërmjet depozitave dhe kredive është shumë e gjerë dhe tregon veç një trend të ulët uljeje (e ulur në 11.3 pikë të përqindjes më 2007 nga 11.8 në vitin paraprak). Sektorët nuk gëzojnë qasje të barabartë në financa: shumica dërrmuese e kredive shkojnë për tregti (57.6% në gjysmën e parë të 2008-ës, e ulur nga 61% në periudhën e njëjtë të 2007-ës), pasuar nga shërbimet (17.6%, ngritje nga 14.9%) dhe industria e energjia (13.4%, ngjitje nga 11.8%). Vënia në zbatim e paefektshme të të drejtave të kreditorëve si dhe kontratave në Kosovë i shtyn kostot për institucionet financiare dhe e luhat vlerën e hipotekës.

Tregu i sigurimeve po ashtu dominohet nga kompani të huaja dhe është shumë i vogël me asete që përbëjnë rreth 2% të GDP-së më 2007. një grup e kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik dhe të rezervave është hartuar për sektorin e sigurimeve nga banka qendrore për ta fuqizuar kapacitetin e industrisë. Po ashtu, është themeluar korniza ligjore për produktet e sigurimit të jetës dhe për liberalizmin e tarifave. Në përgjithësi, sektori financiar mbetet profitabil dhe ndërmjetësimi financiar është thelluar më tej, ndonëse në nivel të ulët. Qasja ndaj financave është ende e pabarabartë dhe e penguar nga vënia e dobët në zbatim si dhe kostot e larta të huazimit.

3.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së

Ekzistimi e një ekonomie funksionale tregu

Në përgjithësi, Kosova ka zhvilluar një kornizë përkatëse legjislativë e institucionale për një ekonomi funksionale tregu. Sidoqoftë, implementimi dhe vënia në zbatim e kësaj kornize mbetet e dobët. Një çështje e pazgjidhur është elektriciteti, ndërsa vjedhja dhe

mospagesa e faturave të rrymës vazhdon të tolerohet dhe të kontribuojë për përdorimin joefikas të burimeve të pamjaftueshme. Furnizimi me energji po ashtu vuan nga struktura e dobët e qeverisjes dhe menaxhimi i dobët i ofruesit të rrymës (KEK) i kombinuar me nën-investim, me gjithë subvencionet e larta nga buxheti, interesat e mbrojtura dhe mungesa e vullnetit politik për ta ndryshuar gjendjen. Faktorët shtesë, sikurse evazioni fiskal dhe korrupsioni bashkë me përdorimin e gjerë të punës së padeklaruar, çojnë tek një sistem çmimesh ku bashkekzistojnë disa çmime për të njëjtat shërbime e mallra, me pasoja negative për efikasitetin e përgjithshëm të tregut dhe transparencën. Shtimi më 2007 konsiderohet i shkaktuar krejtësisht nga the aftësia ripërtëritëse e sektorit privat në një mjedis të investimit të ulët publik dhe përkrahja në rënie e donatorëve. Në përgjithësi, të drejtat e pasigurta pronësore dhe vënia e dobët në zbatim e kontratave, korrupsioni dhe furnizimi i pamjaftueshëm me energji, si rezultat i qeverisjes së dobët të ofruesit KEK dhe infrastruktura vazhdojnë të peshojnë mbi konkurrueshmërinë e bizneseve kosovare, klimën e bizneseve dhe besueshmërinë e mekanizmave të alokimit.

Kapitali njerëzor e fizik

Kosova mbetet e ndikuar nga mungesa e ambienteve të mjaftueshme arsimore si dhe mësimdhënia e cilësisë së dobët. Shkalla e përgjithshëm e vijimit në arsim nuk ka treguar ndonjë shtim të ndjeshëm në vitet e fundit. Ajo është sidomos e ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë, dhe nivelet e braktisjes janë të larta. Pjesa e arsimit në shpenzimin e përgjithshëm buxhetor është shtuar në 17.3% në gjysmën e parë të vitit 2008. Politikat aktive të tregut të punës sikurse janë arsimi profesional vazhdojnë të përballen me kufizime të ashpra kapacitetesh. Për mungesë të ambienteve fizike e të mësimdhënësve, vetëm një pjesë e vogël e bashkëmoshatarëve të një viti që arrijnë në tregun e punës përfitojnë nga këto masa. Për t'i adresuar këto kufizime, është ndërtuar një qendër profesionale e kualifikimeve në Prishtinë.

Infrastruktura e transportit (rrugët dhe hekurudhat) në Kosovë janë të kufizuara në gamë dhe kushte. Nuk është mirë e lidhur me rrjetet rajonale, dhe shpenzimet e mirëmbajtjes kanë qenë të pamjaftueshme edhe pse njëfarë përmirësimi i infrastrukturës rrugore ka filluar në zonën e Prishtinës si dhe me lidhjet rajonale për Shkup e Pejë. Densiteti i rrugëve është vetëm 3,3 km për 1.000 banorë kurse lidhjet hekurudhore me Serbinë kanë qenë të vështira pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova.

Depërtimi i telefonisë mobile është shtuar ndjeshëm dhe ka arritur rreth 50% nga mesi i 2008-ës. Pjesërisht për shkak të hyrjes së operatorit të dytë mobil, infrastruktura e telekomunikimeve me shpejtësi të lartë po përmirësohet, gama e produkteve po zgjerohet dhe çmimet po bien. Në përgjithësi, baza e dobët teknologjike (kombinuar me mungesën e konkurrueshmërisë së çmimeve), gjendja e dobët e infrastrukturës fizike dhe numri i vogël i kapitalit të kualifikuar njerëzor mbeten pengesat kryesore për një ekonomi tregu që funksionon mirëfilli dhe që është konkurruese.

Struktura sektoriale dhe ndërmarrësore

Janë themeluar autoritetet rregullative për të gjitha rrjetet kryesore dhe industrinë e

mallrave, por kapaciteti i tyre mbetet i dobët. Në disa raste, efektet potenciale pozitive mbi liberalizimin nuk kanë qenë në gjendje të materializohen për shkak të qeverisjes së dobët korporatave ose, në rastin e sektorit të minierave, vazhdonin trazirat shoqërore. Kosova nuk mund të tregtojë ende energji në nivel të njëjtë me fqinjët e saj për shkak të integritit të papërfunduar në marrëveshjet rajonale për tregtimin e elektricitetit. Prodhimi dhe shpërndarja e rrymës elektrike ende janë të tubuara në ofruesin e energjisë me performim të dobët - KEK. Ka pasur do ndryshime në strukturën e ndërmarrjes, e cila mbetet e dominuar nga mikro-ndërmarrjet. Sidoqoftë, zhvillimi i sektorit financiar ka ndihmuar të shtohen aksionet dhe dinamizmi i sektorit të shërbimeve. Të dhënat e tregtimit për vitin 2008 tregojnë drejt një përmirësimi struktural në sektorin e procedimit të ushqimit, në kuptimin e zëvendësimit të importeve të prodhimeve ushqimore të procesuara. Sektori joformal mbetet i madh. Në përgjithësi, ka pasur pak ndryshime në strukturën sektoriale të ekonomisë.

Ndikimi i shtetit mbi konkurrueshmërinë

Më 2007, subvencionet në kesh për organet publike mbetën stabile me nivelin e 2006-ës. Por më 2008 ky nivel tashmë është arritur në gjashtë muajt e parë¹⁷. Ndonëse qeveria nuk ka ndërhyrë aq drejtpërdrejt sa më 2007, mosveprimi kundrejt vjedhjes së përhapur të rrymës elektrike mbetet një subvencion i tërthortë më shumë ndaj subvencioneve të paguara prej buxhetit, dhe vazhdon ta zhvlerësojë besueshmërinë e rregullatorit të pavarur të elektricitetit. Mosveprimi i autoriteteve po ashtu po e shkatërron konkurrueshmërinë, sidomos të prodhuesve të mesëm e të mëdhenj. Këto nuk mund t'i drejtohen ekonomisë joformale deri në shkallën e njëjtë sa edhe mikro-ndërmarrjet dhe bizneset e vogla të cilat operojnë kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe të tregtimit. Rrjedhimisht, administrimi i dobët dhe sundimi i ligjit kontribuojnë për strukturën e ashpër biznesore e cila pastaj ia vështirëson sektorit privat të arrijë ekonomi me rëndësi në gamë dhe/ose në rreze. Në përgjithësi, vazhdojnë subvencionet direkte e indirekte shtetërore, që të kombinuara me nivel dhe cilësi të dobët të shërbimeve publike, po e pengojnë konkurrueshmërinë e sektorit privat.

Integrimi ekonomik dhe konvergjenca brenda BE-së

Ekonomia e hapur, e matur me vlerën e importeve plus eksporteve në mallra e shërbime si përqindje e GDP-së, u shtua në 62% më 2007, e ngritur prej 56% më 2006¹⁸. Metalet bazë dhe prodhimet e metaleve bazë vazhduan të përbejnë mbi gjysmën e mallrave të eksportuara më 2007 dhe aksionet e tyre u shtuan më tej në 66% në shtatë muajt e parë të 2008-ës. Eksportet e mallrave gjatë kësaj periudhe u ngritën në 63% krahasuar me periudhën e njëjtë më 2007, me eksporte për në BE tashmë të dyfishuara. Importet e mallrave u shtuan për 21% më 2007 dhe për 27% në shtatë muajt e parë të vitit 2008. produktet minerale (kryesisht naftë) mbeten kategoria më e madhe e importit (21% e

¹⁷ Pjesërisht për shkak të grevës në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në maj dhe qershor 2008, raporti i auditimit për buxhetin e vitit 2007 nuk ishte i disponueshëm në kohën e hartimit të raportit të progresit. Raporti i auditimit është burimi më i përshtatshëm mbi subvencionet për ndërmarrjet shtetërore.

¹⁸ Këto shifra janë dukshëm më të ulëta sesa në raportin e vjetshëm, për shkak të një vlerësimi të shtuar të GDP-së

importeve totale gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2008).

CEFTA dhe shtetet anëtare të BE-së vazhdojnë të jenë dt partnerët kryesorë tregues për Kosovën me përpjesë të barabarta prej 37.5% të tregtimit të përgjithshëm në gjysmën e parë të vitit 2008. Pjesa e eksporteve të destinuara për BE u shtua nga 38% më 2006 në 42% më 2007 dhe më tej në 50% në shtatë muajt e parë të vitit 2008. Pjesa e BE-së në importet totale mbetet rreth 35-36%. Bursa reale efektive e shkëmbimit e bazuar në indeksin e çmimit të konsumatorit filloi të rritet qëndrueshëm nga mesi i 2007-ës, pas një modeste rënieje modeste më 2006 për 2.8%¹⁹. Është e qartë se performansa e regjistruar e eksporteve nuk është nxitur nga konkurrueshmëria e shtuar e çmimeve. Në përgjithësi, integrimi ekonomik me BE është shtuar.

4. Standardet Evropiane

4.1. Tregu i brendshëm

Ky kapitull shqyrton kapacitetin e Kosovës që gradualisht ta përshtas legjislacionin dhe politikat e sa me ato të *acquis* lidhur me tregun e brendshëm, politikat sektorale dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë në përputhje me Procesin e Stabilizim Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Po ashtu, ky kapitull analizon kapacitetin administrativ të Kosovës. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit përfshin progresin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjes së Kosovës.

4.1.1 Qarkullimi i lirë i të mirave

Ka pasur progres në fushën e standardizimit. Agjencia Kosovare e Standardizimit, e cila është përgjegjëse për standardizimin dhe akreditimin, ka rritur stafin e saj prej pesë të punësuarve në tetë.

Agjencia Kosovare e Standardizimit nuk është anëtare e ndonjë organizate ndërkombëtare për standardizim. Në mungesë të anëtarësisë, Agjencia është në gjendje, sipas termave të Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Shqipërisë, të adoptojë dhe përhap standardet evropiane në Kosovë. CEN dhe CENELEC janë pajtuar për këtë Memorandum të Mirëkuptimit. Në vitin 2008, 665 standarde evropiane janë pranuar si standarde të Kosovës. Një komiteti i ri teknik është themeluar në fushën e standardeve elektroteknike.

Kosova ka aprovuar legjislacionin për makineri, tekstil/fibër, teleferik me shina, me qëllim që të afrohet me standardet evropiane. Këshilli Profesional për Standardizim dhe pesë komitetet teknike për standarde janë themeluar në fushat e ndërtimit, produkteve të naftës dhe gazit, shërbimeve të transportit dhe postës, menaxhimit dhe mekanizmave elektroteknik.

¹⁹ Vlerësime të FMN-së

Nuk ka progres për të raportuar për conformity assessment. Për momentin asnjë trup për conformity assessment nuk është akredituar ose përcaktuar. Akreditimi nuk është mandator për përcaktimin e tupave conformity assessment.

Është bërë progres i kufizuar për akreditimin. Një Bord i Akreditimit është themeluar dhe procedurat e reja janë aprovuar për akreditimin e testimit dhe kalibrimit të laboratorëve dhe për trupat inspektues. Një memorandum i mirëkuptimit për akreditim është nënshkruar me Shqipërinë.

Ka pasur njëfarë progresi në Metrologji. Ligji për Metrologji e forcon rolin e departamentit të metrologjisë si një agjencion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), i cili ka një staf prej 11 punëtorësh. Për më shumë, MTI ka themeluar një Këshill për Metrologji. Anëtarët e Këshillit përfshijnë përfaqësuesit e ministrisë, universiteteve, institucioneve nacionale shëndetësore dhe bizneseve private. Detyra e tij është të bëjë rekomandime dhe këshillojë për çështjet që kanë të bëjnë me metrologjinë. Kuvendi ka aprovuar tri pjesë të reja të implementimit të ligjit për metrologji, të gjitha në fushën e metaleve të çmuara.

Mbikëqyrja e tregut është fazë paraprake dhe mbetet shumë për të bërë për të siguruar sistemin e mbikëqyrjes së tregut në përputhje me *acquis*.

Asnjë progres nuk mund të vërehet në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Përgjithësisht, përgatitjet për të themeluar infrastrukturën e nevojshme horizontale për qarkullim të lirë të mallrave, janë në fazën fillestare. Duhet bërë përpjekje të konsiderueshme për të zhvilluar këtë infrastrukturë dhe për të përmirësuar kapacitetin përkatës administrativ për të siguruar përputhshmëri adekuate me standardet evropiane dhe implementimin. Përputhshmëria me standardet evropiane në fushën e qarkullimit të lirë të mallrave është e ndikuar nga mungesa e kapacitetit administrativ dhe resurseve financiare.

4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta për ndërmarrje

Përputhshmëri e kufizuar ka ngjarë për qarkullimin e lirë të njerëzve. Lëvizja e njerëzve në Kosovë është e vështirësuar nga situata politike dhe nga kërcënimet reale dhe të perceptuara të sigurisë, posaçërisht në mes të Veriut dhe pjesës tjetër të Kosovës. Përgjithësisht, përputhshmëria mbetet shumë e kufizuar.

Progres i kufizuar mund të vërehet për sa i përket të lirisë për të siguruar shërbime. Korniza legale për lirinë për të siguruar shërbime dhe për të drejtën për të themeluar është akoma fragmentare. Përputhshmëria me standardet evropiane është e kufizuar.

Nuk ka zhvillime për të raportuar në fushën e company law.

Përgjithësisht, pak progres mund të raportohet në këtë fushë.

4.1.3. Qarkullimi i lirë i kapitalit

Ka pasur njëfarë progresi për sa i përket qarkullimit të lirë të kapitalit.

Për sa i përket qarkullimit të kapitalit, Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës ka aprovuar politika më fleksibile për depozita kapitale të barasvlershme, duke lehtësuar qasjen nga degët e bankave të huaja në kapitalin e tyre paid-in në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të kushtetutës, Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës është transformuar në Bakën Qendrore të Kosovës. Ajo ka autoritet për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare.

Rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave duhet të zhvillohet domethënshëm. Sektori bankar duhet të jetë në gjendje që efektivisht të ndihmojë ekonominë duke siguruar shërbime moderne dhe financime afatgjata.

Nuk ka zhvillime për t'u raportuar për sistemet e pagesave.

Nuk ka ngjarë progres për sa i përket legjislacionit për pastrim të parave. Përgjithësisht, institucionet kryesore, që janë përgjegjëse për problemin e pastrimit të parave bashkëpunojnë mes vete. Qeveria ka lansuar një plan të veprimit në luftën kundër pastrimit të parave. Sidoqoftë, mbetet problematike mungesa e ekspertizës së gjyqësorit dhe forcimit të ligjit në hetimin dhe gjykimin e krimeve ekonomike komplekse. Zyra Prokurorisë Speciale të Kosovës akoma ka mungesë të prokurorëve lokalë të specializuar. Lufta kundër pastrimit të parave mbetet sfidë.

Përgjithësisht, legjislacioni për qarkullimin e kapitalit është pjesërisht në përputhje me standardet evropiane dhe ka pasur njëfarë progresi sa i përket kapacitetit administrativ. Sidoqoftë, përpjekjet përmbajtësore janë akoma të nevojshme, si për sa i përket legjislacionit, ashtu edhe sa i përket kapacitetit implementues.

4.1.4. Doganat dhe tatimet

Ka pasur njëfarë progresi në fushën e doganave.

Shërbimi i Doganave ka pranuar planet e reja të BE-së për dogana, duke deklaruar kritere të qarta të bazuara në praktikat më të mira të BE-së për të matur kapacitetin operacional dhe themeluar plane për reformimin e doganave në të ardhmen dhe përgatitur për përputhshmërinë me standardet dhe rregullat ndërkombëtare.

Në qershor 2008 një rregullore e re është futur në fuqi, e cila përcakton procedurat e doganave për t'u mundësuar doganave të ndërmarrin veprime kundër falsifikimit të mallrave, piratizimit të mallrave dhe dhunimit të të drejtave për pronën intelektuale.

Informacioni i Tarifës së Integruar të Kosovës (TARIK) është aprovuar tërësisht në përputhje me Sistemin e Harmonizuar dhe me Nomenklaturën e Kombinuar; po ashtu TARIK është operacional në dy gjuhët zyrtare në Kosovë dhe në gjuhën angleze.

Aktivitetet kontrabanduese janë shtuar prej shkatërrimit në muajin shkurt të dy pikave kufitare në Kosovën Veriore. Edhe Kosova edhe Serbia po përballen me humbje përmbajtësore të të ardhurave. KFOR kontrollon dokumentet e kamionëve që kalojnë, por nuk kryen kontrollime doganore të rregullta. Kamionët janë duke u drejtuar në Mitrovicë për leje doganore. Njësitë kundërdoganore të Shërbimit Doganor të Kosovës kanë filluar patrullime në të gjitha rrugët që vijnë prej Kosovës veriore. Pas deklaratës së pavarësisë, shumica e zyrtarëve doganorë të serbëve të Kosovës kanë dhënë dorëheqje.

Pothuajse 75% e të gjitha mbledhjes së taksave grumbullohen në kufi. Edhe përkundër mungesës së kontrollimeve të rregullta doganore në dy pikat kufitare në veri të Kosovës, përgjithësisht mbledhja e të ardhurave nga Shërbimi Doganor i Kosovës për janar-shtator 2008 ishte 12% është më e lartë se të ardhurat e mbledhura për të njëjtën periudhë në vitin 2007.

Kapaciteti i doganave është rritur, posaçërisht me sigurimin e një skaneri mobil për mallra, i cili është vendosur në pikat më të mëdha kaluese me ish republikën jugosllave të Maqedonisë dhe tre skanerëve për kontrollim të bagazhit, një prej të cilëve është caktuar për njësinë anti kontrabandë. Bashkëpunimi me vendet fqinje është përmirësuar. Ekzistojnë udhëzimet administrative për procedurat disiplinuese dhe për deklarim të pasurisë për të plotësuar Kodin e Procedurave Disiplinuese dhe ngritur standardet profesionale.

Sidoqoftë, kapaciteti i shërbimeve doganore për të zbatuar ligjin e doganave duhet të forcohet edhe më tutje për sa i përket trajnimit, equipment ris analysis, kontrolleve post kontrolluese dhe mbështetjes IT. Përpjekjet përmbajtësore duhen bërë për të siguruar implementimin efektiv të legjislacionit për dogana, posaçërisht për sa i përket të falsifikimit të mallrave. Çështja e shtrirjes së kontrolleve doganore në Kosovën veriore mbetet e hapur.

Përgjithësisht, legjislacioni i doganave të Kosovës është në përputhje me standardet evropiane. Përpjekje të rëndësishme nevojiten për të siguruar implementimin efektiv të legjislacionit, duke pasur parasysh që doganat sigurojnë hise të rëndësishme për të ardhurat e përgjithshme publike. Përpjekje të veçanta janë të nevojshme për të forcuar ligjin për të luftuar falsifikimin e mallrave dhe kontrabandës.

Nuk ka pasur progres në fushën e tatimeve.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka përmirësuar performansën. Përgjithësisht grumbullimi i ATK-së ka qenë diku 12% më i lartë në shtatë muajt e parë të vitit 2008 krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2007, duke ndryshuar trendet negative të viteve të fundit. Shqyrtimi i legjislacionit të Kosovës në lidhje me përputhshmërinë e tij me Kodin e Administrimit për Tatimin e Bizneseve sapo ka filluar.

Pajtueshmëria e taksave duhet të rritet si për të hyrave tatimore personale, ashtu edhe për ato korporative, por edhe për VAT.

Kapaciteti i ATK-së mbetet i dobët. Sistemi i Informacionit Menaxhues të ATK-së nuk është akoma operativ. Nevojiten përpjekje të mëdha për të përmirësuar shërbimet e taksapaguesve. Legjislacioni për tatime është vetëm pjesërisht në përputhje me standardet evropiane. Përputhshmëri e mëtutjeshme është e nevojshme, sikurse edhe përpjekje të rëndësishme për të garantuar fuqizim efektiv të legjislacionit. Mbledhja e taksave mbetet jashtëzakonisht e ulët dhe ekonomia informale e përhapur meqë kontrollet janë të kufizuara.

4.1.5. Konkurrenca

Nuk mund të raportohet progres.

Komisioni i Konkurrencës akoma nuk është operacional. Kuvendi akoma nuk i ka caktuar kandidatët për këtë komision. Kosova duhet të finalizojë vendosjen e Komisionit të Konkurrencës, përfshirë edhe përcaktimin e resurseve të nevojshme. Ligji për Ndhimë Shtetërore, qëllimi i të cilit është vendosjes së një Zyre për Ndhimë Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nuk është aprovuar akoma.

Përgjithësisht, dispozitat kosovare për konkurrencë nuk janë vendosur akoma.

4.1.6. Sigurimi Publik

Ligji për Sigurim Publik (amandamentuar në 2007) është pjesa kryesore e legjislacionit në këtë fushë. Ai është kryesisht në përputhje me standardet evropiane, edhe pse një numër i dispozitave të urdhëresave, aprovuar më 2004, nuk janë implementuar. E njëjta vlen edhe për regjim më fleksibil të sajuar për sektorin e shërbimeve komunale. Janë raportuar diskrepanca mes versioneve të gjuhëve të ndryshme të legjislacionit, gjë që duhet të përmirësohet për të garantuar siguri ligjore. Ligji për Sigurim Publike i përcakton procedurat e sigurimit detajisht dhe fokusohet më shumë në kërkesat procedurale, gjë që nuk ngjet në shumicën e vendeve të BE-së sepse zakonisht janë të përfshira në legjislacionin implementues.

LSP siguron bazën legale për Komisionin Rregullues për Sigurim Publik, Bordit Shqyrtues të Sigurimit Publik dhe Agjencisë për Sigurim Publik. Agjencia për Sigurim Publik aktualisht ka 13 punëtorë. Funksioni kryesor i saj është blerja qendrore. Ai po ashtu kryen disa funksione teknike dhe rregulluese në rastet kur procedurat e sigurimit janë implementuar duke kontraktuar drejtpërdrejtë autoritetet. Ai ka krijuar një bazë të të dhënave për të regjistrim dhe mbikëqyrje. Kjo paraqet kontribut të rëndësishëm për efektivitetin e statistikave dhe menaxhimit të sigurimit publik.

Komisionin Rregullues për Sigurim Publik është një agjenci përgjegjëse për zhvillim të përgjithshëm, mbikëqyrje dhe shqyrtim të sistemit të sigurimit. Ai përbëhet nga pesë anëtarë të nominuar nga qeveria dhe të caktuar nga Kuvendi për 5 vite. Së paku tre anëtarë duhet të kenë kualifikimet e njëjta me ato që kërkohen për gjyqtarë. Komisioni Rregullues për Sigurim Publik ka një staf mbështetës prej 18 personave. Bordit i ri

Shqyrtues i Sigurimit i paraparë në amendamentin e Ligjit për Sigurim Publik është themeluar në korrik dhe është trup kuazi-gjyqësor. Roli i tij është t'i rishqyrtojë vendimet administrative të lëshuara nga institucionet qendrore të sigurimit dhe ankesat e kërkesat e ofruesve. Suksesi i Bordit të ri Shqyrtues të Sigurimit varet në vendosjen e resurseve të mjaftueshme për shqyrtimin e vendimeve.

Trajnimi dhe çertifikimi i zyrtarëve të sigurimit në kontraktimin e autoriteteve është suspenduar për shkak të mungesës së bashkëpunimit mes Institutit Kosovar për Administratë Publike dhe Komisionit Rregullues të Sigurimit Publik.

Përgjithësisht, njëfarë progresi mund të raportohet në këtë sektor. Ligji për Sigurim Publik është në përputhje me standardet evropiane, përfshirë edhe procedurat e shqyrtuara por implementimi i dispozitave nuk është vendosur akoma dhe administrimi i përgjegjshëm nuk është akoma mjaftueshëm operativ. Përkushtimi prej të gjithë organizatave është e nevojshme për të konsoliduar progresin e bërë deri tani.

4.1.7. Ligji për pronën intelektuale

Për sa i përket pronës intelektuale, mund të raportohet progres i kufizuar.

Asnjë progres nuk mund të raportohet për sa i përket copyright-it dhe të drejtave që kanë të bëjnë me të.

Për sa i përket pronës industriale, Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Respektimin e të Drejtave të Pronës Intelektuale (Rregullorja 2008/22). Implementimi ka filluar në qershor të vitit 2008. Ligji mundëson marrjen e veprimeve kundër piratërisë, falsifikimit dhe për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale.

Zyra për Pronë Industriale është një agjencion i pavarur përgjegjës për implementimin e ligjeve për shqyrtim të vendimeve. Ajo është plotësisht operationale dhe ka filluar të pranojë dhe regjistrojë aplikacionet në nëntor të vitit 2007. Ajo ka një staf prej katër punëtorësh dhe ka pranuar 1,300 aplikacione deri tani. Ministria për Tregti dhe Industri ka aprovuar dy urdhëresa administrative: njëra për pagesat për regjistrimin e të drejtave të pronës industriale, tjetra ka të bëjë me rivërtetimin e të drejtave të pronës industriale me origjinë prej kohës së Jugosllavisë.

Zbatimi i përgjithshëm mbetet shumë i dobët. Vazhdon niveli i lartë i falsifikimit dhe piratërisë. Kosova nuk është akoma në gjendje të implementojë dhe zbatojë legjislacionin e saj kombëtar dhe obligimet e saj ndërkombëtare në këtë fushë. Kapaciteti administrativ për të implementuar të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale është i pamjaftueshëm dhe dispozitat implementuese janë akoma të nevojshme.

Përgjithësisht, parapërgatitjet e Kosovës në fushën e pronës intelektuale dhe industriale mbesin në fazën preliminare. Kapaciteti implementues është i kufizuar.

4.1.8. Punësimi dhe politikat sociale

Ministria e Punës ka prezantuar në prill të vitit 2008 Raportin Vjetor për Punë dhe Punësim. Sidoqoftë, shpenzimet e larta të lidhura me Strategjinë e Kosovës për Punësim (2008-2013) ka parandaluar aprovimin e saj.

Papunësia në Kosovë sipas shënimeve në Kosovë sillet në 43% të popullatës ekonomikisht aktive. Gjithsej 334,595 persona (krahasuar me 327,262 persona në 2006) janë regjistruar si të papunë nga shërbimet publike për punësim në Kosovë në vitin 2007; 93% e të regjistruarve si punëkërkues janë regjistruar për më shumë se 12 muaj.

Në mesin e të papunësuarve afatgjatë, grupet më të pafavorshme janë gratë, romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara. Sistemi aktual i përfituesve me aftësi të kufizuara ndikon në destimulimin e personave me aftësi të kufizuara që dëshirojnë të kërkojnë punë; përfitimi për personat me aftësi të kufizuara është gjendje në dispozicion për ata që nuk punojnë ose marrin pjesë në trajnime profesionale.

një fushë për shqetësim është punësimi i femrave. Gratë e reja ballafaqohen me papunësi më të madhe sesa meshkujt dhe më shpesh janë në rang shoqëror më të ulët.

Papunësia e të rinjve në Kosovë është posaçërisht e lartë në Kosovë. Plani i Veprimit për Punësim të të Rinjve në Kosovë nuk është implementuar akoma.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka kapacitet të vogël administrativ. Mundësia aktuale e zyrtarëve të Shërbimit për Punësim Publik për të ndihmuar punëkërkuesit është 1:1,600. Si rezultat, nuk ekzistojnë procedura të qarta për zhvillim, menaxhim, monitorim dhe evoluim të politikave dhe implementimit të tyre. Politikat e punësimit janë po ashtu duke u zhvilluar pa angazhimin e sektorit privat, aspekt ky që e minon efektivitetin e tyre.

Përgjithësisht progres i vogël mund të raportohet në sektorin e punësimit. Mungesa e kornizës legjislativë dhe strategjike dhe mungesa e kapacitetit ekzekutiv janë pengesa për zhvillimin e politikave adekuate të punësimit në Kosovë.

Sa i përket politikave sociale, nuk ka gjykata të specializuara për punëtorë në Kosovë.

Pak progres mund të vihet re në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë. Mungesa e legjislationit adekuat dhe përkushtimi politik është duke parandaluar arritjet e mëtutjeshme në këtë sektor. Inspektorati i Punës, i cili është përgjegjës për sigurimin e legjislationit për punësim, dhe posaçërisht për dispozitat e Ligjit për Siguri Profesionale, Shëndet dhe Ambient Pune, ka mungesë të kapacitetit për të kryer punën e tij efektivisht.

Progres shumë i kufizuar mund të raportohet për në fushën e dialogut shoqëror. Aktualisht janë 28 sindikata të punëtorëve të regjistruara në Kosovë. Sidoqoftë, partnerët shoqërorë janë të dobët dhe roli i tyre në vendim-marrje është marginal. Këshilli Këshillues Tre anëtarësh nuk është operacional. Marrëveshja Kolektive Kombëtare, e përfunduar në vitin 2004, nuk është implementuar kurrë për shkak të kufizimeve financiare. Kosova akoma nuk ka ligjin për sindikata të punëtorëve dhe ligjin për greva.

Në fushën e përfshirjes shoqërore, shërbimet për përkujdesje për personat me çrregullime mentale dhe psikiatrike janë të siguruara. Disa qendra të komuniteteve për shëndet mendor dhe strehime banuese janë themeluar nën autoritetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Sidoqoftë, Kosova nuk ka plan të veprimit për personat e paaftë për punë. Kosova ka mungesë të mjeteve për riintegrim shoqëror të personave të paaftë. Rehabilitimi dhe risocializimi i njerëzve me aftësi të kufizuara fizike është menaxhuar vetëm nga organizatat joqeveritare. Qasja në shkolla për personat me nevoja të veçanta nuk është e garantuar.

Në fushën e politikave të diskriminimit, qeveria ka deklaruar shtatorin 2008 si muaj të antidiskriminimit dhe ka organizuar disa ngjarje publike dhe sesione trajnimi për t'u siguruar shërbyesve civilë dhe publikut të përgjithshëm më shumë informata për politikat antidiskriminuese të Kosovës.

Mbrojtja shoqërore mbulon katër fusha të gjëra: (i) programet për pensione për të mbështetur personat e moshuar dhe të paaftë; (ii) programet e asistencës sociale për të ndihmuar njerëzit në nevojë; (iii) programe për veteranët dhe për ata që janë dëmtuar gjatë luftës dhe për familjet e të vrarëve ose të zhdukurve dhe (iv) ndihmë për gjetje të vende të punës për të qenë në gjendje për ndihmuar familjet e tyre. Sistemi për mbrojtje sociale është financiarisht i paqëndrueshëm dhe jo siç duhet i organizuar. Diku 325,000 njerëz janë të përfshirë në skemën sociale. 45% e popullatës së Kosovës jeton në varfëri dhe 18% në varfëri të skajshme. Ministria e Punës dhe mirëqenies Sociale ka kapacitet të kufizuar në këtë aspekt. Nuk ka mekanizëm IT adekuat për monitorim. Qeveria ka dorëzuar amendamente në Ligjin për Asistencë Sociale për të thjeshtëzuar implementimin dhe për të futur disa mundësi për sa i përket pranueshmërisë. Në fushën e shërbimeve sociale dhe përkujdesit institucional, nuk ka legjislacion adekuat. Sistemi i shërbimeve sociale mbetet centralisht i menaxhuar. Decentralizimi është duke u penguar nga kufizimet financiare dhe kapacitetit të kufizuar në nivelin lokal. Nuk ka punëtor social profesional në Kosovë me përvojë dhe kompetencë adekuate. Skema pensionale është ndryshuar për të rritur përfitimet e atyre që kanë kontribuar në fondin e vjetër Pensional të Jugosllavisë për më shumë se 15 vjet. Diku 132,421 njerëz aktualisht marrin benefite në bazë të skemës themelore pensionale.

Sistemi i sigurisë sociale mbetet cash based. Kosova nuk ka fond për sigurim shëndetësor.

Në fushën e politikës së shëndetit publik, Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Shëndetin Publik në shkurt të vitit 2008. Statistika të besueshme për shëndetësi nuk ka, gjë që e bën të vështirë analizimin e këtij sektori. Vdekshmëria e foshnjave dhe nënave mbetet më e larta në rajon. Shfaqjet e sëmundjeve ngjitëse janë alarmante dhe në rritje. Infrastruktura e lidhur me shëndetësi, përfshirë pajisjet mjekësore dhe kapacitetin e spitaleve, është e pazhvilluar.

Në përgjithësi, sektori i shëndetësisë është shumë i varfër dhe kërkon shtim të vëmendjes nga qeveria.

Përgjithësisht, punësimi dhe politikat sociale mbeten të dobëta.

4.1.9. Edukimi dhe hulumtimi

Qeveria ka identifikuar edukimin si prioritet për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Ajo është e përkushtuar për të zgjeruar bashkëpunimin ndërministror dhe të investojë më shumë resurse në këtë sektor (diku 170 milionë euro për periudhën 2009-2011). Në muajin maj Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Kornizën e Kualifikimeve Kombëtare duke institucionalizuar procedurat e kualifikimit dhe çertifikimit përmes themelimit të Autoritetit për Kualifikime Nacionale.

Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Edukim në Komuna, i cili është promulguar në qershor. Ligji synon të rregullojë organizimin e institucioneve publike të edukimit dhe të edukimit publik në komuna në nivel parafillor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë. Ligji përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e qeverisë qendrore dhe komunave nënfushën e edukimit.

Këshilli për Edukim Profesional dhe Trajtime është bërë operacional në vitin 2008.

Studimi i fizibilitetit për ‘Sector-Wide Approach in Education’ është kryer nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të organizatave, përfshirë shoqërisë civile. Ai identifikon mënyra për donatorët që të kontribuojnë më efektivisht në reformimin e arsimit. Janë themeluar grupet punuese dhe njëjësia e koordinimit të donatorëve.

Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka shtuar përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Programi ambicioz i qeverisë për ndërtimin e shkollave fokusohet në zonat urbane të dendura me popullatë. Shefi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit është caktuar në muajin mars. Ministria është duke e zhvilluar programin për arsim të lartë që është në përputhje me kërkesat për punë. Kosova ka konsoliduar pjesëmarrjen e saj në programet e European Tempus and Erasmus Mundus. Struktura e Tempus-it është forcuar dhe zgjeruar për të përfshirë universitetin publik serb. Pas përfundimeve të vlerësimit kompatibil me Bolonjën, Kosova ka suspenduar regjistrimin në institucionet private të arsimit të lartë; zgjerimi i licencave të tyre për të operuar është çështje e procesit të akreditimit të ardhshëm të udhëhequr nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit duke filluar nga 1 tetori. MASHT është në proces të shqyrtimit të programit në Trajnimin Profesional dhe Edukativ për 51 profile.

Sidoqoftë, sistemi arsimor i Kosovës vazhdon të jetë i prekur nga kufizimet e resurseve dhe buxhetit dhe mungesa e kualitetit të dobët të mësimdhënies. Motivimi i mësimdhënësve është seriozisht i dëmtuar nga pagat e ulëta dhe sistemi joadekuat i karrierës. Bashkëpunimi mes ministrisë partnerëve shoqërorë dhe sektorit privat është i pazhvilluar, shkollat akoma punojnë në ndërrime dhe qeveria akoma nuk ka bërë ndonjë

investim për zhvillimin e fëmijërisë së hershme. Për më shumë, jo të gjithë studentët kanë pranuar tekstet mësimorë pa pagesë, siç e parasheh ligji. Pjesëmarrja në edukim pas obligativ dhe trajnime është në mesin e më të ulëtave në Evropë. Agjencioni Kosovar i Akreditimit akoma nuk është operativ. Nuk ka cilësi dhe mekanizma monitorues.

Për më shumë, strukturat paralele dhe të bazuara në etnicitet duke përdorur programe dhe tekste mësimore të ndryshme janë burim i segregacionit. Nuk ka pasur progres për sa i përket përfshirjes së romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në sistemin arsimor. Legjislacioni përkatës dhe strategjia janë implementuar dobët dhe mësuesit me aftësi për gjuhët e minoriteteve janë të paktë. Trajnimi Profesional dhe Edukativ (VET) është i ndarë prej edukimit të mesëm të përgjithshëm dhe jo në përputhje me nevojat e ekonomisë së tregut. Kosova nuk ka dispozita alternative për edukim dhe trajnim post sekondar. Mungesa e akreditimit të provajderëve të VET-it minon besimin në skemën e certifikimit të VET-it. Koordinimi respektiv me Ministrinë e Punës nuk është efektiv.

Për sa i përket hulumtimit, MASHT dhe universitetet publike kanë demonstruar një interes në aktivitetet hulumtuese. Janë mbajtur diskutime për të shqyrtuar një pjesëmarrje më efektive të Kosovës në Program-Kornizën e Shtatë për Hulumtim të EC-së. Ministria ka themeluar departamentin për shkencë dhe teknologji dhe ka themeluar tre trupa të ri të përkushtuar për hulumtim: Këshilli Kombëtar për Shkencë, Qendra për Zbulime dhe Transfer të Teknologjisë dhe Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e Edukimit të Lartë, Shkencë dhe Teknologji.

Sidoqoftë, ministria ka ndërmarrë hapa për zhvillimin e hulumtimit dhe kapacitetin zhvillues të universiteteve në partneritet me industrinë. Nismat nga provajderët e edukimit të lartë mbesin shumë të kufizuara.

Përgjithësisht, përpjekjet për reformim të sistemit arsimor meritojnë mbështetje të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të prekshëm të cilësisë. Njëfarë progresi mund të raportohet në përfrimin me standardet e BE-së.

Për sa i përket hulumtimit, njëfarë progresi është bërë, por nuk është aprovuar politikë hulumtuese e përgjithshme ose nuk janë marrë masa specifike për të përmirësuar bashkëpunimin hulumtues dhe integrimin në Zonën Hulumtuese Evropiane.

4.1.10. Çështjet e WTO

Qeveria konsideron qasjen në Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO) si prioritet. Akoma nuk ka dorëzuar aplikimin formal.

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Është bërë përparim i kufizuar në lëmin e **industrialisë dhe të NVM-ve**. Sa i përket mjedisit biznesor, zyrat *one-stop shop* janë përmirësuar, duke e ulur kështu numrin e hapave administrativë që kërkohen për ta nisur dhe mbajtur një biznes. Është bërë i

mundshëm regjistrimi *on-line* me Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve.

Kosova gradualisht po zhvillon një gamë më të gjithëmbarshme të shërbimeve përkrahëse të bizneseve, duke i përfshirë parqet e biznesit dhe inkubatorët. Shërbimet përkrahëse të bizneseve përkrahen nga një varg donatorësh. Ka pasur zhvillime pozitive edhe në disponueshmërinë e mikro-kredive dhe të financave të donatorëve. Megjithatë, mungon bashkërendimi i duhur.

Agjencia për përkrahjen e NVM-ve e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për mbarëvajtjet e zhvillimit të NVM-ve. Kapacitetet e saj administrative mbeten të pamjaftueshme; aplikimet dhe mjetet *on-* nuk janë ende tërësisht operative. Janë pezulluar takimet e Këshillit Konsultativ mbi NVM-të që përfaqëson institucione qeveritare e joqeveritare. Agjencia për Promovimin e Investimeve, e cila ofron shërbime falas për të joshur investime të huaja i ka vazhduar aktivitetet e veta. Ende ka velëm një zyrë jashtë vendit, në Austri.

Nuk ka përparim në zhvillimin e vlerësimit të ndikimit rregullativ (VNR).

Kosova ka marrë pjesë në implementimin e Kartës Evropiane për Ndërmarrje të Vogla dhe mbetet e zotuar në të. Kosova duhet të caktojë një tjetër koordinator për procesin e Kartës si dhe ta fuqizojë Agjencinë për NVM në mënyrë që ajo t'i marrë punët përsipër nga asistenca teknike e UNMIK-ut.

Kosova e ka miratuar një strategji të re të mësimin të ndërmarrësisë, e cila ndërmarrësin e prezanton në kurrikulin e arsimit sekondar. Implementimi ende nuk është bërë.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e industrisë dhe të NVM-ve mbeten në fazë të hershme. Pengesat për operimin e NVM-ve mbeten të mëdha si dhe qasja ndaj financave është e vështirë. Bashkërendimi i përmirësuar i përkrahjeve prej donatorëve të shumtë për NVM-të duhet ta shtojë ndihmën për NVM si dhe efikasitetin e politikave.

4.2.2. Bujqësia dhe kultivimi i peshkut

Ka pak zhvillime që vlen të raportohen sa i përket harmonizimit me standardet evropiane. Janë shpallë ligjet mbi bujqësinë dhe bletarinë organike nga PSSP-ja në janar 2008. Kuvendi ende nuk e ka miratuar ligjin e ushqimit. Kjo po vazhdon t'i vonojë zhvillimet si dhe vënien në zbatim të legjislacionit të ndërlidhur implementues, por edhe themelimin e Agjencisë për Sigurinë e Ushqimit. Kërkohet miratimi i ligjit për ta qartësuar ndarjen e përgjegjësisë në fushën e sigurisë së ushqimit, në veçanti ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Nuk ka ndarje të qartë të përgjegjësisë ndërmjet shërbimeve të ndryshme në sektorin bujqësor (duke e përfshirë veterinarinë dhe administrimin fito-sanitar) dhe përkufizimit të marrëdhënieve ndërmjet niveleve qendrore, lokale e komunale.

Shpenzimet e Qeverisë në sektorin bujqësor në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës 2008 janë shtuar për 32% krahasuar me vitin 2007, ndonëse nga një bazë e ulët. Ka financime

të shtuara, ehe nga Buxheti edhe nga donatorët, duke i përfshirë ato për projekte substanciale për konsolidimin e tokës dhe shërbime këshillëdhënëse. Sektori bujqësor në Kosovë përballet me konkurrencë të fortë nga importet dhe kërkon investim në mënyrë që të modernizohet. Fermat janë tejet të vogla dhe s'janë të pajisura me teknologji moderne që do t'ua përmirësonin mundësitë për të garuar në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Instituti për Verari dhe Bujqësi është themeluar në mars 2007. Ende nuk ka veprime konkrete për ta rregulluar sektorin e verës dhe për ta implementuar Ligjin mbi Verën në përputhje me *acquis communautaire*.

Janë bërë hapa në aspektet implementuese të **Planit Për Zhvillim Bujqësor e Rural** (PZhBR) për vitet 2007-2013, i cili u miratua më 2007, veçmas sa i përket konsolidimit të tokës. Një Plan Veprimi i azhurnuar i PZhBR pritet të aprovohet më vonë gjatë vitit, ku do të përfshihen masa konkrete dhe të detajuara për një varg nënsektorësh bujqësorë. Plani i azhurnuar duhet gradualisht të vijë në linjë me qasjen e BE-së drejt zhvillimit rural në vendet potenciale candidate. Megjithatë, janë të kufizuara resurset financiare për implementimin e planit. Korniza ligjore për implementimin e PZhBR si dhe themelimi i institucioneve implementuese të PZhBR janë ende në stade shumë preliminare. Pa një bazë ligjore, nuk mund të shpenzohen madje as resurset aktuale të kufizuara financiare. Me asistencë nga projekti i financuar nga BE janë themeluar të parat Grupe të Veprimit Lokal si dhe Strategjitë e tyre të Zhvillimit Lokal bazuar në qasjen LEADER+ për katër komuna (Klinë, Shtime, Suharekë, Skenderaj dhe Gjilan).

Është shënuar njëfarë progresi në zhvillimin e politikës dhe të kornizës rregullative për përkrahjen e reformës së zbatueshme të tokës dhe për mbrojtjen e tokës bujqësore kundër zhvillimeve të paplanifikuara urbane. Megjithatë, prerjet ilegale, gjuetimi dhe ndërtime në tokë bujqësore po vazhdojnë. Me gjithë decentralizimin e Agjencisë Kosovare të Pyjeve nëpër Drejtori Rajonale të Pylltarisë, nuk ka sistem menaxhimi të qëndrueshëm të pyjeve.

Në fushën e **veterinarisë dhe të fito-sanitarisë**, planet për përmirësimin e institucioneve të agro-ushqimit janë veç në hapat fillestarë. Veterinaria e Kosovës si dhe Agjencia e Ushqimit i ka licencuar 32 thertore. Nuk ka ambiente për procesimin e nënprodukteve të kafshëve në Kosovë.

Janë në vend legjislacioni dhe infrastruktura për zbatimin e identifikimit efikas të kafshëve, regjistrimit dhe të kontrollit të lëvizjes megjithëqë këto nuk zbatohen si duhet. Është vënë në vend sistemi i identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit për gjedhe por mbetet në pikëpyetje operimi i tij i plotë dhe ende duhet të konfirmohet. Është duke u implementuar legjislacioni i veterinarisë mbi kontrollin e sëmundjeve të kafshëve dhe të çështjeve fito-sanitare, që synon të harmonizohet me standardet evropiane.

Nuk ka pasur zhvillime për sa i përket **kultivimit të peshkut**.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres legjislativ në fushën e bujqësisë, veterinarisë dhe ë çështjeve fitosanitare, ndonëse kërkohen përpjekje të tjera për ta implementuar dhe

zbatuar këtë, veçmas në veterinari dhe në çështje fitosanitare.

4.2.3. Mjedisi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka ndërmarrë hapa drejt zhvillimit të një kornize të integruar për legjislacionin mjedisor. Plan ii Veprimit Mjedisor i Kosovës është i lidhur me gjithsej 16 plane sektoriale. Megjithatë, vetëm katër nga 52 projektet e parapara për periudhën 2007-2010 janë implementuar deri më tash. Planet lokale të veprimit mjedisor janë nënshkruar për pesë komuna.

Mund të raportohet njëfarë progresi në fushën e **legjislacionit horizontal**. Pas miratimit të dispozitave mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) nëpërmjet Ligjit mbi Mbrojtjen Mjedisore, po fillon implementimi. Janë bërë do përpjekje për ta shtuar vetëdijen publike si dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështje mjedisore.

Nuk ka zhvillime për t'u raportuar në fushën e **cilësisë së ajrit**. Legjislacioni relevant nde mungon, dhe Kosova ende nuk ka rrjet monitorimi për cilësinë e ajrit.

Është bërë njëfarë progresi në fushën e **menaxhimit të mbeturinave**. Tri deponi komunale, në Gjakovë, Kaçanik e Prizren, tashmë janë rehabilituar. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) i ka përfshirë të gjitha 17 ndërmarrjet e ujit, mbeturinave dhe të ujitjes. Niveli i ulët faturimit të mbeturinave mbetet problem për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Ka pak progres për t'u raportuar në fushën e cilësisë së ujit. Është lëshuar një leje uji. Është miratuar një udhëzim administrativ mbi kriteret për përkufizimin e zonave të ujit të pijshëm. Ligji i Ujit mundëson themelimin e Autoritetit të Basenit të Ujit, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin e resurseve të ujit në territorin e baseneve të ujit. Implikimet buxhetore si dhe llogaridhënia e këtij institucioni ende mbetet të adresohen. Duhet të përcaktohen përgjegjësitë e ardhshme për operimin dhe mirëmbajtjen e ndërmarrjeve dhe të aseteve publike në sektorin e ujit, i cili do t'u transferohet komunave, Përgjegjësitë menaxheriale për trajtimin e ujërave të zeza urbane si dhe kontrollimin e vërshimeve duhet të përkufizohen gjithashtu. Menaxhimi i ujit përbën një element kyç në Planin e Veprimit të Mjedisit, duke marrë parasysh mangësinë në rritje të ujit në Kosovë dhe rajon. Niveli i ulët i faturimit të shërbimeve të ujit mbetet problem për shërbimet e ujësjellësit.

Nuk është bërë kurrfarë progresi në fushën e **mbrojtjes së natyrës**. Rishqyrtimi i Urdhëresës për Shpezët e Egra si dhe i Urdhëresës për Habitatin ende është në pritje.

Nuk ka progres në **kontrollin e ndotjes industriale dhe në menaxhimin e rrezikut**.

Ka shumë pak progres në fushën e **kemikalieve**. Është nxjerrë Ligji mbi Kemikaliet.

Nuk ka zhvillime për të raportuar në fushën e **organizmave të modifikuar gjenetikiisht (OMGj)**. Ligji për mbrojtjen kundër **zhurmës** ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2008.

Sa i përket **kapacitetit administrativ**, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit tani posedon personel të plotë dhe është operative. Sidoqoftë, resurset njerëzore e financiare të MMPH si dhe të institucioneve të ndërlidhura (si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar) janë ende larg nga të adresuarit në shkallë të mjaftueshme të sfidave ambientale të Kosovës. Bordi Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit ende nuk është themeluar. Duhet të përmirësohet ndjeshëm bashkërendimi vertikal si dhe ai horizontal ndërmjet të gjitha institucioneve të përfshira në çështje mjedisore. Investimet në infrastrukturën mjedisore duhet të shtohen në mënyrë substanciale, veçmas nëpërmjet përkrahjes nga donatorë ndërkombëtarë. Përgjegjësia për komunat aktualisht është e kufizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve në personel dhe në financa.

Marrë në përgjithësi, ka zhvillime të kufizuara për t'u raportuar në fushën e mjedisit, veçanërisht sa i përket legjislacionit horizontal. Kërkohen edhe angazhime të mëtejme në shumicën e sektorëve për miratim, implementim dhe vënie në zbatim të legjislacionit. Mungesa e resurseve njerëzore e financiare, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë komunal, mbetet problematike; e njëjta vlen për mungesën e mekanizmave përkatës të bashkërendimit ndërmjet institucioneve që merren me mbrojtjen e mjedisit.

4.2.4. Politika e transportit

Pak ka përparime në fushën e rrjeteve **trans-evropiane të transportit**. Kosova vazhdon të marrë pjesë aktivisht në Rrjetin Themelor Transportues Rajonal si dhe në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (OTEJL). Ajo po e përditëson dhe po implementon planin shumëvjeçar 2008-2012. Kërkohet bashkëpunim i vazhduar brenda OTEJL-t. Të dyja projektet – Korridori 7, që lidh Nishin me Prishtinën dhe Shqipërinë, si dhe Korridori 6 që lidh Malin e Zi me Prishtinën dhe Shkupin – janë përfshirë në planin shumëvjeçar 2008-2012 si përparësi qeveritare në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Kontrata për konstruktimin e seksionit të R7 (rreth 20 km nga kufiri me Shqipërinë) aktualisht është në proces tenderimi. Është themeluar Njësia e Planifikimit të Transportit brenda Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikimit (MTT); por i mungojnë resurset dhe përkrahja politike për ta kryer mandatin e saj. Megjithatë, infrastrukturën e transportit mbeten të varfra dhe të pazhvilluara në Kosovë. Kapaciteti institucional dhe administrativ duhet të fuqizohet ndjeshëm, si dhe korniza ligjore për Partneritetin Publik-Privat (PPP).

Në fushën e **transportit rrugor**, mund të raportohet njëfarë progresi. Ligji mbi Sigurinë në Rrugë ka hyrë në fuqi dhe janë miratuar tetë udhëzime administrative mbi krijimin e Këshillit të Sigurisë në Rrugë në bashkëpunim me ministritë e tjera të përfshira. Tani është operative baza e të dhënave e rrugëve. Është ndarë një pjesë substanciale e fondeve nga Buxheti i Kosovës (93 milion euro gjithsej) për të siguruar mirëmbajtje adekuate dhe më cilësore të rrugëve si dhe meremetim të rrugëve. Janë lëshuar disa udhëzime administrative mbi patentat e shoferëve dhe inspektimet teknike të automjeteve. Kriteri

për licencimin e operatorëve të transportit publik kërkon fuqizim për ta përmirësuar rregullimin e transportit publik të Kosovës.

Shumë pak përparim mund të raportohet në sektorin e **transportit hekurudhor**. Ligji i Hekurudhave të Kosovës ka hyrë në fuqi në qershor 2008 dhe ofron bazën ligjore për themelimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhës (ARrH) i pavarur nga MTT-ja. ARrH ende nuk është themeluar, sepse në pritje të emërimit të anëtarëve të bordit. UNMIK-u ka nënshkruar "Shtojcën për Memorandumin e Mirëkuptimit në Zhvillimin e Rrjetit Themelor Transportues Rajonal të Evropës Juglindore për hapësirën Transportuese Hekurudhore të Evropës Juglindore " në dhjetor 2007. Kosova është anëtar i Grupit Punues të Hekurudhës të themeluar nën kornizën OTEJL-it.

Transporti hekurudhor nuk është përparësi qeveritare. Infrastruktura hekurudhore dhe inventari hekurudhor si dhe niveli i shërbimeve hekurudhore mbeten në nivel tejet të ulët. Kompensimi i ofruar hekurudhave për ofrimin e shërbimit publik të pasagjerëve nuk i mbulon shpenzimet.

Nuk mund të raportohet kurrfarë përparimi në fushën e **transportit të kombinuar**. Kosovës ende i mbetet ta adoptojë strategjinë e transportit shumëmodal dhe ta zbatojë atë.

Në fushën e **transportit ajror**, ka pasur disa zhvillime. Ligji mbi Aviacionin Civil ka hyrë në fuqi në qershor 2008, duke i zëvendësuar rregulloret e UNMIK-ut mbi ARAC-in (Autoritetin Rregullativ të Aviacionit Civil). Në shtator 2008, është caktuar Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) që ta tejkalojë ARAC-in, por qeveria ende nuk i ka emëruar Anëtarët e Bordit të AAC-së. Kosova vazhdon të implementojë dispozita lidhur me Marrëveshjen e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Janë hartuar të gjitha instrumentet e transpozimit për Fazën 1 të MPEA-së, përfshirë disa dispozita ligjore nga Faza 2 e MPEA-së, por nuk janë miratuar ende. Harmonizimi i standardeve duhet të përshejtohet. Janë bërë një numër investimesh në Aeroportin e Prishtinës si pjesë e përgatitjeve për Çertifikimit Standard ANAC (Autoriteti Ndërkombëtar i Aviacionit Civil) të Aeroporteve.

Në përgjithësi, mund të raportohet njëfarë përparimi në fushën e transportit, sidomos në aviacion. Ka pak zhvillime në hekurudhë dhe në sektorët e transportit të kombinuar. Kosova i ka shtuar investimet në infrastrukturën e transportit më 2008, sidomos në shtrimin e rrugëve dhe në mirëmbajtjen e tyre. Megjithatë, kapacitetet implementuese mbeten të dobëta, sidomos në sektorin hekurudhor.²⁰

4.2.5. Energjia

Sektori i energjisë vazhdon të përballet me probleme serioze. Situata financiare e shërbimit të rrymës elektrike është tejet e pasigurt, kryesisht për shkak të nivelit tepër të ulët të akumulimeve prej faturimit të rrymës elektrike. Rrjedhimisht, furnizimi me rrymë

²⁰ DG TREN ka bërë komente të detajuara mbi konkluzat e kapitujve mbi energjinë dhe transportin, me pak sugjerime nga teksti.

mbetet i pasigurt dhe jo i besueshëm në Kosovë, veçmas në zonat e largëta. Ndërprerjet e rrymës janë ende dukuri të shpeshta.

Program qeveritar për 2008-2011 identifikon zhvillimin e sektorit të energjetikës si njërin nga përparësitë e veta kryesore Programi vë theks të veçantë në ristrukturimin e vazhdueshëm dhe liberalizimin e sektorit si dhe në përdorimin e rezervave të linjitet të Kosovës për prodhimin dhe eksportimin e rrymës. Në shtator qeveria ka miratuar një vendim zyrtar për ta privatizuar KEK-un. Qeveria po planifikon po ashtu një shtim madhor në investimin publik të sektorit, kryesisht për ta fuqizuar rrjetin e përcimit dhe të shpërndarjes si dhe për ta vazhduar punën në minierën e re në Sibovc.

Nuk ka pasur përparim sa i përket **stoqeve të naftës dhe sigurisë nukleare /mbrojtjes nga rrezatimi**. Në fushën e sigurisë nukleare /mbrojtjes nga rrezatimi, duhet të implementohen rregullat themelore dhe të themelohet një organ rregullativ përkatës dhe operativ. Çështjet e rëndësishme radiologjike përfshijnë menaxhimin e burimeve të mbyllura radioaktive, monitorimin mjedisor si dhe mbrojtjen nga rrezatimi në kontekstin e aplikimeve mjekësore e industriale. Duhet t'i kushtohet vëmendje parandalimit dhe luftimit të trafikimit ilegal me lëndë nukleare dhe lëndë të tjera radioaktive brenda Kosovës.

Sa u përket **tregut të brendshëm energjetik** si dhe implementimit të Marrëveshjes së Komunitetit Energjetik (MKE), rezultatet janë të përziera. Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) ka miratuar rregulla për eficientë energjetike. Kodi i shpërndarjes së rrjetit është miratuar nga Zyra Rregulluese e Energjetikës (ZRRÉ) siç kërkohet nga MKE-ja. Kjo i përcakton termat dhe kushtet për lidhjet të rrjeteve me voltazh të mesëm dhe të ulët si dhe për përdorim të sistemit të rrjetit. ZRRÉ-ja po ashtu ka miratuar kodin e njehsimit si dhe metodologjinë për kosto e lidhjes së përcimit. Qeveria nuk i ka përbushur kërkesat e MKE-së për të prezantuar llogaritë e zberthyer ndërmjet divizionit të minierave lokale, gjenerimit të rrymës, shpërndarjes së rrjetit si dhe furnizimeve deri nga mesi i tetorit 2008. Qëllimi i kësaj kërkesë është që të krijohen kushte për privatizimin e aseteve të Korporatës Elektro-energjetike të Kosovës në të ardhmen.. Për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet Qeverisë dhe rregullatorit, kërkesa për adoptimin e procedurës së autorizimit për kapacitetet e gjeneratës së re nuk është përbushur. Ka pasur zhvillime të kufizuara sa i përket zberthimit të distribucionit të KEK-dhe funksioneve të furnizimit. E njëjta vlen edhe për themelimin e Operatorit të Sistemit Distributiv (OSD) siç është parashtruar nga MKE. Kosova duhet të bëjë përparim të mëtejshëm në themelimin dhe implementimin e kornizës ligjore të MKE-së. Kapaciteti institucional dhe legjislativ si për MEM-in ashtu edhe për ZRRÉ-në kërkon fuqizim të mëtejshëm. Mbetet problematike joshja e personelit të kualifikuar. Faturimi dhe grumbullimi nëpërmjet faturave mbetet i dobët si burim i të ardhurave për KEK-un. Mospagesa e rrymës së konsumuar qoftë nëpërmjet mosfaturimit, mosshlyerjes së faturave, ose edhe vjedhjes së elektricitetit paraqet sfida madhore për KEK-un dhe është arsyeja kryesore për paaftësinë paguese dhe inflacionin e paqëndrueshëm të vazhdueshëm për kërkesës për rrymë. Me gjithë njëfarë përmirësimi të vogël gjatë vitit 2007 (që vijoi edhe përgjatë vitit 2008), humbjet teknike e financiare në sektorin e energjetikës vazhdojnë të mbeten të larta. Në vitin 2007, humbjet teknike përbënin 16.2% të kërkesës; vjedhja 22.4%; kurse humbjet e tjera komerciale 21.4%. Shkurt, plot 60% të kërkesës nuk

paguhet dhe KEK-u i ka humbur rreth 99 milion euro vitin e kaluar. Kërkohen përpjekje të fuqishme dhe të shtuara (duke përfshirë policinë dhe drejtësinë) për ta shtuar pagesën e faturave të energjisë si dhe përqindjet e shlyerjes së detyrimeve.

Operatori i Sistemit Përçues së Elektricitetit i Kosovës (OSPEK) është anëtar i Operatorëve të Sistemit Përçues të Evropës Juglindore (OSPEJL). Sidoqoftë, ky operator vazhdon të përballet me vështirësi në nivelin e grupeve punuese teknike të OSPEJL-it mbi kompensimin e ndër-përçimit si dhe mekanizmave të tregtimit tejkuftar. OSPEK nuk shpaguhet nga Operatori i Sistemit Përçues të Serbisë për elektricitetin që kalon transit nëpër rrjetin e tij.

Është arritur përparim në prezantimin gradual të çmimeve të rrymës që i pasqyrojnë kostot. Metodologjia e tarifave të Zyrës për Rregullimin e Energjisë (ZRRrE) mundëson prezantimin gradual të tarifave që reflektojnë kostot nëpërmjet shtimeve vjetore, për t'i ikur fryrjes disproporcionale të faturave për grupet sociale më të ndjeshme. Në të njëjtën kohë kjo metodologji ofron një tarifë të kapshme për klientët me të ardhura të ulëta. ZRRrE e ka linçuar çmimin e dytë të elektricitetit në tetor 2007. ZRRrE ka publikuar një dokument konsultimi në mars 2008 me komentet dhe pikëpamjet e veta mbi përçimin dhe tarifën e shitjes me pakicë për 2008. Tarifën e reja janë mesatarisht 5% më të larta sesa më 2007. Bordi i ZRRrE i ka aprovuar këto tarifa sapo janë caktuar anëtarët e tij të rinj, dhe tarifën janë bërë efektive më 1 korrik. Sipas skemës sociale të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, rreth 40.000 klientë marrin rrymë (500 kËh) që paguhet nga Buxheti i Kosovës (€4.5 milion).

Përgatitjet për zhvillimin e Termocentralit të ri Kosova C (Projekti për Zhvillimin e Rrymës me Linjit) u ngadalësua më 2008, meqë Qeveria vendosi ta shqyrtojë gjithë projektin. Projekti parasheh ndërtimin e deri më 2.000 MË të kapaciteteve të reja, të mbështetura nga zgjerimi i operacioneve të mihjes së linjitet në Sibovc me asete madhore që do t'u jepeshin me koncesion investitorëve privatë (duke i përfshirë elementet e Termocentraleve Kosova A dhe B). Një këshilltar ndërkombëtar transaksioni e ka shqyrtuar dhe miratuar parakualifikimin dhe ka filluar dialogun e strukturuar me katër ofertues të listës së ngushtë për ta zhvilluar pakon e ofertimit. Në vjeshtë këshilltari i transaksionit synon ta finalizojë kërkesën për propozimet që do të lëshohen për ofertuesit e listës së ngushtë. Ofertat përfundimtare priten nga fundi i majit 2009. Sipas orareve më optimiste dhe varësisht nga çështjet ligjore që duhet të zgjidhen, përmbyllja financiare duhet të pasojë brenda një viti, pra nga fundi i 2009-ës.

Megjithatë, oraret e paketës Kosova C nuk ndërliken mirë me nevojën për të filluar zhvillimin e minierës së re në Sibovc Jugperëndim. Burimet ekzistuese të linjitet në Bardh e Mirash priten të shterojnë nga viti 2010, ndërsa Sibovci nuk ka gjasë të nisë të japë linjit para vitit 2012, duke qene se përjeton vonesa në procesin për prokurimin e sistemeve të mbingarkuara të shkarkimit siç janë ekskavatorët, konvejerëve si dhe shpërndarësve. Qeveria ka ofruar mjete për hapjen e një minierë shtesë (miniera e Sitnicës) pranë Mirashit, e cila pjesërisht do ta mbulojë kërkesën për qymyr deri më 2012. Për ta mbushur boshllëkun e mbetur, KEK-u synon t'i përdorë disa nga pajisjet ekzistuese pa i rinovuar për të nisur mihjet në Sibovc Jugperëndim. Të gjitha këto përpjekje janë të synuara për ta ulur rrezikun e nevojës për të paguar importime të shtrenjta të rrymës me

çmime gjithnjë në rritje të tregut.

Zbatueshmëria financiare e projektit Kosova C në afat të gjatë si dhe ndikimi i tij në mjedis vazhdojnë të jenë shkak për shqetësime. Kosova C do të duhet të përputhet plotësisht me dispozitat e MKE-së sa i përket *acquis-së* së BE-së për projektet e reja të gjenerimit të rrymës (pra, në fushat e energjisë, mjedisit dhe të konkurrencës). Përveç kësaj, përputhja e plotë (sipas MKE-së) me Urdhëresën për Termocentralet me Djegie të Madhe deri më 2017 do të rezultojë me mbylljen e njësive të mbetura operative në Kosovën A.

Për më shumë, Qeveria është e vendosur të bëjë përpjekje të shtuar për t'i adresuar humbjet komerciale dhe vjedhjen e rrymës, duke përfshirë bashkëpunimin e përmirësuar me drejtësinë dhe policinë. Ajo po ashtu vë theks më të fortë mbi promovimin e burimeve të **energjisë së ripërtërishme**, duke i përfshirë hidrocentralet, si dhe mbi masat e **efikasitetit të energjisë**, ndonëse financimet qeveritare për të dyja janë të kufizuara. Një studim i para-fizibilitetit i financuar nga BE për ta vlerësuar potencialin e burimeve të ripërtërishme të energjisë (duke përjashtuar hidro-potencialin, i cili është vlerësuar në një studim të veçantë), i kompletuar në fillim të korrikut, ka gjetur se ka potencial të konsiderueshëm për energji solar dhe me biomasë, kurse potenciali i erës dhe ai gjeotermal është shumë i ulët. Studimi rekomandon projekte të demonstrimit për të instaluar panele solare për ngrohje të ujit në rezidenca individuale e kolektive, duke marrë parasysh se rreth 20% të shpenzimit të energjisë përdoret për ngrohjen e ujit.

Në përgjithësi, ka njëfarë progresi në fushën e energjisë, veçanërisht në ndërtimin e kapaciteteve institucionale të Ministrisë, Operatorit Rregullativ dhe të Sistemit Përçues (ORrSPK). Projekti për Termocentralin Kosova C po përparon mirë. Megjithatë, ka probleme të mëdha që duhen zgjidhur, e që përfshijnë përmirësimin e zbatueshmërisë financiare të shërbimit të rrymës elektrike (duke i ulur humbjet komerciale dhe joteknike), duke e shtuar stabilitetin e furnizimit dhe duke e ndaluar inflacionin e paqëndrueshëm të kërkesës, duke e azhurnuar infrastrukturën dhe duke e zgjidhur mungesën kërcënuese të Kosovës me linjit. Nuk ka progres për t'u raportuar sa i përket sigurisë nukleare dhe mbrojtjes nga rrezatimi.

4.2.6. Information Society and media

Njëfarë progresi mund të raportohet për sa i përket komunikimeve elektronike. Në sektorin e telefonisë mobile, operatori i dytë i telefonisë mobile është aktivizuar në treg. Pas aprovimit të kornizës së rregullatorit për hyrje të rrjetit të operatorëve mobil virtual (MVNOs) në Kosovë – duke mundësuar liberalizim të mëtutjeshëm dhe konkurrencë mes shërbimeve telefonike – Autoriteti Rregullues i Telekomunikimit (ART) ka lëshuar dy licenca MVNO në vitin 2008.

Në qershor, Kuvendi ka aprovuar amendamente për ligjin për telekomunikim me qëllim të forcimit të pavarësisë së ART-së. Ai po ashtu ka bartur të gjitha funksionet në fushën e vendosjes dhe menaxhimit në ART. ART dhe Komisioni i Pavarur i Mediave bashkëpunojnë në shqyrtimin e planeve për menaxhim të frekuencave.

ART ka aprovuar një rregullore në muajin nëntor të vitit 2007 për mënyrat e zgjidhjes së konflikteve mes siguruesit të shërbimeve të telekomunikimit.

Implementimi i sektorit të policisë (aprovuar në maj të vitit 2008) është shtyrë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit mes autoriteteve relevante. Nuk ka progres për të raportuar për sa i përket rritjes së konkurrencës në tregun e telefonisë fikse në Kosovë. Kosova është në fazën e hershme të liberalizmit; Kosova akoma nuk ka kodin e saj ndërkombëtar të telefonisë.

Kapaciteti administrativ në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në ART është i pamjaftueshëm. Nivelet e burimeve njerëzore dhe ekspertizës nuk mundësojnë funksionin adekuat. Sipas ligjit për Telekomunikacion, ART duhet të financohet përmes pagesave të licencave.

Nuk ka progres për të raportuar për sa i përket shërbimeve shoqërore informative.

Për sa i përket politikës audiovizuale, puna e Komisionit të Pavarur të Mediave është ndikuar nga mungesa e resurseve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. Rilicencimi i transmetuesve në Kosovë kërkon asistencë të qëndrueshme teknike dhe legale, e cila jashtë kompetencave aktuale të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Me një staf prej 22 personave, KMP ka mungesë të resurseve njerëzore dhe vazhdon të ballafaqohet me kufizime financiare. KMP ka dy punëtorë minoritarë. Kuvendi ka caktuar dy anëtarët e fundit të Këshillit të KMP-së në muajin mars.

Këshilli i KMP-së lëshon licenca, vendos në përtëritjen e tyre dhe jep të drejtat për përdorimin e frekuencave të transmetimit për entitetet e autorizuar. KMP nuk konsultohet sistematikisht nga institucionet tjera. Atribuimi i përgjegjësive për ndarje të frekuencave të ART ka privuar KMP-në prej burimeve të të ardhurave.

Fondi për të Mediat Minoritare, i cili ndan shpërblime për mediat e minoriteteve, grupeve multietnike dhe të pafavorshme, efektivisht është suspenduar. Nuk ka shpërndarë grante për vitin 2007, përveç transferimit të 176 mijë euro të RTK në Fond. Draft ligji për Menaxhimin e Fondit Minoritar nuk është finalizuar akoma.

Prej gjithsej 113 transmetuesve të licencuar në Kosovë, 43 janë prej komuniteteve minoritare.

Skema programore e transmetuesit shtetëror (RTK) është në përputhje me nenin 6 të Ligjit për RTK-në. Diku 16% e programit të RTK-së është në gjuhën e minoriteteve.

Këshilli i Shtypit të Kosovës dhe Instituti Kosovar për Media janë duke funksionuar siç duhet. Sidoqoftë, mbetet mospërputhje legale mes Ligjit për Shpifje dhe Fyerje dhe Kodit Penal. Edhe pse Ligji për Shpifje dhe Fyerje ka dekriminalizuar shpifjen në vitin 2007, sipas kodit penal ekzistues të UNMIK-ut mbetet kundërvajtje kriminale.

Instituti Kosovar i Medias është organizatë jofitimprurëse, me bord menaxhues të përbërë prej dhjetë anëtarëve që përfaqësojnë media të ndryshme të Kosovës. Instituti ka filluar në dhjetor të vitit 2006 me qëllim kryesor që të bëhet qendër për trajnime për gazetarët lokalë. Ai shërben për mediat nacionale, lokale dhe të minoriteteve.

Ligji për Qasje në Informata siguron caktimin e një Komisioneri për Informata, i cili akoma nuk është zgjedhur. Ligji për Copyright nuk është implementuar akoma.

Financimi i RTK-së vazhdon të jetë problematik. Ligji për RTK-në lejon Komisionin e Pavarur të Mediave që për çdo vit të vë pragun (of up to 20%) për reklama. Vënia e pragjeve për çdo vit vështirëson kapacitetin e RTK-së për të planifikuar zgjerim të investimeve. Udhëzimet e thesarit të Ministrisë së Financave për Ligjin për RTK janë shumë strikte.

Nuk ka zhvillime për t'u raportuar për sa i përket aprovimit të legjislacionit përkatës për implementim të Ligjit për Pragjet e Reklamave.

Pak progres është bërë në fushën e lirisë së shprehjes dhe rregullimit të mediave. Këshilli i Mediave dhe Institucioni i Mediave janë duke funksionuar siç duhet, edhe për kundër vështirësive për tërheqjen e stafit të kualifikuar. Liberalizimi i tregut ka progresuar pak prej kur operatori i telefonisë së dytë mobile ka filluar të ofrojë shërbimet e tij. Sidoqoftë, trupat e ndryshëm rregullator ballafaqohen me kufizime buxhetore dhe presione të jashtme.

4.2.7. Kontrolli financiar

Kuvendi ka aprovuar një Ligj për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënien. Ky ligj siguron themelimin e një njësie qendrore për harmonizimin e kontrollit financiar, roli i të cilës është zhvillimi i rregullave për kontroll financiar për sektorin publik dhe rregullimi i menaxhimit financiar dhe sistemit llogaridhënës.

Qeveria është duke shqyrtuar Ligjin për Auditim të Brendshëm. Pavarësia operationale e auditimit të brendshëm dhe harmonizimi me standardet e BE-së do të duhej të kishin kujdes të veçantë. Në nëntor 2007, njësia e harmonizimit qendror për auditim të brendshëm është bërë operationale. Kjo njësi zhvillon standarde, trajnon auditorët e brendshëm, monitoron zhvillimet e auditimit të brendshëm dhe siguron garantimin e cilësisë në punën e auditimit të brendshëm.

Shumë organizata me përgjegjësi buxhetore, përfshirë komunat, kanë siguruar një nivel minimal të aftësisë për auditim. Sidoqoftë, kapaciteti i përgjithshëm i auditimit ka nevojë të forcohet. Llogaridhënia menaxheriale, në veçanti, ka nevojë të forcohet edhe më.

Sa i përket auditimit të jashtëm, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar një Ligj për Auditorin Gjeneral. Ligji rregullon transferin e kompetencave të auditorit të jashtëm prej UNMIK-ut te autoritetet e Kosovës. Auditori Gjeneral duhet të mbetet një institucion i pavarur, që raporton në Kuvend.

Përgjithësisht, ka pasur njëfarë progresi në fushën e kontrollit financiar.

4.2.8. Statistikat

Ka pasur progres të kufizuar në fushën e statistikës.

Infrastruktura statistikore është e dobët. Mungesa e pavarësisë e Zyrës Statistikore të Kosovës është për shqetësim. Burimet e Zyrës Statistikore janë joadekuate dhe koordinimi i sistemit statistikor ka qenë i dobët.

Në fushën e klasifikimeve dhe regjistrimeve nuk ka progres për të raportuar. Përputhja me klasifikimet e BE-së dhe ato ndërkombëtare ka qenë e kufizuar. Kjo fushë ka nevojë për zhvillim përmbajtësor të mëtutjeshëm.

Për sa i përket sektorit të statistikës, ka pasur progres minor në fushën e statistikës ekonomike, biznese dhe bujqësore. Pilot projektet janë kryer për treguesit e çmimeve të prodhuesit dhe statistikave biznesore. Rezultatet janë përdorur si burime për llogaritë kombëtare. Janë ndërmarrë iniciativa për zhvillimin e statistikës së turizmit. Në fushën e statistikës makro-ekonomike, vazhdon zhvillimi i llogarive kombëtare. Në mars të vitit 2008, Zyra e Statistikave ka aprovuar një metodologji të re për vlerësuar konsumin në ekonominë e shtëpisë.

Parapërgatitjet për regjistrimin e popullatës dhe shtëpive kanë qenë çështja kryesore për sa i përket statistikës demografike dhe shoqërore. Puna përgatitore teknike është kryer dhe do të testohet me regjistrim eksperimental të shkallës së vogël.

Përgjithësisht, progres i kufizuar mund të raportohet në fushën e statistikës. Zyra e Statistikës nuk është një prodhues i pavarur e statistikave zyrtare. Zyra e Statistikës së Kosovës ka kapacitet të pamjaftueshëm administrativ dhe koordinues. Progresi i bërë është përgjithësisht i kufizuar në zonat ku është dhënë asistencë.

4.3. Drejtësi, liri dhe siguri

4.3.1. Viza, kufiri, kontrolli, azili dhe migrimi

Kosova nuk ka regjim të vizave. Policia e Kosovës ka mundësi të kufizuara të kontrollit të lëvizjes së personave në dhe jashtë Kosovës.

Ligji për të Huajt është adoptuar në shkurt dhe është promulguar në qershor. Ai përfshin dispozita të detajuara për natyralizimin e të huajve në Kosovë.

Në shkurt të vitit 2008 është aprovuar Ligji për Dokumentet e Udhëtimit. Në maj të vitit 2008 Ministria e Brendshme ka filluar të prodhojë pasaportat e Kosovës. Shpërndarja e këtyre pasaportave ka filluar në korrik. Pasaportat nuk shquhen për tipare biometrike. Tipari i tyre i sigurisë përfshin UV-print, shenjën e gishtit dhe siluetën bardhë e zi.

Për sa i përket kufirit dhe çështjeve kufitare, në maj Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Menaxhimin e Kufirit të Integruar dhe Sigurisë së Kufirit. Qeveria ka aprovuar Strategjinë e saj Menaxhuese për Kufirin e Integruar në muajin nëntor të vitit 2007, por akoma nuk e ka lëshuar planin e veprimit korrespondues. Shërbimet e Policisë Kufitare të Kosovës kanë filluar të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të Shqipërisë, ish republikës jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Struktura themeluese e Ministrisë së Brendshme lejon për komplementimin dhe nuk specifikon shpërndarje të qartë të detyrave. Kapaciteti i Drejtoratit për Kufi, Strehim dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Brendshme mbetet i pamjaftueshëm. Klasifikimi dhe kombinimi i përgjegjësive të këtij drejtorati është çështje për shqetësim. Numri i përfaqësuesve të serbëve të Kosovës në Policinë Kufitare ka rënë dukshëm pas deklaratës së pavarësisë. Policia Kufitare nuk ka kontroll mbi disa pika kaluese. Përgjegjësia për kontrollin e kufirit të gjelbërt mbetet te UNMIK-u. Policia Kufitare kryen disa patrullime të përbashkëta me KFOR-in.

Procesi i përcaktimit të kufirit ish republikën jugosllave të Maqedonisë ka filluar në qershor. 69 nga 70 shtyllat kryesore kufitare të planifikuara janë vendosur. Kufiri me Serbinë nuk është përcaktuar. Kufiri me Malin e Zi nuk është përcaktuar po ashtu dhe kufiri me Shqipërinë është shënuar vetëm pjesërisht. Janë një numër i kalimeve kufitare jozyrtare ose sezonale që nuk kontrollohen ose kontrollohen pjesërisht nga autoritetet e Kosovës. Akoma nuk ka marrëveshje formale të nënshkruar me vendet fqinje për menaxhimin e kufirit të integruar.

Policia Kufitare nuk ka as sistem të duhur komunikimi për të mbledhur dhe shkëmbyer të dhëna për daljet dhe hyrjet, as qasje në të dhënat për krimet e personave që dëshirojnë të hyjnë ose dalin nga Kosova. Sistemi IT i përdorur në tri kalimet kryesore kufitare nuk është kompatibil me pajisjet e përdorura në BE. Nuk shkëmbim të zbulimeve me pjesët tjera të Policisë së Kosovës.

Bashkëpunimi mes agjencioneve të ndryshme të Kosovës të involvuara në IBM është duke u përmirësuar. Sidoqoftë, nuk ka marrëveshje formale për bashkëpunimin operacional mes aktorëve të ndryshëm. Duhet edhe më shumë përpjekje për sa i përket trajnimeve të zyrtarëve të angazhuar në menaxhimin e kufirit.

Kuvendi ka miratuar Ligjin për Azil në maj. Departamenti për kufi, azil dhe migrim në Ministrinë e Brendshme ka vazhduar të ndërtojë kapacitetin e tij menaxhues. Sidoqoftë, departamenti ka kapacitet të kufizuar për t'i trajtuar rastet e azilit. Nuk ka qendër të pranimit për azilkërkuesit ose të kthyerit vullnetarë. Kosova pranon shumë pak aplikacione për azil.

Ka pasur progres të vogël në migrim. Në janar të vitit 2008, drejtorati për kufij, azil dhe migrim ka marrë përgjegjësinë për trajtimin e të kthyerve nga vendet e treta. Akoma nuk ka Ligj për Migrim.

Përgjithësisht, ka pak progres për t'u raportuar në fushën e kontrollit kufitar dhe azilit. Kapaciteti i Policisë Kufitare për të kryer kontroll efektiv të kufirit, posaçërisht në Kosovën Veriore dhe në kufijtë e gjelbërt, ka nevojë për t'u përmirësuar dukshëm.

4.3.2. Pastrimi i parave

Lufta kundër krimit financiar është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovë.

Një plan i veprimit për pastrimin e parave është aprovuar në muajin gusht.

Qendra Inteligjente Financiare është entitet mbikëqyrës për institucionet jo-financiare. Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës mbikëqyr institucionet financiare. Ka bashkëpunim të mirë mes këtyre dy institucioneve dhe doganave. Bashkëpunimi me gjykatat dhe me trupat për forcimin e ligjit është përmirësuar, siç kanë demonstruar rastet e fundit të profileve të larta. Kurset trajnuese janë organizuar nga Policia e Kosovës për të zgjeruar kapacitetin hetues financiar në kuadër të drejtoratit të krimit të organizuar.

Sidoqoftë, mbetet problematike mungesa e ekspertizës në gjyqësi dhe përforcimin e ligjit në hetime dhe gjykime të krimeve ekonomike komplekse. Zyra e Prokurorit Special të Kosovës ka mungesë të prokurorëve lokal dhe të specializuar. Nuk ka mundësi për ruajtje të evidencave. Komunikimi mes njësisë për hetim të krimeve ekonomike dhe korrupsionit të Policinë e Kosovës dhe njësisë rajonale që merren me krime financiare mbetet i varfër dhe akoma nuk ka të dhëna të përbashkëta. Vëzhgimi i obligimeve raportuese nga institucionet jobankare është i pamjaftueshëm. Mungon bashkëpunimi i administratës tatimore të Kosovës. Ligji kundër pastrimit të parave nuk është adekuat dhe ka hetime të pamjaftueshme të raporteve të transaksioneve të dyshimta. Virtualisht nuk ka mbikëqyrje të sektorit real shtetëror. Luftimi i pastrimit të parave karakterizohet me ndarje të kompetencave mes trupave të ndryshëm lokal dhe ndërkombëtar.

Përgjithësisht, progresi në luftimin e pastrimit të parave ka qenë i pamjaftueshëm. Pastrimi i parave vazhdon të jetë problem serioz.

4.3.3. Droga

Kosova gjendet në rrugën e trafikimit të heroinës në Ballkanin Jugor. Ngarkesat me heroinë prej Turqisë futen përmes kufirit të ish republikës jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës, i cili është vështirë të kontrollohet. Ngarkesat vazhdojnë në Serbi dhe Hungari ose Shqipëri. Policia e Kosovës ka kryer disa hetime dhe konfiskime gjatë periudhës raportuese.

Mungesa e statistikave të besueshme dhe mungesa e zbulimeve ka pamundësuar hartimin e një plani të veprimit ose strategjie për të luftuar drogat. Policia e Kosovës ka mungesë të aftësive dhe pajisjeve për të zënë trafikimin e drogës. Ka bashkëpunim të pamjaftueshëm ndërkombëtar dhe mes agjencive në luftën kundër trafikimit të drogës.

Konsumimi i drogës nuk është i njohur si shqetësim i madh në Kosovë. Sidoqoftë, përdoruesit e drogës janë shtuar. Raste të vdekjes përmes overdozës janë raportuar.

Përgjithësisht, nuk ka pasur progres për t'u raportuar. Trafikimi i drogës vazhdon të jetë problem serioz në Kosovë.

4.3.4. Policia

Performanca e Policisë së Kosovës për sa i përket ruajtjes së rendit publik dhe luftimit të krimin minor në zonat e populluara me shumicë është e kënaqshme. Ligjet Policinë dhe Inspektoratin e Policisë janë aprovuar në shkurt të vitit 2008. Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim në mars të vitit 2008 është konvertuar në një agjenci ekzekutive të Ministrisë së Brendshme.

Pas shpalljes së pavarësisë, shumë zyrtarë të policisë prej serbëve të Kosovës kanë braktisur punën. Në disa zona jo me shumicë, funksionimi i forcës policore multietnike nuk është plotësisht efektiv.

Nuk ka pasur përmirësim në shkëmbim të zbulimeve mes strukturave të ndryshme të Policisë së Kosovës. Marrëdhëniet mes shërbimit publik të prokurimit vazhdojnë të jenë të vështira. Nuk ka shenja të dukshme as të përmirësimit të ndjeshëm të kapaciteteve hetuese as të përdorimit strategjik të inteligjencës për qëllime të policisë. Rrogat për policë janë të ulëta. Qendrat policore të Kosovës akoma nuk i plotësojnë standardet ndërkombëtare. Kapacitetet për hetim dhe kontroll të brendshëm të Policisë së Kosovës duhet të forcohen edhe më. Strategjia për reduktim të krimit nuk është implementuar akoma. Nuk ka strategji për mbledhjen e armëve. Ligji për armët e vogla është i pakompletuar dhe zbatimi i tij nuk është i suksesshëm. Akoma nuk ka ligj për mjekësi ligjore dhe autopsi. Policia e Kosovës e bën përdorim të pamjaftueshëm të statistikës së krimeve si vegël për menaxhim.

Numri dhe disponueshmëria e armëve të vogla, armëve me dritë dhe eksplozivëve, sikurse edhe prania e vazhdueshme e municionit të pashpërthyer që qarkullon në Kosovë, paraqet problem shumë serioz. Mungesa e kornizës legjislative adekuate çon në qarkullimin e parregulluar të armëve, gjë që ndikon në shkallën e krimit dhe sigurinë publike në Kosovë.

Përgjithësisht, njëfarë progresi mund të raportohet në fushën e policisë, por krime të nivelit të lartë dhe mungesat strategjike mbesin problem serioz.

4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmi

Nuk ka as strategji as plan veprimi për të luftuar krimin e organizuar. Nuk ka bazë legale për menaxhimin e aseteve të konfiskuara, gjë që rezulton në humbje të ndjeshme për buxhetin e Kosovës. Mungesa e regjistrimit të saktë është pengesë serioze për konfiskimin e aseteve reale shtetërore. Luftimi i krimit të organizuar është prioritet kryesor në Partneritetin Evropian për Kosovën.

Mungon përcaktimi dhe kapaciteti i kërkuar për të ndaluar efektivisht krimin e organizuar. Policia priret të fokusohet në ruajtjen e rendit dhe jo në krimin e organizuar.

Gjyqësori nuk ka kapacitet që të ndalë seriozisht krimin e organizuar. Motivimi i prokurorëve publik për të ndalë krimin e organizuar është i minuar nga mungesa e kushteve adekuate të punës, pagave dhe përkujdesja shoqërore.

Kosova mbetet një zonë e origjinës, transitit dhe destinimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Viktimat e trafikimit (kryesisht për shfrytëzim seksual) janë kryesisht nga Moldavia, Rusia dhe Ukraina. Janë duke u rekrutuar në trafikim një numër në rritje i shqiptareve të Kosovës në moshë jomadhore dhe prej familjeve me situatë të pafavorshme.

Ligji për trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimi i organizuar janë përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Zëvendës Ministri i Brendshëm është nominuar Koordinator Kombëtar për Anti Trafikim. Strategjia dhe Plani i Veprimit për luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore është aprovuar në korrik.

Sidoqoftë, prokurorët dhe gjyqtarët nuk janë të përgatitur për t'u marrë me viktimat e trafikimit. Prokurorët nuk janë proaktiv dhe bazohen kryesisht në deklaratat e viktimave. Disa dispozita të Kodit të procedurës Penale për trafikimin e qenieve njerëzore nuk janë adekuate.

Bashkëpunimi mes njërive qendrore dhe rajonale të Policisë së Kosovës që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore vazhdon të jetë problem për shqetësim. Njësitë rajonale ballafaqohen me mungesë të mbështetjes në nivel qendror, posaçërisht në logjistikë. Mungesa e të dhënave në nivel qendror vështirëson përdorimin e inteligjencies për veprime kundër lloji të krimit. Njësitë rajonale për trafikimin e qenieve njerëzore nuk kanë vetura të pashënuara dhe kanë mungesë të mjeteve teknike. Riintegrimi shoqëror i viktimave të trafikimit mbetet problematik. Janë disa shtëpi të sigurta. Qasja e organizimit të trajnimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimi i aktorëve të ndryshëm shtetëror në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore është e nevojshme. Implementimi i strategjisë dhe planit të veprimit për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore është joadekuat.

Për sa i përket luftës kundër terrorizmit, njësia kundër terrorizmit vazhdon aktivitetin e saj me stafin e Drejtoratit për Krime të Policisë së Kosovës, por kjo është akoma nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të UNMIK-ut. Disa aktivitete specifike trajnuese kanë ngjarë dhe një plan për personel të mëtutjeshëm është duke u zhvilluar. Përgatitjet në këtë fushë janë akoma në fazën e tyre fillestare.

Përgjithësisht, progres i vogël është bërë në fushën e luftimit të krimit të organizuar. Krimi i organizuar vazhdon të jetë problem serioz. Progres shumë i kufizuar është bërë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Nuk ka zhvillime për t'i raportuar. Akoma nuk ka ligj të përgjithshëm për zhvendosjen e Urdhrit për Mbrojtje të të dhënave dhe akoma nuk është formuar autoriteti i pavarur mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave. Kjo mbetet çështje për shqetësim.

ANEKS STATISTIKOR

TË DHËNA STATISTIKORE (29 shtator 2008) Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Të dhëna themelore	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Popullata (mijë)	1)	:	:	:	:	1 985	2 016	2 041	2 070	2 100	2 127
Hapësira totale e vendit (km ²)		10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	:

Të ardhurat kombëtare	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Bruto Produkti i Brendshëm (GDP) (million national currency)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
GDP (million euro)	2) 3)	:	:	:	1 624	1 735p	1 797p	3 007p b	3 068p	3 192p	:
GDP (euro per capita)		:	:	:	:	:	905p	1 473p b	1 482p	1 520p	:
GDP (në Standardet e Fuqisë Blerëse (PPS) per capita)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: GDP (në Standardet e Fuqisë Blerëse (PPS) per capita, EU-25=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Çmimi i rritjes së GDP (monedha kombëtare, çmimet konstante, % ndryshimi në vitin paraprak)		:	:	:	:	1.2p	3.1p	:	:	:	:
SI: Rritja e Punësimit (të ardhurat kombëtare, % ndryshimi në vitin paraprak)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punëtorëve: rritja e GDP për person të punësuar (%ndryshimi në vitin paraprak)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Rritja e shpenzimeve të njësisë punëtoresh (të ardhurat kombëtare, % ndryshimi në vitin paraprak)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Produktivitetit I punëtorëve (GDP në PPS për person të punësuar, EU-25=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera bruto e shtuar prej sektorëve kryesorë (%)											
Bujqësia		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Industria		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Ndërtimi		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shërbimet		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shpenzimet e konsumit final, si hise e GDP (%)		:	:	:	163.1	151.6	147.5	109.7p b	111.9p	111.5p	:
Ekonomia shtëpiake dhe NPISH, si hise e GDP (%)		:	:	:	101.3	96.9p	96.2p	85.3p b	89.0p	90.6p	:
Qeverisja e përgjithshme, si hise e GDP (%)	4)	:	:	:	61.8	54.6p	51.4p	24.5p b	23.0p	21.0p	:
Formimi I kapitalit bruto të fiksuar, si hise e GDP (%)	5)	:	:	:	40.7	34.5	29.3	19.4p b	19.3p	20.6p	:
Ndryshimet në inventar, si hise e GDP (%)		:	:	:	:	:	:	3.9 b	4.2	4.4	:
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, relative me GDP (%)		:	:	:	16.6	12.5p	10.4p	7.1p b	7.0p	8.9p	:
Importi I mallrave dhe shërbimeve, relative me GDP (%)		:	:	:	120.4	98.6p	87.1p	40.1p b	42.5p	45.5p	:

Industri	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Treguesi I volumit të prodhimit industrial (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Tarifa e inflacionit	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
SI: Indeksi I çmimeve të konsumatorit (CPI), (total, % ndryshim në vitin paraprak)		:	:	:	:	-1.0	0.3	-0.8	-2.1	-1.5	2.8

Bilansi i pagesave	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse (million euro)		:	:	:	-140	-201	-284	-317	-380	-389	-536
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: bilansi tregtar (million euro)		:	:	:	-962	-871	-856	-971	-1 044	-1 141	-1 360

Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: eksporti i mallrave (million euro)		:	:	:	269	217	186	57	56	111	147
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: importi i mallrave (million euro)		:	:	:	1 231	1 088	1 042	1 028	1 100	1 252	1 506
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: shërbimet rrjetore (million euro)		:	:	:	-725	-622	-523	-9	-36	-15	-18
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: të hyrat rrjetore (million euro)		:	:	:	185	149	123	17	24	29	50
Bilansi i pagesave: totali i llogarisë rrjedhëse: transferet rrjedhëse rrjetore (million euro)		:	:	:	1 361	1 143	973	646	675	738	792
Transferet qeveritare (million euro)		:	:	:	1 144	902	732	432	395	389	389
Investimi I Drejtpërdrejtë i Jashtëm (FDI) in the reporting economy (million euro)		:	:	:	:	:	:	19	80	250	422

Financa Publike	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Deficiti i përgjithshëm qeveritar/surplus, lidhur me GDP (%)		:	:	:	:	8.4	2.2	2.7	:	:	:
SI: borxhi i përgjithshëm qeveritar, lidhur me GDP (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Indikatorët financiar	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, lidhur me GDP (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Bruto borxhi i jashtëm i tërë ekonomisë, lidhur me eksportet totale (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M1 (banknota, hekurat, depozita të shpejta, million euro)		:	:	761	971	998	891	713	572	:	:
Furnizimi me para: M2 (M1 plus depozita me afat deri në dy vite, million euro)		:	:	761	1 096	1 126	1 111	1 128	1 092	:	:
Furnizimi me para: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, million euro)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kredit total prej institucioneve financiare monetare te banorët (I konsoliduar) (million euro)		:	:	3	26	87	233	374	514	637	891

Përqindja e interesit: përqindja e përditshme e parave, per annum (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e interesit huamarrës (një vit), per annum (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e interesit të depozituar (një vit), per annum (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e shkëmbimit të euros: mesatarja - 1 euro = ... të hyrat kombëtare	3)	:	1.000	1.000	1.000	1.000	1.000	1.000	1.000	1.000	:
Indeksi I përqindjes së shkëmbimeve efektive (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera e asetëve rezervë (përfshirë arin) (million euro)		:	:	25	200	58	77	79	107	102	167

Tregtia e jashtme

	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Bilansi tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (million euro)		:	:	:	:	:	:	-1 007	-1 101	-1 195	-1 411
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (million euro)		:	:	:	:	:	:	57	56	111	165
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (million euro)		:	:	:	:	:	:	1 063	1 157	1 306	1 576
Marrëdhëniet tregtare (indeksi I çmimit të eksportit / importi I çmimit të importit)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Ndarja e eksporteve për 27 vendet e BE-së në vlerë të eksporteve totale (%)		:	:	:	:	:	:	29.4	38.4	38.0	42.0
Ndarja e importeve për 27 vendet e BE-së në vlerë të importeve totale (%)		:	:	:	:	:	:	39.5	37.3	34.4	36.3

Demografia

	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Përqindja e rritjes natyrale: ndryshimet natyrale (lindjet minus vdekjet) (per 1000 banorë)	1)	:	:	:	:	:	12.8	14.1	14.6	12.8	12.4
Përqindja e migrimit: imigrantët minus emigrantët (per 1000 banorë)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e mortalitetit të fëmijëve: vdekja e fëmijëve nën moshën një vjeçare per 1000 lindje		:	:	:	:	11.2	15.1	11.8	9.6	12.0	11.1
Jetëgjatësia: meshkuj (vite)		:	:	:	:	:	67.0	:	:	:	:
Jetëgjatësia: femra (vite)		:	:	:	:	:	71.0	:	:	:	:

Tregu Punues

	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Përqindja e aktivitetit ekonomik (15-64): ndarja e popullatës të moshës 15-64 që është ekonomikisht aktive (%)		:	:	:	45.6	52.8	50.3	46.2	49.2	52.3	46.8
SI: Përqindja e punësimit (15-64): ndarja e popullatës të moshës 15-64 që është ekonomikisht aktive (%)		:	:	:	19.6	23.8	25.3	27.7	28.5	28.7	26.2
Ndarja e meshkujve të moshës 15-64 që është e punësuar (%)		:	:	:	31.1	39.4	42.8	46.4	45.8	46.1	40.1
Ndarja e femrave të moshës 15-64 që është e punësuar (%)		:	:	:	8.1	8.8	8.3	9.9	11.7	11.8	12.7
SI: Përqindja e punëtorëve të vjetër të punësuar (55-64): ndarja e popullatës të moshës 55-64 që është e punësuar (%)		:	:	:	16.7	18.4	20.1	23.9	25.2	26.3	24.6
Punësimi nga sektorët kryesorë (%)											

Bujqësia		:	:	:	6.2	10.3	17.3	24.7	18.8	21.4	16.9
Industria		:	:	:	16.9	17.2	15.4	14.0	14.4	12.4	14.1
Ndërtimi		:	:	:	8.6	11.2	11.3	8.0	7.9	8.1	10.4
Shërbimet		:	:	:	68.3	61.3	56.0	53.4	58.9	58.2	58.3
SI: Përqindja e të papunëve: ndarja e forcës punuese që është e papunë (%)		:	:	:	57.1	55.0	49.7	39.7	41.4	44.9	43.6
Ndarja e forcës punuese mashkullore që është e papunë (%)		:	:	:	51.8	45.2	40.3	31.5	32.9	34.6	38.5
Ndarja e forcës punuese femërore që është e papunë (%)		:	:	:	69.9	74.5	71.9	60.7	60.5	61.6	55.2
Përqindja e personave të papunë < 25 vite: ndarja e forcës punëtore të moshës <25që është e papunë (%)		:	:	:	80.0	77.7	74.9	66.5	70.5	75.5	70.0
SI: Përqindja e të papunëve afatgjatë: ndarja e forcës punuese që është e papunë kohë të gjatë (%)		:	:	:	47.6	47.3	42.7	34.9	34.7	41.1	37.1

Kohezioni Social	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Mesatarja mujore e rrogave (të ardhurat kombëtare)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Indeksi i rrogave të vërteta (indeksi i rrogave nominale të ndara nga CPI) (2000=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Braktisësit e hershëm të shkollës: ndarja e popullatës të moshës 18-24 që nuk e kanë përfunduar edukimin e mesëm dhe nuk ndjekin asfarë edukimi apo trajnimi (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Standardi I jetesës	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Numri i udhëtareve me vetura për 1000 persona		:	:	:	:	:	:	:	49.4	69.9	68.7
Numri i të abonuarve për shërbimet e telefonisë mobile për 1000 persona		:	:	:	:	:	156.3	167.4	:	:	:

Infrastruktura	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Densiteti i rrjetit hekurudhor (linjat operuese, per 1000 km ²)		:	:	:	:	:	:	39.5	:	:	:
Gjatësia e autostradës (një mijë km)		:	:	:	:	:	:	:	0.0	0.0	0.0

Zbulimi dhe Hulimtimi	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
SI: Shpenzimet për resurset njerëzore (shpenzimet publike për edukim) lidhur me GDP (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Shpenzimet e brendshme bruto për hulumtim dhe zhvillim, lidhur GDP (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpitë e tyre (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Ambienti	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
-----------------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------	------

SI: Lëshimi total I gazave serre, ekuivalent me CO2 (tonë, 1990=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Intensiteti I energjisë së ekonomisë (kg i vajit ekuivalent per 1000 euro GDP)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Ndarja e energjisë së përtërirë në harxhimin e rrymës (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
SI: Ngarkimi I rrugëve transportuese si ndarje e brendshme totale e transportit të ngarkuar (ndarje modale e transportit të ngarkuar) (%)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Energjia	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Produkti primar i të gjitha produkteve të energjisë (një mijë TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Produkti primar i naftës së papastër (një mijë TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Produkti primar qymyrit dhe linjtit të papërpunuar (një mijë TOE)	6)	:	:	:	:	5 528	6 466	5 658	6 391	6 532	6 715
Produkti primar i gazit natyror (një mijë TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Importet e të gjitha produkteve të energjisë (një mijë TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Konsumi bruto i energjisë së brendshme (një mijë TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjenerimi i rrymës (një mijë GWh)		:	:	:	:	3.2	3.2	3.5	4.0	4.0	4.3

Bujqësia	Note	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Indeksi I Volumit të prodhimit bujqësor të mallrave dhe shërbimeve (çmimet e prodhuesit, vitin paraprak=100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Zonë bujqësore totalisht e shfrytëzuar (një mijë hektarë)		:	:	:	539	:	:	:	:	:	:
Bagëtia: gjedhe (një mijë kokë, fundi i periudhës)		:	:	289	347	319	:	335	352	392	:
Bagëtia: derra (një mijë kokë, fundi I periudhës)		:	:	59	75	110	:	55	47	68	:
Bagëtia: delme dhe dhi (një mijë kokë, fundi I periudhës)		:	:	193	230	116	:	106	152	113	:
Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (sasia totale e qumështit, mijë tona)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Të korrurat: drithë (përfshirë orizin) (1 mijë tonë, prodhim final)		:	:	:	459	396	:	408	441	392	:
Të korrurat: panxhar sheqer (1 mijë tonë, prodhim final)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Të korrurat: perime (1 mijë tonë, prodhim final)		:	:	:	169	135	:	150	289	172	:

SI: Indikatori Struktural

e: vlerësim

f: parashikim

p: përkohshëm

b: I ndarë në seri

- 1 Burimi: Eurostat.
- 2 Burimi: Zyra e Statistikës së Kosovës të dhëna të përkohshme 2004-2006 (çmimet aktuale).
- 3 Nuk ekzistojnë të hyra kombëtare zyrtare. Euro është monedha e përdorimit.
- 4 Përfshirë sektorin e donacioneve. Sektori i donatorëve përfshin UNMIK-un, grantet.
- 5 Investimi: përfshirë sektorin donator, qeverinë e përgjithshme, investimet private (shtëpitë dhe të tjerat).
- 6 Prodhimi i qymyrit për 1 000 tonë; të dhëna të mbledhura prej Korporatës Energjetike të Kosovës (sipas Rezolutës 1244).